



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 18 SHTATOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 18.
SEPTEMBRA 2008. GODINE

SHTATOR – SEPTEMBAR
2008

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 29 dhe 30 korrik 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Interpelanca e ministrit të Punëve të Jashtme, Skënder Hyseni, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AKR-së,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-20 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërmjetësim,
8. Shqyrtimi i vendimit të Kryeministrit të Kosovës për emërimin e ministrit të Forcës së Sigurisë,
9. Shqyrtimi i propozimvendimit për ndarjen e mjeteve financiare për Ministrinë e Forcës së Sigurisë dhe
10. Shqyrtimi i propozimvendimit për formimin e Komisionit Parlamentar ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

D n e v n i r e d

1. Usvajanje zapisnika sa plenarnih sednica, održanih 29 i 30 jula 2008.godine
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Interpelacija ministra spoljnih poslova Skender Hyseni, na osnovu zahteva Parlamentarne grupe AKR
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o korišćenju, upravljanju i održavanju zgrada u suvlasništvu,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 02L-20 o tehničkim zahtevima proizvoda i procena usaglašenosti,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o predsedniku Republike,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o preduzetništvu,
8. Razmatranje odluke premijera Kosova za imenovanje ministra Snaga bezbednosti,
9. Razmatranje predloga-odluke za dodeljivanje finansijskih sredstava za Ministarstvo snaga bezbednosti,
10. Razmatranje predloga odluke za formiranje parlamentarne Komisije Ad-hoc za izbor kandidata za članove Nezavisnog nadzornog odbora Kosova.

A g e n d a

1. Approval of the minutes of the plenary sessions held on 29 and 30 July 2008,
2. Time for Parliamentary questions,
3. Interpellation of the Minister for Foreign Affairs, Skender Hyseni, upon requirement of the parliamentary group of AKR,
4. First review of the Draft Law on Use, management and Maintenance of Building Joint Ownership,
5. First review of the Draft Law on amendment and supplementation of the Law Nr. 02/L-20 on technical demands for products and valuation of conformity,
6. First review of the Draft Law on the President of Republic of Kosovo,

7. Second review of the Draft Law on mediation,
 8. Review of Prime minister's decision in nomination of Minister for Security Force,
 9. Review of proposal decision for sharing financial means for Ministry of Security Force, and
 10. Review of proposal decision for establishing Ad Hoc Parliamentary Committee for selection of candidates for members of the Independent Overseen Council of Kosovo.
-

Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti **Jakup KRASNIQI**.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 102 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Para se t'ia fillojmë, kërkoj që të hiqet nga rendi i ditës pika e tetë, duke u bazuar në praktikat e deritashme të emërimit të ministrave nga Kryeministri pas zgjedhjes së Qeverisë.

Kërkoj prononcimin e shefave të grupeve parlamentare.
Fjalën e ka deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuari zoti Kryetar,
I nderuari zoti Kryeministër,
Kabinet qeveritar dhe kolegë deputetë,

Unë besoj se të gjithë jemi të ndërgjegjshëm pse ndodh kjo, sepse ky ligj s'është i vetmi që bie ndesh në një farë mënyre me Kushtetutën, andaj për të harmonizuar këtë si duhet në raport me Kushtetutën, duhet ta heqim përkohësisht nga rendi i ditës, në mënyrë që ta harmonizojmë më vonë dhe të rregullohet kjo punë ashtu si duhet. Ne e mbështesim këtë që ta heqim nga rendi i ditës.

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zoti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Zoti Kryeministër,
Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet kërkesën tuaj për tërheqje të kësaj pike të rendit të punës, me shpresë që do të rregullohet ligji, sepse është i qartë, ai ka kërkuar si i tillë, ndërsa Kushtetuta është e qartë në kuptimin e emërimeve dhe zgjedhjeve për organet më të larta.

Grupi ynë parlamentar e mbështet mocionin tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar anëtarë të Kabinet qeveritar, kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah tërheqjen e kësaj pike nga rendi i ditës me një besim se në të ardhmen, para se të vendosen çështjet në rend të ditës, të sqarohen, në mënyrë që të mos kemi probleme të tilla. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në mbledhjen e fundit të Kryesisë përmes anëtarit tonë të Kryesisë, zotit Naim Maloku, ne kemi kërkuar një gjë të tillë që të mos futet në rend dite. Kjo do të thotë që atëherë kemi ditur që nuk duhet dhe sot e mbështesim. Mendojmë se, ashtu siç janë emëruar ministrat e tjerë, duhet të procedohet edhe me zotin Mujota. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet tërheqjen e pikës së tetë të rendit të ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar ”7+”, deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: I Parlamentarna grupa ”7+” se predružuje ostalim parlamentarnim grupama, dakle mi smo takodže da se ova tačka skine sa dnevnog reda s obzirom na ovlašćenje premijera. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Shefi i Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Uvažene kolege, dame i gospodo,

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke će podržati predlog da se osma tačka povuče sa dnevnog reda. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Lus deputetët që me një votë formale të deklarohen.
Kush është “për”? Faleminderit! A ka “kundër”? Nuk ka. A ka abstenim?
Konstatoj se me shumicën absolute të votave miratohet ky propozim.
Ju njoftoj që ministri i Ministrisë së Mbrojtjes, Fehmi Mujota, është ministër i Kabinetit qeveritar.

Fjalën e ka kërkuar Gani Koci lidhur me rendin e ditës.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Në emër të Komisionit propozoj dhe besoj që edhe ju si Kryesi e Kuvendit dhe si Kryetar, por edhe sekretari kenë qenë të njoftuar lidhur me pikën e nëntë të rendit të ditës- Propozimvendimin. Ne kemi vendim të Qeverisë, por jo propozimvendim për ndarjen e mjeteve financiare për Ministrinë e Forcës dhe të Sigurisë. Kjo kërkesë sipas rregullit dhe sipas përgjegjësisë paraprakisht do të duhej të shqyrtohej në Komisionin për Buxhet dhe në Komisionin për Buxhet nuk është shqyrtuar s’është miratuar, s’është rekomanduar që të futet në rend të ditës për vetë faktit se kërkesa nga Qeveria nuk ka ardhur në përputhje me Rregullën 8.2 pika b të Ligjit të Buxhetit për vitin fiskal 2008. Ne si Komision, më datën 9 të këtij viti iu kemi drejtuar Qeverisë që kërkesën ta kompletojë me gjithë dokumentacionin që kërkohet sipas Rregullës që e thashë më parë, prandaj si e tillë mendoj se nuk i ka plotësuar kushtet që të futet në rend të ditës.

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Dëshiroj veç t’ju ndihmoj në mbajtjen e seancës se u deklarua se zoti Mujota është ministër i Kabinetit qeveritar. Është mirë që për hir të opinionit të tregoni që zoti Mujota është ministër i Forcës së Sigurisë dhe shpresoj se Qeveria në të ardhmen do t’iu përmbahet dispozitave të Kushtetutës, duke u tërhequr nga pozita e të qenit edhe ministër, edhe deputet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pasi morëm rendin e ditës për seancën e sotme dhe të nesërme, kujtoj që vërejtja ime lidhur me rendin e ditës ka të bëjë me dy çështje të cilat mendoj se është dashur të përfshihen në rendin e punës. Çështja e parë ka të bëjë me një debat apo informacion nga Qeveria lidhur me mundësitë buxhetore për ngritjen e pagave në sektorin: e policisë, shëndetësisë, të gjyqësisë dhe të administratës, në mënyrë që vërtet nga ky Parlament dhe kjo Qeveri të kemi rekomandime dhe qëndrime për të cilat do ta njoftojmë, do të thotë të gjithë këtë sektor publik.

Dhe e dyta, është vërejtja ime, po ashtu, që është emergjente të jetë në rend të ditës është çështja e kursimit të parave nga 400 mijë punonjës të Kosovës në Fondin e Pensional apo Trustin Pensional, gjegjësisht menaxhimi i tyre i deritashëm për të mos thënë keqpërdorimi, tregtimi ose kontrabanda me ato para ku me miliona e dhjetëra miliona kanë humbur nga ai trust e ne nuk gjetëm kohë ta vëmë në rendin e ditës.

Pra, kërkoj nga Qeveria dhe nga Ju që këto çështje të vihen në rend dite në seancën e nesërme apo në vijim të seancës tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kërkesat për shtim të rendit të ditës dihet se si procedohen.

Fjalën e ka kërkuar deputetja, Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë po ndërlidhem me propozimin e kryetarit të Komisionit të Buxhetit për pikën e nëntë- Shqyrtimi i propozimvendimit për ndarjen e mjeteve financiare për Ministrinë e Forcës së Sigurisë. Nuk kam nevojë të sqaroj më tepër në lidhje me këtë pikë se sa që e sqaroj kryetari i Komisionit. Ju kisha lutur, zoti Kryetar, që të mos lejoni që të shkelen procedurat ligjore për procedimin apo për lejimin e këtyre mjeteve. Është e vërtetë që Komisioni i Buxhetit nuk ka pranuar kërkesën në formë çfarë është shtruar nga Qeveria, andaj ne si Lidhje Demokratike e Dardanisë e mbështesim propozimin e kryetarit të Komisionit të Buxhetit që kjo pikë e rendit të ditës të tërhiqet dhe të sillet me procedurë të rregullt, të aprovohet në Komision dhe pastaj të vijë në rend ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Mendoj që është i nevojshëm deklarimi i Qeverisë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, Kryetar!

Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Qeveria është e interesuar që t'i respektojë në tërësi procedurat ligjore që janë të parapara për vendosje në rend të ditës dhe tërheqje nga rendi i ditës.

KRYETARI: Faleminderit!

Me pajtimin e Qeverisë, unë përsëri e kërkoj një votë formale nga deputetët.

Kush është “për”? Faleminderit! A ka” kundër”? 1 “kundër”. Faleminderit! A ka abstenim? 1 abstenim.

Pasi që është tërhequr vetë propozuesi, hiqet nga rendi i ditës edhe pse kështu nuk është vepruar kur kohë më parë kemi miratuar Buxhetin për Ministrinë e Punëve të Jashtme. Faleminderit!

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

- Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 29 dhe 30 korrik 2008

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 29 dhe 30 korrik 2008, si dhe transkriptet nga këto seanca, u janë shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët a kanë vërejtje në procesverbale?

Për fjalë është lajmëruar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar auditor,

Në procesverbale dhe transkripte kudo përdoret termi Kuvend, që do të isha për këtë term, sepse është i përshtatshëm, është adekuat, madje edhe grupi për redaktimin e Kushtetutës e ka propozuar, por dikush arbitrarisht e ka zhvendos me termin Parlament, kështu që në Kushtetutë ekziston termi Parlament. Unë angazhohem që, ani pse

personalisht nuk do të pajtohesha me termin Parlament, por për hir të dokumentit politik-juridik më të lartë të vendit tonë, që kurdoherë edhe kudo në të ardhmen të zëvendësohet termi Kuvend me Parlament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk kemi të lajmëruar për fjalë.

Konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare të 29 e 30 korrikut 2008.

Pika e dytë e rendit të ditës.

- Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në bazë të Rregullës 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare, përkatësisht pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Koha për parashtrimin e pyetjes është e kufizuar në një minutë, për përgjigje në pyetje, tre minuta, për pyetje shtesë, një minutë, për përgjigje në pyetjen shtesë, dy minuta. Andaj, i lus deputetët dhe ministrat që ta respektojnë kohën.

Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve. Deputeti Xhevdet Neziraj, IRDK, ka pyetje për ministrin për Komunitete dhe Kthim, Boban Stankoviqin. Lus deputetin ta lexojë pyetjen!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuari Kryetar,

I nderuari Kryeministër dhe ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pyetja i është dërguar ministrit për Komunitete dhe Kthim. Edhe pse nuk është këtu, unë do ta lexoj pyetjen.

Zoti ministër, viteve të fundit ka shumë pjesëtarë të komunitetit egjiptas që janë kthyer nga disa vende perëndimore, e sidomos nga Gjermania. Çka është duke bërë Ministria juaj, pra, Qeveria për këta njerëz të kthyer, të cilët po ballafaqohen me probleme, si me rindërtimin e shtëpive, punësimin, problemet socio-ekonomike, arsimore, shëndetësore dhe regjistrimin civil? Duke pasur për bazë se nuk kanë bërë asgjë, atëherë për këtë arsye edhe e kam bërë pyetje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Gjithashtu, deputeti Xhevdet Neziraj, ka pyetje për ministrin për Administrimin e Pushtetit Lokal, zotin Sadri Ferati. Lus deputetin që ta lexojë pyetjen!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pasi që në fjalorin politik të gjithë politikanëve fjala më e shpeshtë është integrimi i komuniteteve, kam bërë një pyetje për ministrin e Pushtetit Lokal: - Sa pjesëtarë të komunitetit egjiptas janë punësuar si shërbyes civilë në asamblетë komunale në Kosovë jashtë zyrave lokale të komuniteteve?

KRYETARI: Faleminderit!

E ka fjalën ministri, Sadri Ferati.

MINISTRI SADRI FERATI: I nderuari Kryetar,

I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Në pyetjen e deputetit unë do t'i them ato shënime që ne i posedojmë. Në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk kemi evidenca për kategoritë: romë, hashkalinj dhe egjiptas, por në kategorinë RAE kemi gjithsej të evidentuar 157 të punësuar në administratat komunale. Për përgjigje më të saktë unë do të kisha udhëzuar që të pyesni në Ministrinë e Shërbimeve Publike ngase atje bëhen të gjitha evidencat për shërbyesit civilë.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

E kam ditur një përgjigje të tillë për arsye se është duke u manipuluar shumë me këto RAE, me të vetmin qëllim që të mos dihet kush kënd e përfaqëson dhe sa njerëz janë të punësuar. Për këtë arsye edhe e kam bërë këtë pyetje dhe, sa për informim, do të tregoj që nuk është asnjë i punësuar jashtë zyrave lokale të komuniteteve, prandaj, zoti ministër, përveç decentralizimit, duhet të merresh edhe me çështje të tjera që edhe komunitetet e tjera që s'kanë të bëjnë me decentralizimin të përfitojnë në administratën komunale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Ministër, a ke përgjigje shtesë?

MINISTRI SADRI FERATI : Faleminderit!

Duhet të konstatojmë edhe një herë se edhe të punësuarit nëpër zyrat lokale të komuniteteve janë shërbyes civilë dhe të punësuar në administratë. Edhe ai numër futet në numrin që e thashë. Ne nuk i ndajmë të punësuarit nëpër administratën se punësojnë në këtë zyrë dhe këtë nuk e numërojmë sa janë edhe këtej. Në përgjithësi, numri që e thashë është edhe ky. Ne e marrim përsipër që akoma ta zhvillojmë idenë që ju e thatë, që të punësojmë sa më tepër anëtarë edhe të këtij komuniteti nëpër komunat dhe në këtë drejtim ju thërras që të jemi një aksion të përbashkët, që të kemi një bisedë, të shikojmë se cila është gjendja dhe si të shkojmë më tutje. Unë jam vullnetar i kësaj ideje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Pyetja e tretë- deputeti Driton Tali ka pyetje për ministren e Energjisë dhe të Minierave, zonjën Justina Pula, dhe ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti. E ka fjalën Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Pyetja, ashtu siç thatë, është për ministren e MEM-it dhe ministrin e MPB-së. Kohë më parë u raportua se hajnat në KEK kanë arritur që të vjedhin 4000 kilogramë unaza të bronzit të papenguar nga askush. E hapin derën pa pasur nevojë ta thyejnë drynin, duke vjedhur me javë të tëra. Ka edhe vjedhje të tjera të raportuara në KEK, si për shembull, vjedhjet e kabllove elektrike, kabllove që e lidhin rotorin e elektromotorit, kabllove të gomës që shërbejnë për lëshimin në punë të elektromotorit tek shiriti transportues i qymyrit e tjera, sikurse që janë raportuar edhe krime të tjera, si bie fjala, mbushja me

dhe e ekskavatorit E2, duke i shkaktuar humbje disa milionëshe KEK-ut, dhe vepra të tjera penale. Pyetja është: -Çfarë ka bërë konkretisht Ministria e MEM-it dhe MPB-së lidhur me rastet e raportuara dhe...

KRYETARI: Ministrja përgjigjet.

MINISTRJA JUSTINA PULA: I nderuari Kryetar i Parlamentit,
I nderuari Kryeministër,
Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuari deputet Tali, edhe unë iu bashkohem shqetësimeve tuaja se çdo vjedhje dhe shpërdorim në KEK duhet të dënohet ashpër me ligj.

MEM-i nuk është institucion përgjegjës për vjedhje dhe shpërdorime. Ne do ta përkrahim dhe inkurajojmë menaxhmentin e KEK-ut që t'i marrë të gjitha masat që këto t'i denoncojë dhe t'i përcjellë deri në prokurori.

Ju i përmendët disa vjedhje. Ne jemi shumë të shqetësuar. Konkretisht kemi të bëjmë me dy raste. Rasti i parë është paraqitur më 8 janar 2008 dhe totali i dëmit është 2340 euro, ndërsa rasti i dytë paraqitet më 11. 2. 2008 dhe totali i dëmit është 3995 euro.

Për të dy rastet janë formuar grupet punuese në KEK, janë paraqitur në polici dhe ndiqen sipas procedurave zyrtare. Ende nuk kemi marrë ndonjë informacion se çka është bërë, mirëpo tërë kohën jemi duke monitoruar dhe jemi në kontakte me organet përgjegjëse për këto raste. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, a ke pyetje shtesë?

DRITON TALI: Po, kam një koment të vogël. Zonja ministre tha se MEM-i nuk merret me këto punë. Unë nuk di me çka po merret MEM-i, ndonëse njëherë tjetër na shpjegon pak në detaje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Vazhdojmë me pyetjen e katërt. Deputetja Drita Kadriu, PDK, ka pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zoti Enver Hoxhaj. Lus deputeten Kadriu ta lexojë pyetjen!

DRITA KADRIU: Faleminderit, Kryetar!
Zoti ministër, fillimisht ju përuroj për një fillim të mbarë të vitit shkollor. Menaxhimi dhe organizimi në MASHT ka vështirësi të ndryshme në administrimin e proceseve. Kjo ndodh për shkak se strukturat organizative brenda në MASHT janë formuar, pa pasur të qartë vizionin dhe misionin për të cilin janë ngritur fillimisht.

Pyetja ime është: -Çfarë po ndërmerrni për të ndërtuar një strukturë organizative funksionale, në mënyrë që administrimi i proceseve të bëhet në interes të misionit që ka MASHT-i?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit shumë!

I nderuari zoti Kryetar,

I nderuari zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra,

Të nderuar deputetë,

Unë kam marrë një pyetje me shkrim, e cila më tepër i referohet nostrifikimit. Tash shtrimin e pyetjes nuk e kuptova se a është fjala për organogramin e Ministrisë apo për nostrifikimin?

KRYETARI: Sqaroje pyetjen, deputete Kadriu!

DRITA KADRIU: Në vështirësitë në administrim të proceseve kemi një shembull si ngecin këto procese, sepse 7 muaj pritet për një nostrifikim. Që ta lehtësoj, pyetjen e kam pasur zoti ministër.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit shumë për pyetjen deputete. Ju falënderoj shumë për një pyetje të tillë, e cila, vërtet, edhe për ne si Ministri e Arsimit është një shqetësim në baza ditore me që shpeshherë shohim palë që presin gjatë për nostrifikim të diplomave. Më lejoni t'ju them që nostrifikimi i diplomave si koncept është koncepti i kohës së komunizmit, meqë sot ka barasvlerë të diplomave dhe qarkullim të diplomave. Çdo diplomë që lëshohet sot mund të verifikohet shpejt në internet nga autoriteti që është lëshuar- përmbajtja e diplomës. Prandaj, ne si Ministri e Arsimit kemi themeluar qendrën ENIK/NARIK, e cila është një rrjet dhe i cili rrjet evropian- botëror synon që diplomat brendapërbrenda Kosovës dhe brendapërbrenda vendeve të Bashkimit Evropian dhe në botë të jenë të barasvlershme dhe të qarkullojnë sa më shpejtë, përderisa jemi të detyruar që ajo pjesë e administratës e cila ka mbetur që të vazhdojë procesin e nostrifikimit ta përmbyllë një proces të tillë. Së shpejti do ta kemi edhe promovimin e konceptin të Qendrës ENIK/NARIK, i cili është një projekt dhe i cili do të sigurojë që diplomat nuk kanë nevojë të nostrifikohen në formë siç janë nostrifikuar më herët, por kanë nevojë që të jenë barasvlershme brendapërbrenda institucioneve të Kosovës dhe këto të Kosovës të jenë të barasvlershme dhe të qarkullueshme jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, a ke pyetje shtesë?

Fjalën e ka deputetja Drita Kadriu.

DRITA KADRIU: Pyetja ime është: - Çfarë po ndërmerrni që të riorganizoni strukturën brenda MASHT-it? Për shembull, kenë strukturën e Inspektoratit që nuk dihet shumë qartë cilat janë detyrat e tyre. Pastaj, të Institutit Pedagogjik që, gjithashtu, shumë njerëz aty kanë kontrata, ndërsa ndoshta nuk bëjnë punën për të cilën janë thirrur. Pyetja ime ishte, rreth organogramit të Ministrisë së Arsimit.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, për pyetjen e dytë!

Ju e dini se Qeveria e Kosovës ka iniciuar Projektligjin për Qeverinë. Definitivisht, ky projektligj do të ketë edhe reflektime direkt në punën tonë si Ministri e Arsimit, përderisa sa i takon organogramit, ne si Ministri e Arsimit kemi angazhuar një ekspert ndërkombëtar i cili merret me hartimin e një studimi të fizibilitetit, meqë vetëm kur ka studime të fizibilitetit, atëherë mund të merren edhe vendime se si të organizohen organogramet.

Unë mendoj që puna të cilën është duke bërë Ministria e Arsimit me organogramin aktual i përbush disa kërkesa, ndërsa çështjet të cilat i referohen nostrifikimit të diplomave,

për shembull, shpeshherë nuk janë punë që varen direkt nga Ministria e Arsimit, meqë është fjala për komisione vlerësuese të cilat janë jashtë Ministrisë së Arsimit, që janë pranë Universitetit të Prishtinës, për ekspertë të ndryshëm të cilët për një lëndë të caktuar kanë nevojë për kohë dhe hapësirë që ta shohin një diplomë konkrete se sa përshtaten me plan-programet tona, kështu që jo vetëm organogrami i Ministrisë, por shpeshherë edhe pozita e aktorëve të ndryshëm jashtë Ministrisë së Arsimit e dikton dinamikën e punës të cilën e bëjmë ne si Ministri e Arsimit.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Pyetja e radhës, deputetja Drita Kadriu, ka pyetje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, zotin Valton Beqiri.

Deputete, parashtroje pyetjen!

DRITA KADRIU: Faleminderit, Kryetar!

Në qytetin e Vushtrrisë gjenden dy monumente të lashtësisë historike të Kosovës: Ura e Guri dhe Kalaja e Vjetër, të cilat janë monumente të mbrojtura edhe na UNESCO-ja, por që kanë vështirësi t'i përballojnë shkatërrimet e kohës.

Pyetja ime është: -Cilat janë projektet e Departamentit të Kulturës në Ministrinë tuaj për të ndërmarrë hapa konkretë në këtë problematikë për komunën e Vushtrrisë? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI VALTON BEQIRI: Faleminderit, i nderuari zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Institucionet e Ministrisë së Kulturës, të cilat merren me trashëgiminë kulturore në gjithë territorin e Kosovës kanë evidentuar rreth 2847 objekte në tërë Kosovën që janë në prioritet dhe në listën e monumenteve të cilat duhet të jenë në mbrojtje të shtetit.

Në kuadër të këtyre monumenteve, në komunën e Vushtrrisë janë evidentuar: Kalaja e Vushtrrisë, si monument i rëndësisë së veçantë, Ura e vjetër e Gurit, përmendoret mbivarrore të Mustafë Begut, Shtëpia e Badivukut, Shtëpia në rrugën "Boris Kidriq", në rrugën e vjetër, Shtëpia e Qamiloviqe.

Sa i përket Urës së Gurit, në vitin 2004 Ministria e ka prezantuar dhe ka futur në listën prioritare dhe në sajë të prezantimit tonë në Konferencën e Donatorëve në muajin maj në Paris, në vitin 2005, është siguruar një fond prej 150 mijë eurosh nga Zyra Franceze dhe implementimin e këtij projektit ka pasur ta bëjë UNECKO, por ajo është vonuar me implementim të procesit dhe presim që në fund të këtij viti të fillojë implementimi rreth Urës së Gurit.

Sa i përket Kalasë së Vushtrrisë, Ministria e Kulturës, në muajin prill 2008, katër muaj para pyetjes suaj parlamentare ka futur si prioritet dhe ka prezantuar në projektet, në dokumentin e PIP-it për 2009 dhe kemi kërkuar që në Kalanë e Vushtrrisë të investohet 120 mijë euro në dy faza, për 2 vjet. Mendoj se ne jemi duke u munduar që në bazë buxhetit të cilën e kemi ta shpërndajmë në gjithë territorin e Kosovës dhe besoj që në fazën kur vjen vendosja për buxhet, të keni konsideratë që këtë buxhet ta ngrisni edhe për trashëgiminë kulturore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, a ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Pyetja e radhës.

Deputeti Arsim Rexhepi, ka pyetje për ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, zotin Sadri Ferati.

Zoti deputet, parashtrojeni pyetjen!

ARSIM REXHEPI: Zoti ministër Ferati,

Në një praktikë që deri me zgjedhjet e fundit e ka kultivuar OSBE-ja për qytetet që kanë nën 100 mijë banorë, janë paraparë asamble me 31 anëtarë. Vushtrria është ndër ato qytete që i ka pasur dhe i ka mbi 100 mijë banorë. Edhe në numërimin e fundit që e ka bërë OSBE-ja, Vushtrria rezulton t'i ketë 107 mijë banorë, ndërsa njëkohësisht vazhdon në asamblenë e saj t'i ketë 31 anëtarë.

Pyetja ime është: -A keni dijeni rreth këtyre padrejtësive që ndodhin me asambletë komunale kur në të njëjtën kohë në një qytet tjetër që ka dukshëm më pak se 100 mijë banorë, në Suharekë punojnë në asamblenë komunale ose janë aktiv në asamblenë komunale 41 delegatë. Pse ndodh kështu dhe a keni paraparë një zgjidhje për ta kthyer drejtësinë në vend? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI SADRI FERATI: I nderuari deputet,

Gjendja momentale nëpër asambletë komunale është e kësaj kategorie. Kategorizimi i asambleve në 21, 31, 41 dhe 51 anëtarë të asambleve komunale me Ligjin e ri për vetëqeverisje lokale është një formulim tjetër dhe numri i anëtarëve të asambleve komunale do të korrespondojë me numrin e banorëve të atij lokaliteti. Duhet të presim fillimisht dhe po shpresojmë dhe vendimet janë të tilla dhe po bëhen të gjitha përgatitjet që të kemi edhe regjistrimin e popullatës dhe pastaj do të jetë shumë lehtë që me saktësi të konstatojmë se cila është asambleja komunale, sa anëtarë të asamblesë do të jenë. Nuk është vetëm Vushtrria ajo që konsideron se ka numër më të madh të banorëve dhe i takon numër më i madh i asambleve dhe i takon një trajtim më i fuqishëm në ndarjen e grandeve. Vërejtje të tilla kemi në të gjitha komunat, besoni, por tani për tani ne nuk mund të ndryshojmë këtë gjendje derisa nuk kemi faktografi konkrete me regjistrimin e popullatës.

Sipas gjendjes momentale që ekziston me ligjin e ri, Vushtrrisë do t'i kishin takuar 45 anëtarë, si një informacion preliminar, por regjistrimi i popullatës do të jetë ai që do ta përcaktojë decidivisht. Pra, deri në zgjedhjet e reja dhe numrin e saktë të regjistrimit të popullatës, tani për tani kjo është gjendja momentale në të cilën duhet të llogarisim dhe duhet të punojmë më tutje.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Pyetja e radhës, deputetja Myrvete Pantina, ka pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta parashtrojeni pyetjen!

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Qytetarët e Vushtrrisë furnizohen me ujë nga ujësjellësi rajonal i Mitrovicës nga i cili furnizohen edhe qytetarët e Mitrovicës dhe të Skenderajt. Por, qytetarët e Vushtrrisë

ballafaqohen me mungesë të jashtëzakonshme të ujit të pijes tash e 9 vjet. Gjatë ditëve të verës, qyteti kishte ujë vetëm një orë gjatë 24 orëve, ndërsa qytetet e tjera kanë përfituar shumë moti edhe përfitojnë ende shumë më tepër nga i njëjti burim. Konstatimi është se qytetarët e Vushtrrisë janë të dëmtuar në raport me qytetet e tjera sa i përket furnizimit me ujë. Prandaj, kërkojnë që uji të shpërndahet proporcionalisht me numrin e banorëve të tyre.

Zoti Kryeministër,

Meqë problemi i furnizimit me ujë të qytetarëve të komunës së Vushtrrisë nuk po mund të zgjidhet në nivelin rajonal, a ka mundësi që Qeveria e Kosovës të marrë përsipër zgjidhjen e këtij problemi?

Me këtë rast, zoti Kryeministër, dua vetëm t'ju përkujtoj se qytetarëve të Vushtrrisë gjatë fushatës parazgjedhore u keni premtuar...

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar të gjithë ministra, deputetë, shefa të grupeve parlamentare, kryetarë të partive politike,

Dëshiroj që fillimisht t'ju uroj hapjen e sesionit të ri të Kuvendit të Republikës së Kosovës- sesionit vjeshtor, me këtë debat apo këto pyetje të cilat janë më interes edhe për Qeverinë, për Kuvendin dhe për qytetarët e Republikës sonë.

E nderuara deputete,

Jam mirë i informuar me krizën sa i përket furnizimit me ujë edhe në qytetin e Vushtrrisë. Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë përgjegjësinë që i takon dhe së bashku me Komisionin Evropian është duke shqyrtuar mundësinë e fillimit të projektit, pas përfundimit të studimit të këtij projektit me një vlerë rreth 4 milionë euro në vendin e quajtur Sugdo, mes fshatrave Oshlan dhe Akrashticë, në sistemin "Ibër-Lepenc", me kapacitet 300 litra në sekondë dhe që do të mbulojë rreth 70% të territorit të Vushtrrisë, duhet që të ndërtohet fabrika e ujit dhe në këtë drejtim Qeveria e Kosovës së bashku me Komisionin Evropian është duke punuar seriozisht. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Deputete, a ke pyetje shtesë?

Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Zoti Kryeministër, kur pritet të realizohet ky projekt?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë shikova nga opozita se a po vjen ndonjë pyetje, s'i shikova këta partnerët e koalicionit. Sido që të jetë, faleminderit shumë për pyetjen!

Por, për projektin është me rëndësi që ka përfunduar studimi, ka filluar të punohet shumë seriozisht dhe do të fillojë shumë shpejtë. Është çështje procedurale kur do të përfundojnë këto procedura dhe të fillojë projekti. Me rëndësi është që është përcaktuar lokaliteti, vendi, janë siguruar mjetet, tash do të fillojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Pyetja e radhës, deputeti Ibrahim Makolli, AKR, pyetje për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq.

Deputet, e ke fjalën!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit!

Pyetja është- Invalidët ushtarakë dhe civilë, të cilët e kanë pasur të rregulluar statusin e tyre të invalidit para vitit 1999 dhe kanë gëzuar pension invalidor, nuk janë të përfshirë në skemën e re të përkrahjes sociale dhe pensionale.

Zoti ministër,

Cila është arsyeja e heqjes së tyre nga lista dhe cilat janë qëndrimet e kësaj Ministrie ndaj kësaj kategorie në shoqëri?

KRYETARI: Urdhëro!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Poštovani predsjedniče,

Pštovani premijeru,

Poštovani zamenici premijera,

Poštovani ministri,

Dame i gospodo, narodni poslaici,

Gospodine Makoli, kao što verovatno znate, trenutno je na snazi regulativa UNMIK-a 2001/35, koja je u osnovi dala da svi stari od 65. godina mogu imati pravo na penziju od 40 evra. Kao što znate, novi sistem, penzioni sistem, koji je počeo sa radom a koji je usvojen 2001. godine, nije obuhvatio možda sve grupe invalida rata koji su imali taj status pre 1999. godine, i ova šema iz 2003. koja je takođe obuhvatila 40 evra po jednog korisnika koji su utvrđeni sa invaliditetom i u tom delu su i ti korisnici bivši bili ohrabreni više puta javno da se prijave da dobiju svoje pravo na penziju. Doduše, desilo se da jedan broj njih nije odgovorio na taj javni proziv i da nije ispunio svoje zakonsko pravo, ali ono što mogu da vam kažem, da ono što Ministarvo za rad i socijalnu politiku radi sad je izgradnja jenog novog zakona koji će obuhvatiti sve invalide, znači i one koji su bili pre 99-te i one posle 99-te, što bi značilo, što bi uključivalo i ove ratne invalide koji su to bili pre same 99-te godine, odnosno iz Drugog svetskog rata.

Ministarstvo za rad i socijalnu politiku će taj zakon sa izradom tog zakona u ovim radnim grupama koje imamo u samom ministarstvu i u samoj Vladi, izvršiti posao do kraja septembra, eventualno do sredine oktobra, tako da ćemo posle toga da prosledimo dalje na rad u samoj Vladi, i sigurno ćete biti i Vi informisani. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit ministër, deputet ke pyetje shitesë? Urdhëro, fjalën e ka Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit!

Ministër, kjo sipas meje paraqet diskriminim dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Pyetja ime shitesë është kjo: - Çka do të ndërmerrni ju përkitazi me këtë çështje dhe a duhet që kjo kategori e njerëzve të cilët padrejtësisht nuk janë brenda skemave që t'u kompensohen të gjitha ato vite të cilat nuk kanë pranuar pensionin invalidor?

NENAD RAŠIĆ: Gospodine Maloli, ja sam i malo pre ogovorio verovatno na to pitanje rekavši da su oni svi bili javno pozvani nekoliko puta da se uključe u penzijsku gemu,

invalidsku, ali se jedan broj njih nije odazvao. Novi zakon bi trebao jasno da utvrdi da li imaju, ja u ovom momentu ne mogu da vam kažem sigurno da li će imatai pravo na nadoknadu retroaktivno ili će biti od dana kada će oni biti prihvaći, ali siguran sam da će Zakon to regulisati. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputeti Naser Rugova, LDD, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Zoti deputet, e keni fjalën!

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti ministër i Shëndetësisë. Para disa muajve ju pata parashtruar një pyetje lidhur me Entin e Medicinës fizikale dhe rehabilitimit “Ilixha” lidhur me zgjidhjen e statusit juridik të këtij institucioni shëndetësor dhe mundësinë e menaxhimit nga Ministria që ju e drejtoni. Që nga ajo kohë nuk ka ndodhur asgjë në këtë drejtim. Ky institucion është në gjendje të rëndë në të gjitha aspektet edhe për faktin e keqmenaxhimit nga ana e menaxhmentit aktual.

Mirëpo, pa kurrfarë të drejte ligjore, pa kurrfarë kompetence, drejtorit të Entit shëndetësor “Ilixha” i vazhdohet kontrata edhe për një vit nga një zyrtar i Ministrisë që ju e drejtoni. Këtyre shkeljeve flagrante të ligjit i shtohet edhe fakti se drejtori aktual i këtij institucioni është nën hetime për krime ekonomike. Pse ministri i lejon këto shkelje të ligjit? Cili është komenti juaj për degradimin në kontinuitet të këtij institucioni të rëndësishëm shëndetësor dhe cilat janë masat që ju do të ndërmerrni për sanimin e gjendjes?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuari zoti Kryetar i Kuvendit, Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar, Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Zoti Rugova, pyetja juaj është njëra prej pyetjeve të cilës ne i kemi kushtuar kujdes që nga dita e parë, më 10 janar, sepse gjendja në institucionin që ju e përmendni është një gjendje shumë paradoksale, që një institucion shëndetësor publik i vendit tonë nuk financohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe aty është një gjendje juridike shumë e ngatërruar. Ne e kemi trashëguar si të tillë që nga dita e parë për shkak të rëndësisë, kemi arritur që në mbledhjen e Qeverisë, e cila është mbajtur në Istog, këtë çështje ta diskutojmë.

Ne mendojmë se ai institucion duhet të privatizohet pjesërisht, ndërsa kur them pjesërisht, mendoj me spinof special, pjesa e objektit të Oniksit, ndërsa të mbetet burimi i ujit dhe një objekt diku me 200 shtretër.

Ne kemi vizituar në nivelin më të lartë tri herë deri më tash këtë qendër, kemi ardhur në përfundim se ata të cilët e kanë vazhduar atë kontratë kanë bërë një shkelje. Në dosjen e tyre personale ke bërë një vërejtje konfidenciale dhe shpresoj që ata do të kenë në bazë të rregullave në fuqi pasoja. Është ndërprerë kontrata, nuk paguhet drejtori, sepse shkeljet janë të pakapërcyeshme dhe bëhet me dije që ai institucion është edhe nën hetime policore.

Ne jemi për këtë institucion dhe për disa institucione tjera në një situatë shumë interesante ku ne kemi nevojë për punëtorë shëndetësorë, ndërsa Ministria e Ekonomisë dhe Financave, e shtyrë dhe e kontrolluar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, nuk na lejon që ne të punësojmë profesionistë mjekësorë. Ne kemi program për zgjedhjen e këtij problemi, kemi mbështetjen besoj të shumicës së Kuvendit, që punëtorët shëndetësorë të nxirren nga shërbyesit civilë dhe ne të mos kemi një situatë paradoksale siç është kjo.

Unë shpresoj që me fillimin e punës së Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe duke pasur parasysh se kryetari i komunës së Istogut është njëri prej anëtarëve dhe për kryetarin e komunës ky është një prioritet, sepse ne mendojmë që duhet institucionet të decentralizohen, do të thotë që të jenë në menaxhim financiar të komunës, ndërsa

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputet, a ke pyetje shtesë?
Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti ministër!
Ishte një përgjigje jo e plotë. Çështja është pse ju keni lejuar që një shërbyes civil t'ia vazhdojë kontratën drejtorit? Çështja tjetër është, kur do të merrni hapa konkret se kështu keni deklaruar edhe më herët, kanë kaluar 9 muaj që nga ardhja në pushtet të këtij koalicionit qeveritar? Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit shumë!
Ne, në kuadër të kompetencave ligjore, në ditën e të kuptuarit se është vazhduar ajo kontratë dhe që drejtori është i vetmi zyrtar që paguhet nga Qeveria e Kosovës dhe asnjë punëtorë tjetër nuk paguhet, e në të njëjtën kohë ai drejtor merr rrogë edhe nga të hyrat vetanake, ne e kemi ndërprerë atë kontratë dhe për zyrtarin e Ministrisë së Shëndetësisë në bazë të rregullave në fuqi ne i kemi shqiptuar vërejtje konfidenciale në dosjen e tij personale dhe unë shpresoj që komisioni disiplinor do ta marrë veprimin e duhur në bazë të ligjit.

KRYETARI: Faleminderit!
Pyetja e radhës, deputeti Naser Rugova ka pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti. Zoti deputet, e keni fjalën!

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!
Zoti ministër, problematika e pajisjes së shtetasve të Republikës së Kosovës me dokumente të udhëtimit vazhdon tani e disa vjet, por tani jemi në rrethana të reja, jemi shtet dhe nuk mund t'i ankohemi askujt për ngecje dhe zvarritje procedurash. Fatkeqësisht, këto trende kanë vazhduar dhe po vazhdojnë ende. Jemi dëshmitarë të radhëve të gjata dhe të pritjeve, sidomos në sezonin e verës, kur shumë bashkatdhetarë tanë shtetas të Republikës së Kosovës vinë për pushime në atdhe. Vërtet është për të ardhur keq kur i dëgjojmë shqetësimet e tyre, kur dihet se u është premtuar një tretman krejt tjetër të cilën ata edhe e meritojnë. Të presësh me nga 2,3 apo 4 javë që të pajisesh me dokument të udhëtimit të shtetit tënd, vërtet është paradoks. Cilat do të jenë masat konkrete të Ministrisë që ju e drejtoni për thjeshtësimin e procedurave të pajisjes së shtetasve të Republikës së Kosovës me dokumente të udhëtimit, e në veçanti të atyre në mërgatën tonë?

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Rugova,

Qytetarët, siç e dini, aplikojnë për pasaporta në qendrat komunale të regjistrimit civil që janë të instaluar në 30 komuna. Aplikacionet e tyre pastaj dërgohen në Departamentin për Prodhimin e Dokumenteve që funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe afati ligjor për prodhimin e një pasaporte është 14 ditë nga dita e aplikimit. Dëshiroj të theksoj që radhët e gjata për aplikimin në komuna para sporteleve nuk janë vetëm për pasaporta, janë edhe për dokumente të tjera, duke përfshirë edhe dokumente të tjera të gjendjes civile, certifikatat e llojeve të ndryshme.

Më lejoni t'ju informoj, po ashtu, se me qëllim të ngritjes së efikasitetit për ofrimin e shërbimeve për qytetarët që kërkojnë të pajisjen me pasaporta, Ministria e Punëve të Brendshme, me përkrahjen e Qeverisë e ka marrë një vendim që dy departamentet përkatëse- Departamenti për Regjistrimin dhe Gjendjen Civile dhe Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve të punojnë me orar të zgjatur 12 orë në ditë, ndërsa gjatë vikendit nga 8 orë, gjithnjë me qëllim që në këtë fazë, kur posa kemi filluar me pasaporta të reja, të ofrojmë shërbime sa më efikase ngase edhe kërkesat e qytetarëve janë enorme të mëdha.

Siç e dini, e kemi bërë edhe publike, disa herë kemi pasur edhe një program të veçantë për diasporë, ku ka pasur në çdo komunë edhe sportele të veçanta. Këto i kemi organizuar edhe në bashkëpunim me komunat, sportele të veçanta për informim të qytetarëve dhe për mbështetje të veçantë të qytetarëve për pajisjen e tyre me pasaporta të Republikës së Kosovës.

Besojmë se këtë e kemi arritur duke pajisur qytetarët me pasaporta dhe para afatit të paraparë. Kemi pasur edhe raste edhe ju mund të shikoni që në rastet emergjente të veçanta Ministria jonë ka shtuar dhe, përveç afatit shtesë të punës, kemi qëndruar deri në orët e vona të natës të punojmë sidomos në muajin që ka qenë kritik dhe disa nga qytetarët kanë marrë edhe tek pas mesnate kanë arritur pasaportat në qytetet e tyre.

Dëshiroj t'ju them me kënaqësi se trendet e pasaportave kanë qenë jashtëzakonisht të mëdha. Kemi rreth 130 mijë pasaporta vetëm prej datës kur ka filluar dhënia e pasaportave tona. Ky është një numër rekord, pra ky numër nuk është shënuar asnjëherë as në vendet e regjionit. Dhe, po ashtu, dëshiroj të shfrytëzoj këtë rast t'ju them se edhe trendi i njohjes së pasaportave tona nga shtetet tjera është shumë i mirë, përveç vendeve që na kanë njohur zyrtarisht po bëjmë punë të madhe edhe me vendet që zyrtarisht nuk e kanë njohur ende shtetin tonë për njohjen e pasaportave dhe kemi sinjale shumë pozitive që do të njihen nga këto vende. Faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit, zoti ministër!

A ka pyetje shtesë? Po!

Prapë deputeti Naser Rugova, ka pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti.

NASER RUGOVA: Faleminderit!

Zoti ministër, që nga çlirimi i vendit tonë kanë kaluar 9 vjet, kurse në territorin e Republikës së Kosovës, tani shtet i pavarur dhe sovran, ende qarkullojnë automjete me dy palë targash të njohura zyrtarisht. Njëra palë e targave janë të protektoratit dhe të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse dhe, tjetra, e shtetit fqinj, Serbisë. Tani kanë kaluar muaj që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe vazhdon e njëjta situatë. Kur do t'i ketë Republika e Kosovës targat e veta zyrtare që do të respektohen nga të gjithë shtetasit dhe në mbarë territorin e vendit tonë dhe kur do ta ndaloni regjistrimin e automjeteve në territorin e Republikës së Kosovës me targa të një shteti tjetër?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Faleminderit për pyetjen, zoti Rugova!

Automjetet me targa të vjetra, siç e dini, ende lejohen të qarkullojnë në territorin e Republikës së Kosovës me një vendim ekzekutiv të mëhershëm të UNMIK-ut dhe i cili ka qenë i vazhduar disa herë, siç e dini edhe ju, më herët edhe me një vendim ekzekutiv të datës 11 prill që është kërkuar, është lejuar një shtyrje, po ashtu, e këtij vendimi.

Parimisht, çështja e regjistrimit dhe e qarkullimit të automjeteve është e rregulluar me Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor. Në këtë kontest, ne po punojmë që të rregullohet edhe çështja e automjeteve me targa të mëhershme, por më lejoni të konfirmoj se autoriteti i vetëm për regjistrimin e automjeteve dhe lëshimin e targave të Republikës së Kosovës është Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Tashmë jemi në fazën e finalizimit të përgatitjeve për të filluar me lëshimin në qarkullim të targave të reja të Republikës së Kosovës. Në këtë kontest kemi hartuar bazën ligjore dhe dizajnin e targave të reja, ndërkohë shumë shpejtë presim të kemi konsultime përmbyllëse për të filluar pastaj edhe procesi i lëshimit të targave të reja në qarkullim për të cilat po punojmë që jo vetëm të jenë të një kualiteti të sigurisë së lartë, por edhe të duken bukur.

Dëshiroj, po ashtu, të them që çështja e lëshimit në qarkullim të targave të reja tashmë është një çështje e kryer dhe më e rëndësishme se sa dizajni edhe mbështetja ligjore, por përcjellja ligjore për këto targa është me rëndësi procesi të cilin ne po e koordinojmë edhe me institucionet tjera për të bërë një proces komplet që kur fillojë dhënia e tyre të jetë një afat ku të gjithë qytetarët, të gjithë ata që kanë automjete, duhet të kenë edhe targa të reja. Por, është një proces që nuk duhet të shikohet vetëm nga aspekti i nxjerrjes së një targe të re, por edhe i koordinimit kohor edhe me mekanizma të tjerë për ta realizuar plotësisht brenda një afati. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Prapë deputeti Naser Rugova, ka pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, Enver Hoxhaj.

NASER RUGOVA: Zoti ministër, jemi dëshmitarë që nga paslufta, përkundër përpjekjeve jo të vogla të institucioneve dhe kuadrit arsimor universitar, reformat në arsim universitar kanë ngecur. Faktorët e këtyre ngecjeve janë të shumtë: vakumi ligjor për një kohë të gjatë, mungesa e buxhetit të nevojshëm për zbatimin e reformave,

politizimi dhe ndikimet e politikës në këtë segment, por edhe neglizhenca, papërgjegjësia pse jo edhe euforia e pasluftës.

Për procesin e Bolonjës as që bëhet fjalë. Përpos Universitetit publik, këto 5 vjetët e fundit në vendin tonë u hapën dhe u licencuan nga Ministria e Arsimit, Shkencë dhe Teknologjisë dhjetëra universitete private në të cilat ligjëron një numër i theksuar i kuadrit akademik që ligjërojnë në Universitetin Publik. Pas raportit të Këshillit Britanik, Qeveria e Kosovës mori vendim që të mos licencohet asnjë universitet privat në Kosovë. Dihet se aktualisht në këto universitete private vijnë mësimet apo janë para përfundimit të studimeve mbi 23 mijë të rinj të vendit tonë.

KRYESUESI: Zoti Hoxhaj, e keni fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

I nderuari deputet Rugova,

Faleminderit shumë për një pyetje të tillë. Do të synoj që të jem konkret në përgjigjen që e shtruat. Pikërisht fati i mbi 20 mijë studentëve që janë në institucionet private të arsimit të lartë ka qenë faktor kryesor dhe determinues pse Qeveria e Kosovës ka vendosur që ta angazhojë një këshill shumë profesional, Këshillin Britanik për Akreditim dhe të vendosë rend në kaosin i cili e ka përcjellë arsimin e lartë këto vitet e pasluftës. Meqë mënyra e formulimit të pyetjes ishte edukimi dhe ekonomia, më lejoni t'ju them që pikërisht është agjenda e Qeverisë së Kosovës që edukimi të kuptohet si ekonomi dhe edukimin e kuptojmë si ndër prioritetet ekonomike të Kosovës, prandaj edhe synojmë që ta kemi një sistem arsimor, i cili prodhon fuqi punëtore të kualifikuar për tregun e punës së Kosovës dhe më gjerë.

Arsimi terciar ose arsimi i lartë është kyç për tregun e punës meqë prodhon profesionistë të fushave të ndryshme. Meqë programet e studimit që ofrojnë universitetet private nuk u referohen nevojave të tregut të punës edhe ky ka qenë njëri prej faktorëve kryesorë pse raporti i Këshillit për Akreditim ka qenë ai çfarë ka qenë. Më lejoni t'i përmendi dy situata që do t'i kemi gjatë këtij viti dhe vitit të ardhshëm.

Së pari, në çdo vend të botës arsimi i lartë nënkupton një pluralizëm të institucioneve ku ka edhe shkolla profesionale të larta, fakultete politeknike edhe universitete. Vizioni ynë është që këto universitete të ofrojnë edhe grada universitare, mirëpo edhe grada jo universitare të drejtimeve të ndryshme profesionale ose të jenë fakultete politeknike.

E dyta, pas procesit të akreditimit, ne shpresojmë që disa universitete do të jenë të përkushtuar dhe, nëse janë të përkushtuar, do ta kenë edhe certifikatën për akreditim. Diplomati që do t'i marrin do të reflektojnë cilësi dhe do t'iu përshtaten nevojave të tregut të punës. Do të thotë, qëllimi ynë si Qeveri është që vërtet këto institucione t'i shohim si partner. Sektori privat është partner i fuqishëm vetëm atëherë kur ofron cilësi dhe kur ofron standarde të cilat do të duhej t'i respektonim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë, zoti Rugova?

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti ministër!

Ishte një përgjigje e orientimeve të politikave të Qeverisë në këtë sektor. Ju edhe vetë dhe disa anëtarë të Kabinetit qeveritar me vite keni ligjëruar në dy e më shumë universitete

private. A janë valide notat që i keni dhënë dhe diplomat dhe ato të tjerat dhe çka do të ndodhë me fatin e mbi 23 mijë të rinjve? Këtu është problematika.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Definitivisht, po. Sikur pjesa e parë e pyetjes do të kishte qenë e formular në këtë formë, atëherë përgjigja ime do të ishte kjo.

Kuvendi i Kosovës, në vitin 2003 e ka miratuar Ligjin për arsimin e lartë. Në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë, u janë ndarë licencat këtyre universiteteve private. Këto licenca janë valide, këto diploma janë valide deri në vitin 2007. Ne nuk marrim përgjegjësi vetëm për një pjesë kyçe, ajo është cilësia e këtyre diplomave, mirëpo janë valide meqë janë dhënë në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë të Kosovës, kështu që definitivisht këto diploma do të jenë valide, pra duhet të pranohen. Ndërsa, sa i përket qarkullimit të këtyre të diplomave, barasvlerës së këtyre diplomave në tregun e punës brenda Kosovës dhe jashtë Kosovës, do të jetë procesi i akreditimit, i cili do të ndihmojë shumë që këto diploma thjesht të pranohen meqë standardet janë nga Ligji për arsimin e lartë dhe standarde ndërkombëtare në fushën e arsimit të lartë të cilat thjesht do të shërbejnë si kriteret për procesin e dytë të akreditimit. Mirëpo, ju falënderoj për pyetjen e dytë, definitivisht çdo diplomë që është lëshuar në universitetet private deri në vitin 2007 me licencë që janë dhënë nga Ministria e Arsimit, do të jetë valide, pranohet dhe duhet të pranohet nga çdokush në Kosovë. Qëllimi ynë, si qeveri e Kosovës, është që në vitin 2009 të jemi të përqendruar në tri prioritete. Ato prioritete janë: cilësia, cilësia dhe vetëm cilësia në arsim.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Dua t'ju informoj që sipas kohës së paraparë, kemi ardhur te pyetja e parafundit dhe e kemi shpenzuar 50 minutëshin. Dua t'ju them që pyetja e fundit i drejtohet, sipas këtij minutazhi, ministrit të Shëndetësisë nga deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: I adresohet Kryeministrit, me radhë, ose ministrit të Ekonomisë e Financave.

KRYESUESI: Këtu në renditje e kam ministrin e Shëndetësisë.

NASER RUGOVA: Në rregull, po vazhdoj atëherë.

Zot ministër i Shëndetësisë, ditë më parë Ministria që ju e kryesoni ka ndarë një buxhet shtesë për trajtimin jashtë vendit të pacientëve me probleme kardiovaskulare, kardiokirurgjike, por edhe të natyrave të tjera. Sa është shuma e këtyre mjeteve, si dhe ku do të trajtohen këta pacientë? Deri kur do të vazhdojë praktika e daljes jashtë Kosove të parasë publike, si dhe pse nuk orientohen këto mjete për ndërtimin e Klinikës së Kardiokirurgjisë, e cila do t'i mbulonte nevojat e pacientëve kosovarë dhe njëherë e përgjithmonë do ta zgjidhte këtë problem jetik për pacientët dhe shëndetësinë kosovare.

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit!

Ne jemi duke i shëruar plagët e hapura. Që nga viti 2003 janë 585 pacientë të kualifikuar për kardiokirurgji. Në republikën e Kosovës nuk ka kardiokirurgji. Njëra prej çështjeve, e cila është shumë mirë të sqarohet, iu përket mjeteve. Që nga 10 janari i vitit 2008, ju garantoj se asnjë zyrtar i lartë i Republikës së Kosovës dhe asnjë anëtar i familjes së tyre nuk ka përdorur mjete nga ky fond. Të gjitha mjetet e ndara për këtë vit deri në muajin 6, kanë qenë të ndara 500 mijë euro dhe me mirëkuptimin e Qeverisë dhe

të Kuvendit, janë liruar edhe 2 milionë, me shpresë se deri në fund të këtij viti ne nuk do të kem asnjë pacient, i cili nga viti 2003 e deri në fund të vitit 2008 ka kërkuar trajtim jashtë vendit.

Nën dy, asnjë pacient nuk shkon për trajtim jashtë vendit nëse, nën një, s'e ka rekomandimin e mjekut, i cili shkon në komisionin profesional të Qendrës Klinike Universitare. Ai Komision profesional e rekomandon te Komisioni për vlerësim mjekësor, pas kalimit të komisionit për vlerësim mjekësor shkon te Bordi ekzekutiv, i cili ia rekomandon ministrit të Shëndetësisë dhe ministri i Shëndetësisë ka të drejtë deri në vlerën 3 mijë euro të nënshkruajë vetë, kurse nëse ajo profakturë është mbi 3 mijë euro, atëherë së bashku me ministrin e Ekonomisë dhe Financave kanë mandat të nënshkruajnë deri në 30 mijë euro dhe nëse kjo shumë është më e lartë, atëherë ne shkojmë në mbledhje të Qeverisë.

Ju garantoj se deri më sot të gjitha këto procedura janë përfillur. Jemi të vetëdijshëm se duhet të ndërtohet Kardiokirurgjia. Ne i kemi ndarë mjetet për adaptimin e hapësirës në Qendrën Klinike Universitare, por Kardiokirurgjia do të thotë dije, e cila aktualisht nuk ekziston në vendin tonë dhe ne jemi në pritje që Kuvendi i Kosovës ta miratojë Ligjin për partneritetin publiko-privat, për të cilin ne jemi të përgatitur që në këtë partneritet publiko-privat, me një tender ndërkombëtar ta kemi Kardiokirurgjinë në Republikën e Kosovës. Kemi bërë përpjekje që gjatë këtij viti t'i sjellim ekipet e kardiokirurgëve, e kemi pasur...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Zoti Rugova, a keni pyetje shtesë? Fjalën e ka zoti Rugova!

NASER RUGOVA: Zoti ministër, pergjigja ishte e përgjithësuar. Kam pasur nderin të jem nënshkruar i atij memorandumit që kardiokirurgët italianë nga Sando Nato Ospotalo dhe Regjiono Margarita në Torino, do të thotë, na kanë shprehur edhe vullnetin, edhe gatishmërinë që ta ndihmojnë zhvillimin, ndërtimin dhe rritjen e Klinikës së Kardiokirurgjisë. Kjo gjë nuk po ndodhë tash e katër vite me radhë.

Qeveria dhe Ministria që ju e kryesoni, nuk e keni paraparë në prioritet e juaja fillimin e ndërtimit të kësaj klinike tejet të rëndësishme për Kosovën dhe pacientin e lodhur kosovar. Deri të bëhet ai ligj i partneritetit privato-publik, kam frikë se do të kalojnë edhe nja 5 vite të tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër!

ALUSH GASHI: Zoti deputet, Qeveria e Republikës së Kosovës në tërësi e ka zbatuar marrëveshjen të cilën e keni nënshkruar ju, e cila nuk ka qenë aso kohe e ratifikuar as nga ministri.

Ne e kemi ftuar Klinikën e Sando Natos, profesor Mazola me ekipin e tij ka ardhur, ka operuar në Prishtinë, i kemi bërë ofertë për vazhdimin e punës, por jo për vizitat të kohëpaskohshme. Nëse ata janë të gatshëm, ne e kemi ofertën me shkrim, por ne do të dëshirojmë që ta kemi Kardiokirurgjinë gjatë tërë vitit. Ne i kemi mjetet për fillimin e asaj pune, por nëse nuk ka gatishmëri deri në miratim të ligjit për këtë formë, ne jemi të gatshëm ta zbatojmë partneritetin publiko-privat.

Dhe, nën dy, kardiokirurgëve kosovarë që punojnë jashtë, iu kam ofruar të ardhura të negociuara vetëm për të ardhur të punojnë në vendin tonë. Prandaj, këto tri mundësi janë të hapura dhe unë jam i bindur që në Kardiokirurgjinë të cilën nuk kanë mundur ta formojnë këtu që 60 vjet, ne do ta kemi brenda një viti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Konstatoj që minutazhi prej 50 minutash, që është paraparë me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës, ka kaluar dhe mbetin pyetjet e tjera që ministrat t'iu përgjigjen në seancën e nesërme dhe më tutje, në vijimësi sipas radhës.

Vazhdojmë me pikën e tretë e rendit të ditës:

3. Interpelanca e ministrit të Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Aleancës Kosova e Re

Në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit, Grupi Parlamentar i AKR-së i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me kërkesë për ta ftuar në interpelancë ministrin e Punëve të Jashtme, Skender Hyseni.

Në afatin e paraparë me Rregullore të Punës, ministri i është përgjigjur ftesës për interpelancë. Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 25.2 të Rregullores së Punës, debati për interpelancë mund të zgjasë deri në 2 orë. Sipas Rregullës 25.7, Grupi Parlamentar i cili ka kërkuar interpelancën mban të drejtën e fjalimit në debatin në kohëzgjatje deri në 10 minuta, dhe në përmbyllje të debatit deri në 5 minuta.

Koha e ndarë për grupet parlamentare do të reflektojë përfaqësimin e tyre në Kuvend.

Ftoj Kryetarin e Grupit Parlamentar, zoti Ibrahim Makolli, që ta marrë fjalën lidhur me kërkesën e bërë. Atëherë, në vend të Ibrahim Makollit, ftoj Ibrahim Gashin.

IBRAHIM GASHI: I nderuari zoti kryesues,
I nderuari zoti Kryeministër,
Të nderuar ministra,
Të dashur deputetë,

Bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Rregulla 25/1, Grupi Parlamentar i Partisë Aleanca Kosova e Re, thërret në interpelancë ministrin e Punëve të Jashtme, zotin Skender Hyseni.

Falënderojmë Kryesinë e Kuvendit dhe juve, të nderuar kolegë deputetë, që e keni aprovuar dhe me debatin tuaj sot po i kontribuoni funksionalizimit të misionit mbikëqyrës që ka legjislativi ndaj Qeverisë. Me këtë akt, ne po i mbrojmë parimet themelore të demokracisë, kur miqtë tanë kanë drejtuar sytë nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Grupi parlamentar i AKR-së, por edhe opinioni i gjerë kosovar, tashmë ka parë qartë ngecjen e madhe që ka ndodhur dhe po ndodhë në ndërtimin e strukturës së Ministrisë së Punëve të Jashtme, hartimin e strategjisë afatshkurtër dhe afatmesme të politikës së jashtme të Kosovës, vonesën e madhe të pajustificueshme në ndërtimin e shërbimit

diplomatik të Kosovës dhe për pasojë ngathtësinë e theksuar deri në shkallë dështimi në çështjen e lobimit për njohjen e shtetit të Kosovës nga shumica e vendeve anëtare të OKB-së.

Dua të filloj nga e para. Nga momenti i hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor, kur duhej të shpalosej një platformë e detajizuar e Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke qenë se ministri ishte nominuar rreth 2 muaj më parë, një gjë e tillë nuk ndodhi. As sot, më shumë se tre muaj pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, ministri Hyseni nuk ka prezantuar këtë platformë. Në vend të saj, kjo Ministri ofron në Ueb faqen e saj të pandërruar akoma një dokument të cilin e quan Program. Është ky dokument, të nderuar kolegë deputetë, që asnjëherë nuk është prezantuar as në Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme, as në Kuvend, e kam përshtypjen as në Qeveri, sepse nëse Qeveria e ka aprovuar një program të një niveli të tillë amatoresk, atëherë përgjegjësinë nuk duhet kërkuar vetëm te zoti Hyseni.

Këtu e kam dokumentin i cili gjendet në Ueb-faqen e Ministrisë, i cili është në Word 5 faqe, është dokument që shpreh me fjali dëshirore, si të them, pa asnjë rrugë implementuese dhe plan implementimi. Madje, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ky i ashtuquajtur Program nuk gjendet në gjuhën angleze.

Të nderuar kolegë,

Si pasojë e mungesës së një programi të parapërgatitur, kjo Ministri nuk ka arritur as tani, tre muaj pas formimit të saj, të krijojë në strukturë dhe një staf efektiv i cili mund të marrë përsipër përgjegjësinë e madhe që e ka kjo Ministri në procesin e shtetndërtimit të Kosovës.

Në këtë Ministri akoma nuk ekziston një njësi për planifikim, për më tepër, Qeveria akoma nuk e ka emëruar as zëvendësministrin për Punë të Jashtme.

Gjendja bëhet edhe më pesimiste kur kihet parasysh mënyra e përzgjedhjes së kuadrove të para në këtë Ministri. Jotransparenca dhe nepotizmi i theksuar ka rezultuar që këtu më shumë të ketë gjuhëtarë dhe përkthyes, dhe pothuaj asnjë të kualifikuar dhe me përvojë në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Kam bindjen se këto elemente dhe preferencat partiake janë shndërruar në kritere bazë për t'u punësuar në këtë Ministri. Rast eklatant i përzgjedhjes është kur dy anëtarë të komisionit filtrues zgjedhin veten për zyrtarë të lartë në këtë Ministri, dhe ndodhë, po ashtu, që në këtë Ministri për drejtor në zyrën për Çështje Rajonale të emërohet një drejtues i emisioneve për tinejxher.

Kjo që sapo përshkrova, është vetëm një sekuençë e pamjes së zymtë që sot mbretëron brenda mureve të asaj që veten e quan Ministri e Punëve të Jashtme të Kosovës.

Nuk do studim se konsekuencat e mosndërtimit të strukturës efektive dhe profesionale, determinojnë pashmangshëm ngecjet shumë të mëdha edhe në dy segmente të tjera shumë të rëndësishme, që ka si mision kjo Ministri: ndërtimin e Shërbimit diplomatik dhe lobimin.

Të nderuar deputetë,

Pas 17 shkurtit 2008, Kosova e inkurajuar dhe e përkrahur nga fuqitë mike e deklaroi veten si shtet të pavarur dhe sovran. Logjika thotë që nga ajo kohë Kosova duhej të sillej ndaj vetvetes dhe të tjerëve si subjekt legal i të drejtës ndërkombëtare, duke e iniciuar

fillimin e ndërtimit të marrëdhënieve bilaterale, sidomos me vendet të cilat pa hezitim njohën Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës. Kështu Kosova do të dëshmonte përkushtimin për respektimin e parimeve të reciprocitetit dhe të partneritetit midis vendeve mike dhe Kosovës. Për fat të keq, as kur u nominua ministri i Punëve të Jashtme, një nismë e tillë nuk ndodhi me arsyetimin se pritej hyrja në fuqi e Kushtetutës, një arsyetim jo shumë i qëndrueshëm kur dihet se askush nuk e ndalonte Kosovën që t'i përfundonte përgatitjet finale për hapjen e përfaqësive diplomatike dhe zyrtarizmi i këtyre misionëve të ndodhte në ditën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës.

Megjithatë, të nderuar deputetë, jemi këtu ku jemi. Hapja e misionëve diplomatike nuk ndodhi dhe, për fat të keq, nuk po ndodhë as pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Sot, më 18 shtator, të ngarkuarit me punë në 10 misionet e para diplomatike akoma ndodhen në Prishtinë.

AKR dhe opinioni i gjerë kosovarë ka pritur që më së largu deri më 20 qershor, të ngarkuarit me punë të kishin ngritur, qoftë edhe në hotelet e kryeqyteteve të vendeve pritëse, flamurin e Kosovës, të dorëzonin letrat kredenciale dhe të bëheshin pjesë koreve diplomatike të këtyre shteteve, prej nga shumë fuqishëm do të arrinin të përhapnin të vërtetën për Kosovën dhe të krijonin opinionin dhe disponimin e munguar për njohje të shtetit të Kosovës tek përfaqësuesit e atyre vendeve që nuk e kanë bërë këtë akoma.

Në diplomaci ka një rëndësi të veçantë elementi i faktit të kryer. Prezenca e flamurit dhe e stemës së Republikës së Kosovës në Uashington, në Bruksel, në Londër, Berlin, Ankara dhe në qendra të tjera të vendimmarrjes ndërkombëtare do ta kishte efektin e fuqishëm psikologjik se Kosova tashmë është subjekt legal në marrëdhënie ndërkombëtare ose, të paktën, po sillet si e tillë.

Arsyetimet e ministrit për mungesë të mbështetjes logjistike janë krejtësisht të paqëndrueshme. Vonesa në ndërtimin e shërbimit diplomatik, e cila realisht ka prodhuar konsekuenca të pariparueshme, po të shikohet me një dioptri më të thellë, del se është produkt i impotencës së kësaj Ministrie, e në mos edhe i ndërhyrjeve të shpeshta të interesave partiake të partive në pushtet.

Përzgjedhja dhe dekretimi i 10 të ngarkuarve të parë me punë, dhe së fundi i 10 sekretarëve të parë, është edhe një performancë jokredibile e kësaj Ministrie. Me pak përjashtime, të ngarkuarit me punë nuk posedojnë kredencialet e domosdoshme profesionale e akademike dhe as përvojën në prezantimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Për më shumë, një pjesë e tyre prej kohësh nuk jeton fare në Kosovë dhe pak i njeh realitetet dhe nevojat e këtij vendi, gjë që pamundëson zhvillimin e asaj që njihet si diplomaci publike e shtetit të Kosovës në vendet e akredituara. Derisa shpreh shqetësimin tim për këtë proces, më kujtohet thënia e diplomatit të njohur amerikan Gjorgj Frost Kenan, citoj: “Diplomacia çdoherë do të ketë ambasadorë dhe ministra, por çështja është nëse ajo do të ketë diplomat ndonjëherë”. S’do mend se ky mesazh për Kosovën ka një domethënie të veçantë.

Kosovës në këto momente i duhen diplomat me cilësi dhe shkathtësi të jashtëzakonshme. Suksesi i punës së diplomatëve të parë të Kosovës, fatkeqësisht, do të shihet shumë shpejt se do të jetë i varfër, josubstancial dhe krejtësisht kozmetik. Uroj që të jem i gabuar.

Më lejoni të theksoj se me rastin e emërimeve të të ngarkuarve me punë, është bërë shkelje e Ligjit për themelimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Shërbimit diplomatik, respektivisht neni 7.1 dhe 7.2, duke përjashtuar Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme jo vetëm nga procesi i rekrutimit dhe i intervistimit të kandidatëve, por qoftë edhe nga një informatë e vetme. Do me thënë, ky Komision nuk ka marrë një informatë të vetme.

Praktika e tillë e kundërligjshme e përjashtimit të Kuvendit nga i gjithë procesi i formulimit të politikës së jashtme dhe i ndërtimit të Shërbimit diplomatik, të nderuar deputetë, nuk ndodhë në asnjë vend që aspirojnë apo është vend me demokraci të zhvilluar. Për më tepër, këtu ndodhë që ministri të mos gjejë kohë as vullnet të paraqitet para Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme. Paraqitjen e djeshme në Komision, e shohim si përpjekje për të humbur rëndësinë e debatit të sotëm.

Kuvendi i Kosovës është privuar nga misioni i tij mbikëqyrës në këtë Ministri edhe me rastin e vendimit të Qeverisë, të marrë në mbledhjen e 27 gushtit për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 25 milionë eurosh që do të përdoren për blerjen e ndërtesave për përfaqësitë diplomatike dhe konsullore jashtë vendit. Unë dua të përmendi këtu vetëm rastin e Maqedonisë, e cila si shtet është pavarësuar në vitin 1991, dhe vetëm në vitin 2006 ka ndarë një pjesë të parë të buxhetit për të blerë patundshmëri për vendosjen e misioneve diplomatike jashtë vendit.

Ngecjet e sipërpërmendura të Ministrisë dhe të ministrit, përveç tjerash janë reflektuar ndjeshëm edhe në segmentin e lobimit që pas 15 qershorit, do të duhej të ishte pjesë e rëndësishme e strategjisë së kësaj ministrie, ani pse ministri dje çuditërisht tha se ky nuk është mision i yni kryesor.

Ndërtimi i marrëdhënieve bilaterale me shtetet anëtare të OKB-së është rruga e vetme për legjitimimin e statusit të ri dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB.

Objektivi strategjik afatshkurtër i diplomacisë kosovare është njohja nga vendet fqinje dhe të gjitha vendet e BE-së, e theksoj, sepse perspektiva evropiane e Kosovës sfidohet rëndë nëse shpejt nuk kemi njohjen e 27 vendeve të Bashkimit Evropian. Këtë imperativ, si duket, nuk e ka kuptuar seriozisht ministri....

KRAESUESI: Ju kanë kaluar 10 minutat e paraparë. Për ta përmbyllur fjalën, një minutë e ke shtesë.

...Ju faleminderit!

Do t'i lexoj vetëm pyetjet. Të nderuar deputetë, Grupi Parlamentar i AKR-së, shqetësimet e tija dhe të opinionit të gjerë mbi punën e ministrit Hyseni dhe të Ministrisë që ai drejton, do t'ia adresoj këtu para Kuvendit, si organ më i lartë legjislativ, në formën e pyetjeve për ministrin:

1. Si është e mundur që, zoti ministër, keni marrë postin dhe keni qeverisur 3 muaj pa një program dhe plan të qartë veprimi?

2. A keni strategji të shkruar afatmesme të zhvillimit të diplomacisë, të politikës së jashtme të Kosovës, që të mund ta prezantoni sot?

3. A mund të na i numëroni kriteret e përzgjedhjes së 10 të ngarkuarve të parë dhe të ndihmësve të tyre dhe a keni marrë pjesë ju në përzgjedhjen e tyre?

Kemi informatë se Kosova në dhjetë vendet e para nuk do të ofrojë fare shërbime konsullore, aq shumë të nevojshme dhe shumë të pritura nga diaspora jonë. Si është menduar kjo zoti ministër? Përse zoti ministër asnjëherë nuk keni publikuar qëndrimet zyrtare në ndonjërin nga...

KRYESUESI: Ju faleminderit! Gjatë diskutimit mund t'i shfrytëzoni pyetjet, t'ia shtroni ministrit. Edhe ky e ka të drejtën në fund. Zoti Hyseni, e keni fjalën!

MINISTRI SKENDER HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti Kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar kolegë ministra,

Siç e dini, Ligji për themelimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës është miratuar më 13 mars 2008, ndërsa ministri i Jashtëm është nominuar më 4 prill 2008.

Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme ka hyrë në fuqi më 16 qershor. Kjo datë ka shënuar momentin ligjor të themelimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe kjo, pa dyshim, ishte një ngjarje historike për shtetin e Kosovës.

Themi kështu për dy arsye: Së pari, ushtrimi i politikës së jashtme është tipar dallues i shteteve sovrane dhe, së dyti, kjo Ministri u themelua në kohën kur Kosova ka nevojë më së shumti të jetë e pranishme në arenën politike ndërkombëtare. Si e tillë, Ministria e Punëve të Jashtme ka mandat ligjor që të jetë përçuesi dhe mbrojtësi i interesave të Kosovës dhe të qytetarëve të saj jashtë vendit. S'do mend se aktualisht interesat parësore të Kosovës dhe të qytetarëve të saj mund të përmbledhen në një fjalë: Përshpejtimi i procesit të njohjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Duke u nisur nga kjo, unë si ministër dhe bashkëpunëtorët e mi, që nga themelimi kemi pasur dy prioritete kryesore në punën tonë. Së pari, ndërtimi dhe funksionalizmi i Ministrisë dhe, së dyti, zhvillimi i kontakteve dhe i veprimeve të tjera për të përshpejtuar këtë proces. Gjithsesi, ndërtimi dhe funksionalizmi i Ministrisë është parakusht për veprime efikase të saj në kuptim të asaj që quhet lobim për njohjen ndërkombëtare të shtetit të Kosovës.

Përpos dy aspekteve të lartë cekura, aspekti i tretë i punës së Ministrisë ka të bëjë me funksionet që i kryen çdo ministri, do të thosha e jashtme, në rrethana normale. Kjo nënkupton, ndër të tjera, garantimin e privilegjeve dhe të imuniteteve diplomatike të përfaqësive të huaja, nënshkrimin dhe ratifikimin nga parlamentet, natyrisht, të marrëveshjeve dhe të traktateve ndërkombëtare. Pastaj, udhëheqjen, krijimin dhe konstituimin, konsolidimin e misioneve diplomatike jashtë vendit, e kështu me radhë. Ministria e Jashtme është e angazhuar në kryerjen e të gjitha këtyre funksioneve.

Të nderuar deputetë,

Në vijim do të paraqes para jush një ekspozitë të shkurtër të punës që ka bërë Ministria, gjithnjë duke pasur parasysh çështjet që i keni shtruar në kërkesën tuaj për interpelancë

dhe, kuptohet, do t'u përgjigjem me kënaqësinë më të madhe pyetjeve dhe komenteve tuaja.

Një nga prioritetet kryesore të angazhimeve të Ministrisë, që nga dita e themelimit, ka qenë ndërtimi i strukturave dhe funksionalizimi i tyre dhe kjo, të nderuar deputetë, nuk është punë e lehtë. Në rastin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, kjo bëhet edhe më sfiduese kur kihet parasysh mungesa e përvojës, e traditës diplomatike të Kosovës, sidomos sa i përket shërbimit të jashtëm si dhe mundësitë e kufizuara financiare. Gjithsesi, këtu hy edhe koha e shkurtër, në njërën anë, dhe nevojat e mëdha që ka Kosova në planin e diplomacisë, në anën tjetër.

Që ditët e para të emërimit tim, kam themeluar një ekip të veçantë për t'u marrë me organizimin strukturor dhe funksionalizimin e Ministrisë. Ky ekip ka përgatitur organogramin ose strukturën, siç quhet, të Ministrisë dhe Udhëzimin përkatës administrativ, si dhe aktet e tjera përkatëse ligjore që kanë qenë të domosdoshme për punën e Ministrisë në atë fazë.

Ministria e Punëve të Jashtme ende ka mungesë të infrastrukturës bazë për realizimin e detyrave dhe të përgjegjësisë. Ende funksionojmë në kushte pune jo optimale, jo për fajin e Ministrisë, jo për fajin e Qeverisë, për fajin e mungesës reale, deficiteve reale që Kosova ka në fusha të caktuara, sidomos në rrafshin e hapësirës së punës dhe të zyrave. Do me thënë, Ministria e Punëve të Jashtme ende nuk ka hapësirë të mjaftueshme për akomodimin e të gjithë stafit civil dhe aktualisht jemi duke punuar ngushtë me Ministrinë e Shërbimeve Publike që këtë problem ta zgjidhim në afat të gjatë dhe mirë.

Në kuadër të procesit të ndërtimit institucional, Ministria e Punëve të Jashtme ka bërë edhe hapjen e konkurseve për rekrutimin e stafit civil. Deri më tani kemi rekrutuar një pjesë të stafit të planifikuar, duke respektuar të gjitha rregullat ligjore në fuqi dhe nën mbikëqyrjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Këto ditë jemi në proces të rekrutimit të pjesës tjetër të stafit.

Më lejoni këtu, të nderuar deputetë, të bëjë një digresion të vogël. Jo gjithmonë, institucionet e Kosovës, e sidomos shërbimi civil nëpër institucione të Kosovës, janë shumë atraktive për një kuadër kulmor në kuptim të cilësisë, fatkeqësisht, për shkak të pagave të ulëta që akoma institucionet e Kosovës janë në gjendje të ofrojnë.

Krahas ndërtimit dhe funksionalizimit të Ministrisë, një ndër çështjet më parësore në të cilën jemi përqendruar gjatë punës sonë, ka qenë procesi i njohjes ndërkombëtare i shtetit të Kosovës.

Që nga dita ime e parë si ministër i nominuar, e mandej si ministër i Punëve të Jashtme, punën për njohjen ndërkombëtare të shtetit të Kosovës e kam konsideruar si çështje me përparësi të dorës së parë. Po e përsëris edhe sot, zoti deputet, Gashi, Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës nuk është ministri për lobim, është Ministri e Punëve të Jashtme e cila ka edhe një varg të madh detyrash të tjera në kuadër të saj. Lobimi është vetëm një dimension dhe një segment aktual i dorës së parë, me urgjencë të jashtëzakonshme, të cilës Ministria e Punëve të Jashtme, por jo vetëm Ministria e Punëve të Jashtme, po edhe ministritë e tjera, edhe institucionet e tjera të Republikës së Kosovës, i janë qasur me seriozitetin më të madh.

Pra, që nga dita e parë në zyrë, së bashku me bashkëpunëtorët e mi, kemi filluar procesin e përgatitjes së analizave dhe të planifikimit të veprimeve që të ndikohet në njohjen ndërkombëtare të Republikës së Kosovës. Duhet të jemi të vetëdijshëm se për shkak të natyrës tejte dinamike të zhvillimeve ndërkombëtare, ne nuk e kemi pasur luksin të bëjmë analiza dhe planifikime të gjata dhe gjithëpërfshirëse. Sido qoftë, kemi bërë analiza të vazhdueshme të qëndrimeve të çdo shteti veç e veç ndaj pavarësisë së Kosovës, në fokus të veçantë të shtetave me ndikim rajonal apo global. Si rezultat, Ministria e Jashtme e ka një pasqyrë të qartë të qëndrimeve të shumicës absolute të shteteve të botës ndaj pavarësisë së Kosovës. Mbi bazën e analizave të tilla, Ministria ka përgatitur dhe zbatuar një plan konkret të implementuar në veprime konkrete që në diskursin tonë të përditshëm po quhen aktivitete lobuese.

Këto aktivitete kanë pasur për qëllim ndikimin e drejtpërdrejtë apo të tërthorët te vendet që ende nuk e kanë njohur shtetin tonë. Ndikimi drejtpërdrejtë përfshin kontaktet e drejtpërdrejta me diplomatë dhe zyrtarë të tjerë shtetërorë të vendeve që nuk na ka njohur.

Ndikimi tërthorët përfshin bashkëveprimin me vendet përkrahëse të Kosovës. Shumica e vendeve që na kanë njohur, si SHBA-të, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia, vendet e tjera të BE-së dhe Turqia, për të shtyrë përpara përmes tyre procesin e njohjes së Kosovës.

Sa i përket ndikimit të drejtpërdrejtë, Ministria e Punëve të Jashtme, që nga dita e parë e punës së saj është angazhuar që të zhvillojë sa më shumë kontakte të drejtpërdrejta, të dyanshme dhe shumanshme, me përfaqësues vendesh që nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës.

Këto takime janë zhvilluar qoftë në kryeqendrat e mëdha botërore, si Nju Jorku, Brukseli apo Vjena, qoftë përmes vizitave direkte në vende të ndryshme. Po ashtu, është shfrytëzuar ndonjë samit shumëpalësh, siç ka qenë Samiti i procesit për bashkëpunim me Evropën Juglindore, në Pomorje, për të zhvilluar takime me ministra të jashtëm, kryeministra vendesh të ndryshme, kryesisht të vendeve ballkanike.

Vazhdimisht kemi bërë përpjekje që të realizojmë vizita të drejtpërdrejta, por kjo, të nderuar deputetë, jo gjithmonë ka qenë e mundur të realizohet jo për fajin tonë, dhe jo gjithmonë ka pasur përgjigje pozitive në kërkesat tona. Duhet thënë qartë, troç, me zë të lartë, shumë vende që nuk e kanë njohur Kosovën, ende hezitojnë të kenë kontakte në nivel të lartë zyrtar me Kosovën sepse, sipas tyre, ky hezitim është rezultat i drojës se takimet në nivel të lartë do të interpretoheshin si njohje implicite ose njohje de fakto të shtetit të Kosovës. Ka plotë vende që nuk duan ta bëjnë këtë para se ta kenë...

KRYESES: Zoti ministër, e keni një minutë për ta përmbyllur fjalën.

...Po dalim krejt shkurt tek çështja e punësimit, përkatësisht ndërtimit të strukturës civile ose të Shërbimi Civil të Ministrisë. E thamë pak më herët që një numër i kuadrove janë punësuar tashmë. Ju siguroj, të nderuar deputetë, se nuk ka pasur familjarizëm, nuk ka pasur nepotizëm në përzgjedhjen e shërbyesve civilë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës. Ka pasur respektim fundamental dhe rigoroz të ligjeve në fuqi dhe të dispozitave ligjore.

Po kështu, sa i përket përzgjedhjes së të ngarkuarve me punë, të 10 të ngarkuarve të parë me punë, nuk ka pasur absolutisht qasje tjetër përpos qasjes fundamentale të respektimit të kriterëve të profesionalizmit, të integritetit moral dhe kombëtar të bartësve të parë që do të dërgohen për të përfaqësuar Kosovën në botën e jashtme. Pak më tepër, në vijim. Ju faleminderit shume!

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë, ju njoftoj se koha është e ndarë mbi bazën e fuqisë së grupeve parlamentare. PDK-ja -37 minuta; LDK -25 minuta; AKR-13 minuta; AAK -10 minuta; LDD-11 minuta, Grupi Parlamentar “7+” - 7 minuta; SLS- 3 minuta.

Vazhdojmë. Për fjalë është i lajmëruar deputeti Numan Baliq.

Mirë, më fal Numan! Shkojmë me shefat e grupeve parlamentare. Shefi i Grupit parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, e ka fjalën.

RAMË BUJA: I nderuar, zoti Kryetar,

Nuk e di si është kjo natyrë edhe ky rregull që edhe në interpelanca të kërkohet gjithsesi deklarimi i shefave të grupeve parlamentare. Kjo është një liri e plotë e deputetëve që të lajmërohen ose të mos lajmërohen për të thënë diçka ose për mos të thënë. Por, megjithatë, meqë e mora fjalën, po i them disa fjalë. Edhe unë konsideroj se interpelanca është një punë e mirë, një punë shumë e mbarë, një punë që është forma më e mirë e mundshme e kontrollit të Qeverisë që mund t’i bëhet edhe në këtë sektor dhe në sektorët e tjerë dhe, natyrisht, për ministrat që gjithsesi i kemi të gjithë esëll dhe janë mirë në nivel të detyrës së tyre, por i mobilizon dhe i sfidon njëkohësisht dhe i bënë që të jenë më në nivel të detyrës. Unë po them që mbase është pak e tepruar ajo që kërkohet, por është detyrë e opozitës që të kërkojë gjithnjë më shumë, bile edhe e pozitës, sepse është një kohë tepër e shkurtër, tepër e shkurtër kur kemi aprovuar Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe mundësitë që kanë qenë bukur shumë të kufizuara për t’u konsoliduar si strukturë ministrore dhe puna që është bërë.

Unë dakordohem me ministrin, në veçanti në pjesën ku, edhe pse opozitarët qeshën, lobimi nuk është esenca e Ministrisë së Punëve të Jashtme, do me thënë, është pjesëz e Ministrisë së Punëve të Jashtme, por detyrat e Ministrisë së Punëve të Jashtme janë më të mëdha, shumë më të mëdha se sa vetë lobimi. Por, meqë ne jemi një rast dhe vazhdojmë të jemi sui generis akoma, edhe kjo puna e lobimit bie si punë numër një për çështjen e Kosovës, andaj unë po them që Grupi Parlamentar, natyrisht se për kaq punë që është bërë me këto mundësi që i ka pasur, jep përkrahje dhe përgëzon ministrin dhe dëshiron që angazhimi i tij të jetë shumë më i madh se sa ishte deri me sot. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju Faleminderit! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

E falënderoj ministrin Hyseni për paraqitjen e tij dhe për kohën që pati, në mënyrë që t’i përgjigjet Grupit Parlamentar të AKR-së në kërkesën për interpelancë.

Ne deputetët, anëtarë të Komisionit për Politikë të Jashtme, dje e kemi pasur rastin të kemi një dëgjim nga ana e ministrit më të gjatë dhe në bashkëbisedim për të parë angazhimet, sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet ministri dhe Ministria e Jashtme.

Grupi Parlamentar i LDK-së, sigurisht që e mbështet angazhimet dhe përkushtimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, të ministrit në realizimin e politikave, të programit qeveritar, të kërkesave të Kushtetutës në realizimin e detyrës së tij.

E kuptojmë dhe e mbështesim në ndërtimin e kapaciteteve më të mira të mundshme, edhe pse themelimi i institucioneve në Kosovë këto 9 vite ka treguar qartë se është shumë i vështirë, është mision kapital për çdo autoritet, por në të njëjtën kohë edhe problemet e mëdha me kufizime buxhetore dhe me probleme të tjera që ballafaqohemi çdo ditë.

Ministria e Jashtme nuk ka përjashtim, është në këtë rrugë e cila do t'i përballojë dhe duhet t'i përballojë këto probleme që i ka.

Koordinimi ndërinstitutional në realizimin e politikave të jashtme është njëra nga sfidat që edhe dje e kam paraqitur para ministrit. Kushtetuta ia njehtë drejtën, politikën e jashtme edhe Presidentit, edhe Kryeministrit të vendit, por edhe Grupit parlamentar si pjesë e institucionit të Kuvendit, që në këto angazhime të ketë detyra konkrete apo përgjegjësi konkrete.

Është njëra nga sfidat që ministri sigurisht do të duhej ta ketë para sysh dhe duhet të punojë më shumë në koordinimin e krejt këtyre aktiviteteve, në mënyrë që politikat e jashtme të jenë të koordinuara dhe në këtë fazë të realizimit Kosova duhet të kalojë në ofensivë diplomatike, duhet të kalojë në ofensivë diplomatike sepse rasti i djeshëm në Kombet e Bashkuara tregoi qartë që një agresivitet diplomatik duhet të ngrihet në Kosovë nën kujdesin e ministrit, por në koordinim edhe me kërkesë të vazhdueshme që Presidenti, Kryeministri dhe diplomacia parlamentare në këtë fazë të jetë e koordinuar, e sinkronizuar dhe e paraqitur, e plasuar atje ku duhet të jetë për aq sa kemi fuqi dhe mundësi, duke mos harruar asnjëherë rolin dhe mbështetjen e diplomacive të mëdha që e kanë ndihmuar Kosovën të vijë deri në këtë ditë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kryeministër,

Zoti ministër i Punëve të Jashtme,

Mendoj se disa çështje janë thënë më herët, nuk do t'i përsëris, edhe nga vetë kërkuesit e interpelancës sot.

Unë do t'i them disa çështje të tjera dhe do t'i ngrejë disa pyetje këtu. Do të tentoj që vetëm shkurt, nja një minutë të polemizoj me ato që tha ministri për shkak se janë shumë interesant.

Çështja është pak më e gjerë se vetëm te Ministria e Punëve të Jashtme. Politika e jashtme e Kosovës nuk është vetëm e ministrit të Punëve të Jashtme, është edhe e Presidentit, është edhe e Kryeministrit, mirëpo në këtë rast flamurin e ka ministri i Punëve të Jashtme, sepse e ka pranuar detyrën dhe pjesa dërmuese e barrës i bie ministrit të Punëve të Jashtme.

Pyetja e parë vjen pas këtij deklarimi: A ndjeheni përgjegjës, zoti ministër, a ndjeni përgjegjësi dhe tregona, thuana jo, nuk ndiej kurrfarë përgjegjësie për këtë që po ndodhë, ose po, pak përgjegjësi, shumë pak, po tregoni a ndieni përgjegjësi ju. Duhet të tregojë Presidenti i Kosovës a ndien përgjegjësi sado pak qoftë, edhe Kryeministri i Kosovës duhet të tregojë, por ne duhet ta dimë se a ka dikush në Kosovë që ndien vetëm pak përgjegjësi për situatën në të cilën jemi. Thuana jo, ju lutem, nëse nuk ndieni, por ta dimë të paktën.

Çështja tjetër është joserioziteti. Do të flas pak për joseriozitetin e punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ju lutem, klikoni në Ueb faqe dhe te zëvendësministri do ta shihni një fjalë që shkruan Coming soon. Ju lutem, nuk është fjala këtu a është emëruar zëvendësministri apo jo, por fjala është që dikush nuk ka ditë të vë re se çka po shkruan. Për filma që vijnë në kinema shkruhet Coming soon, jo për një zëvendësministër. Kjo tregon sa jo serioze është ajo ministri. Janë diku 40 – 50 njerëz, njerëz, po edhe Alibaba ua ka ditur emrat 40 vetëve që i ka pasur, e lëre më ju që i keni më të ndershëm se ata që kanë qenë.

Çështja tjetër është se ministri na tha që nuk ka nepotizëm. Qysh, bre, nuk ka nepotizëm, kur vëllai i njërit prej zëvendëskryeministrave është emëruar sekretar në Romë. A është ky nepotizëm a jo, apo unë nuk po e di çka është nepotizmi?! Ju lutem, të jeni të saktë. Ministri na tha, i kam tre muaj. Shikoni, prej muajit mars të këtij viti, ne e kemi parë ministrin që ka marrë pjesë në mbledhje të Qeverisë, është ulur aty, është paraqitur si ministër i Punëve të Jashtme dhe nuk e ka bërë organogramin deri në qershor. Ka ardhur qershori dhe thotë tash, unë veç qe dy muaj a tre jam ministër. Po pse na ke thënë që je ministër prej marsit, pse të ka emëruar Kryeministri prej marsit, çka ke bërë prej marsit deri në qershor, apo veç ke ndejë dhe je paraqitur si ministër i Punëve të Jashtme.

Dje na ka thënë, lobimi nuk është puna më kryesore, ka punë shumë më të mëdha. Njerëz, se a kemi për ta ndrequr ne krizën në Lindjen e Mesme, a çka ka për të bërë Kosova? Puna më kryesore e Kosovës është njohja. Ne po i themi lobim, por është puna rreth njohjes, nuk ka të bëjë me lobimin. Çka ka Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës punë tjetër? Ju lutem, nëse dikush di të më tregojë, le të më tregojë. Po ju them tash edhe për moskompetencën totale të Qeverisë së Kosovës. Juve ju kujtohet këtu, e kemi përmendur edhe më përpara, ne kemi dëgjuar shprehje të tilla, ndoshta të vetëkuptueshme, që i kanë bërë dëm Kosovës. Ne të gjithë e dimë, nuk keni nevojë ta na vizatoni ju neve në Qeveri. Mirëpo, fjala njohje kualitative është fjalë e cila i fyen krejt vendet të cilat nuk na kanë njohur. Ne e kemi dëgjuar prej Qeverisë këtë fjalë. Ne e kemi dëgjuar, për shembull, edhe terma të tjera shumë të panevojshme. Ne nuk i krahasojmë njohjet që i kemi marrë me ato që kemi për t'i marrë, këto janë krejt të vetëkuptueshme. Njerëzit që merren me diplomaci e dinë që nganjëherë nuk është mirë të thuhet se dikush tjetër fyhet dhe kur njerëzit fyhen, atëherë na nuk kemi çka të shkojmë dhe t'ju themi atyre – “pse bre nuk na keni njohur deri tash”.

Çështja është kështu. Kur iu thashë a ndieni përgjegjësi, ju lutem, tregoni sa ministra të jashtëm i keni takuar vetëm, nëse nuk ju kanë pritë tregona a nuk po na donë ata neve, a nuk po ju donë juve, a nuk po e donë popullin e Kosovës e Kosovën, apo nuk po ju donë juve, se përgjigje duhet dhënë. Nuk mund të vijë e të na thotë ne ministri i Punëve të Jashtme: “po nuk po na donë ata neve dhe nuk po na presin”. E, kënd ta akuzojmë ne? Kujt t'i themi që Kosova i ka fajet. Ne dikujt duhet t'i themi që i ka fajet. Këto janë disa prej çështjeve që unë shumë seriozisht është dashur t'i ngreh për shkak se Kosova

është e të gjithë neve, ne jemi këtu populli i Kosovës në Kuvend, ju jeni Qeveria e Kosovës që e keni marrë një detyrë t'i shërbeni popullit dhe Kuvendi ju ka kontraktuar dhe nuk mund të vini e të na thoni se ka çështje të cilat nuk bën na t'ua kallëzojmë juve. Ju mund të vini e të na thoni se ka çështje të cilat duhet t'jua tregojmë ndoshta në seanca të ndara e jo publike, mirëpo nuk mund t'i thoni ju njeriut ose institucionit që ju ka punësuar: - "nuk kemi çka ju tregojmë ne juve". Këto janë bazat më elementare të demokracisë. Unë e di se në Kosovë demokracia nuk është në nivelin më të lartë, por janë shumë çështje serioze.

Ministri e përmendi mungesën e traditës. Ne e kemi ditur krejt që ka mungesë të traditës, por mos i punësoni njerëzit e juaj në punë atje se ndoshta ka ndokush që nuk është vëllai i juaj e që ka pak më shumë traditë. Kur i punësoni njerëzit e juaj, normal që rritet pak ajo mungesa e traditës.

I përmendi ministri pak pagat e vogla. Shikoni, ministri sikur edhe unë, sikur edhe shumë njerëz që janë mbrapa të ulur si ministra, kryeministra, zëvendëskryeministra dhe shumë prej jush që tetë vite jeni pjesë e institucioneve të Kosovës. Qysh bre nuk e keni ditur deri më tash që rrogat janë të vogla? A tash na ka rënë ndërmend që janë rrogat e vogla. Po ne që tetë vjet jemi, zoti Hyseni, unë, prej vitit 2001 jemi në institucione me të njëjtat rroga, me ndryshime shumë të vogla. Çfarë arsytimi është tash të thuhet që rrogat janë të vogla, që s'e paskemi ditur na kur është themeluar Ministria e Punëve të Jashtme, që rrogat janë të vogla.

Pyetja tjetër për ministrin është, për shembull, sa vende i ke vizituar dhe, të lutem, pse ke shkuar në Shqipëri me datën 3 shtator. Çka ke pasur nevojë kur ministri i Jashtëm i Shqipërisë të thërret në telefon për çdo dy ditë, kur ka pasur për të ardhur në Prishtinë pas dy javëve. Pse shkove, çka pate nevojë t'i humbësh dy ditë për të shkuar në Shqipëri. Pse nuk shkove në një vend që nuk na ka njohur, ose pse nuk ia dhe mesazhin ministrit Basha me telefon. Ai do ta kishte marrë, e kemi mik, ai na do, na ka pranuar dhe po na ndihmon.

Këto janë disa çështje. Nuk po dua t'ua marrë shumë kohën kolegëve të tjerë. Mendoj se ka pyetje mjaft. Njerëzit donë përgjigje, ne dikujt duhet t'i themi që i ke fajet, të paktën pak. Nuk po duam ne të themi se veç Kosova ka faj, ne i dimë rrethanat, jemi të vetëdijshëm, por dikush në Kosovë duhet të thotë, unë kam pak faj, vetëm pak. Pse erdhi situata kështu qysh erdhi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radha është e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Nëse shikojmë dhe analizojmë punën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, atëherë me plotë kuptim mund të themi se kjo ministri paraqet kulmin e dështimeve të saja, kulmin e dështimeve të kësaj Qeverie. Pse? Politika e jashtme e Kosovës nuk mund të pritet ndryshe nga ajo politika e brendshme. Kosova ka politikë të jashtme aq sa ka kjo Qeveri shtrirje të pushtetit në Veri të Kosovës. Kjo Qeveri ka politikë të jashtme dhe funksionale e të organizuar aq sa kemi të organizuar sistemin ekonomik, aq sa kemi të organizuar energjetikën, sistemin shëndetësor, drejtësinë në veçanti, e kështu me radhë.

Pra, nuk mund të presim që dështimet e kësaj Qeverie të jenë më të vogla se sa dështimet që janë në sferat tjera. Këtu duhet ta kujtojmë vetëm një fjalë që është shumë e re, që e dëgjuam mbrëmë përmes mjeteve të informimit, se kjo Qeveri merret me pasoja. Njëherë duhet të ndodhë diçka, pastaj ne të planifikojmë ndonjë strategji të caktuar.

Ministrin e Punëve të Jashtme mbrëmë patëm rastin ta dëgjojmë, se nëse kalon propozimi i Qeverisë serbe në Asamblenë e OKB-së, atëherë ne do të ndërtojmë strategji lobuese për t'iu kundërvënë pasojave të mundshme. Ja, kjo është filozofia e kësaj Qeverie. Deri këtu mund të presim rezultat dhe deri këtu mund të presim se diçka Kuvendi i Kosovës, apo qytetarët e Kosovës, nesër një valë të re njohjesh, jemi krenar për njohje kualitative dhe gjithçka që lidhet me pavarësinë e Kosovës.

Qytetarët e Kosovës e kanë shumë të qartë se Kosova gjendet në një gjendje specifike, e kjo gjendje specifike kushtëzon një angazhim shumë më të madh, një angazhim shumë të ngjeshur, që Qeveria e Kosovës fatkeqësisht asnjëherë nuk e ka kuptuar.

Duhet të rikujtojmë ministrin e Punëve të Jashtme se ndërmjet deklaratës publike dhe prononcimit publik, siç e quan ai vet, dhe realitetit faktik, është një diskrepancë e madhe. Kjo Qeveri asnjëherë nuk ka treguar se ka ndonjë vizion të caktuar, ka ndonjë strategji apo politikë të caktuar sa i përket procesit të lobimit apo të shtrirjes së mëtejme të njohjes së pavarësisë.

Nuk kemi arritur edhe më tutje, u tha nga kolegët, të ndërtojmë shërbime diplomatike, nuk kemi intensifikim të njohjes edhe pse shtatori, është premtuar se në shtator do të pritet një valë e re njohjesh.

Si parti opozitare jemi shumë të shqetësuar me mungesën apo mosdijësinë, moskapacitetet e kësaj Qeverie për t'i involvuar resurset njerëzore në kuadër të politikës së jashtme, në kuadër të procesit të lobimit. Ky mbetet hendikepi kryesor i kësaj Qeverie.

Ministri Hyseni duhet publikisht të sqarojë, pse edhe kjo Qeveri, që është fill e re, në startin e punës së vet nuk arriti t'i shmangët kancerit të shoqërisë tonë, i cili është nepotizmi, joprofesionaliteti, korniza partiake, e kështu me radhë. Derisa Kosova sot ka nevojë më shumë se kurrë për një prezantim adekuat në arenën ndërkombëtare, sikurse tek ne mjaftojnë që të kemi vizitë në Shqipëri apo një javë rresht të propagandohet për vizitën e ministrit të Punëve të Jashtme në Çeki. Ja, deri këtu ka shkuar krejt misioni diplomatik i Kosovës deri tash.

Thënë shkurt, për t'u lënë hapësirë edhe deputetëve tjerë për shkak kohës së kufizuar, nëse do të kishte një njësi matëse që do t'i maste rezultatet e punës së kësaj Qeverie, atëherë kjo do të ishte e barabartë sikurse të mos ekzistonte fare kjo ministri. Pra, edhe sikur të mos kishim fare ministër dhe ministri përkatëse, jeni të bindur se këtë rezultat do ta kenë. Pothuaj se Qeveria e Kosovës nuk e ka ndërmend të veprojë ndryshe dhe Qeveria e Kosovës përfundimisht është pajtuar me fatin se Kosova nuk ka nevojë për diplomaci, se politikën e jashtme Kosovës do t'ia bëjnë miqtë tanë ndërkombëtar.

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Fjala është për shefin e Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Dame i gospodo,
Gospodine predsjedniče,
Zamenici prejimera, ministri i kolege,
Mislim da smo danas načeli jednu, ja bih rekao, i najaktuelniju temu kojom se bavi kosovska javnost, štampa, medije i dakle nije svejedno ako rezimiramo proces od proglašenja nezavisnosti do danas za ovih 7 meseci. Većina nas misli da nas nije dovoljan broj zemalja priznao. To je jedna realnost i ako ovo kažemo, mi ne treba jedni drugima da okrećemo glavu u pozitivnom ili negativnom smislu, ako govorimo u interesu svih građana, u interesu svih građana Kosova, ako govorimo u interesu države kojoj pripadamo.

Svakako da današnja tema otvara niz pitanja koje smo čuli od kolega a neka pitanja još nisu postavljena i tako dalje.

Ja, kao predstavnik jedne od manjinskih zajednica, očekivao sam od našeg ministra Inostranih poslova da jednom budemo pozvani i da malo razgovaramo, da čuje naša mišljenja jer mnogi poslanici mene pitaju, ja ne znam zašto mene i moje kolege iz manjinskih zajednica, pa šta je sa priznavanjem od strane arapskih zemalja. Nekako su arapske zemlje postale sindrom kojim se mnogo i mediji i štampa ovih dana bave.

Pitamo se zašto jedna Srbija sa preovlađujućom verskom konfesijom da ima veći uticaj na arapske zemlje nego recimo jedno Kosovo ako ima procenat koji ima gledano genetski prema konfesiji kojoj većina stanovnika pripadaju. Ja se pitam zašto bi mene pitao jedan moj kolega zašto? Ja kažem nekome, pa dobro ako ti je bliža druga konfesija, zašto nas Vatikan onda nas nije priznao_ Molim lepo, očekivali smo poziv, mislim da smo trebali razmišljati da neko od predstavnika Turske zajednice bude u nekoj poseti nekima od zemalja bivšeg Sovjetskog saveza na koje ima veliki uticaj Turska država. Mislim da smo to mogli da odradimo. Zašto ne bismo, sada reč lobiranje danas je postala malo deplasirana, i neko je koristi u ovakvoj ili onakoj... Priznavanje, evo nećemo upotrebiti lobiranje, što je rekao kolega Gjini. Priznavanje nam je glavni zadatak da bismo dostigli ono čemu... Mi smo svi do februara okrenuli glavu kako priznati državu, sada nam je glava okrenuta kako povećati broj zemalja koje nas priznaju. Sada, ako nam od toga mnogo šta zavisi, a zavisi pristup Medjunarodnom monetarnom fondu, drugim finansijskim institucijama i tako dalje, pitamo se, niko nas nije pitao na koje poteškoće nailazimo mi bošnjaci, zašto Bosna ne može da prizna Kosovo, a većinski narod te države žarko želi da Kosovo vidi kao državu blisku sebi s obzirom na nedavnu prošlost i ne samo to. Dalje, ne znamo u tom organogramu, dakle strukturi zaposlenih da li ima neko od predstavnika manjinskih zajednica, i tako dalje i tako dalje. Znači, ne želim da budem kritičan, nego svojom diskusijom želim da na neki način i neke propuste ako smo napravili, da u periodu koji je pred nama da pokušamo da ih ispravimo.

Vreme neumitno ide. Mi smo narodu nešto obećali do kraja godine, koliko i tako dalje. Nešto u tom skladu ne ide. Ja ne želim biti kritičan. Najlakše je danas okriviti jednog čoveka. Mi moramo da napravimo jednu zajedničku strategiju kako bi smo ovaj zadatak daljeg priznavanja države učinili uspešnijim. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Megjithatë, duhet t'i them dy fjalë. Është fat i madh që diplomacia nuk varet nga besimet fetare, por diplomacia zhvillohet mbi interesat e tjera dhe mendoj që është mirë që është kështu.

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti, ose kush e do fjalën nga Grupi Parlamentar i SLS-së. Fjalën e ka deputeti Grbiq.

BRANISLAV GRBIĆ: Gospodine predsjedniče,
Gospodine premijeru, ministri,
Gospodo poslanici,
Činjenica je jedna da sigurno učestvuje jedan proces koji je nominovnost jedne međunarodne politike i sigurno da taj proces je jedan ozbiljan proces i koji treba da se nastavi i koji traje.

Priznavanje je jedna veoma ozbiljna stvar u smislu tome, da znači lobiranje koji što su ... neki poslanici u smislu da..., to zaheva jednu kompleksnu situaciju u smislu ne samo međunarodne politike, znači i domaće politike, odnosno da kvalitet koji će međunarodni partneri videti u Kosovu, u svakom slučaju će ubrzati taj proces, a to znači da mi kao građani Kosova i kao Vlada i kao svi predstavnici koji smo sigurno zainteresovani da taj proces brže bude i u smislu tome da kao kvalitetni građani omogućimo stranim donatorima, znači stranim investitorima i svim predstavnicima međunarodnih kancelarija da uvide da je taj proces jedan ozbiljan faktor u stvaranju Kosova kao države i da samim tim, znači kroz svoje investicije, taj proces sigurno će se ubrzati.

Zato, smatramo da samo kvalitetni ljudi, ne samo u Vladi, znači i u ostalim institucijama, znači u društvu ukupno, mogu doprineti Kosovu da taj proces bude brži i da taj proces dovede do kraja. Samim tim, znači, mi moramo dati podršku i vladi i premijeru i ministrima da kroz svoj rad, kroz svoj kvalitetan rad koji će prepoznati ne samo domaća javnost, već i međunarodna zajednica uvide da je proces moguć i da taj proces treba okončati. Sigurno je da ćemo mi i kao predsednik zajednice i kao svi, smatram da u tome možemo znatno doprineti da svojim radom i svojim dostignućima omogućimo da taj proces sigurno bude ne samo stvar međunarodne zajednice, nego i stvar domaće zajednice. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet Grbiq!
Sipas radhës, fjalën do të duhej ta merrte kryetari i Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë. Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zotëri Kryetar i Parlamentit,
Zotëri Kryeministër,
Zotëri ministra,
Unë flas si kryetar i Komisionit, por jo në emër të Komisionit, pra si deputet dhe kryetar i Komisionit, sepse mendojmë që duhet dhe jemi marrë vesh në Komision që sekush le t'i paraqet pikëpamjet e veta dhe unë mendoj se kështu është më mirë.

Ne sot po flasim për një temë kapitale të politikës së Kosovës, e cila është fokusuar si interpelancë për ministrin e Jashtëm, por unë menjëherë mund të them që e konsideroj hapje të një teme të madhe në Parlamentin e Kosovës, e sebeb, shkas është kjo interpelancë.

Mendoj kështu, sepse për veti jam i bindur që ajo që quhet politikë e jashtme e Kosovës, nuk guxon, qoftë edhe në një debat që zgjatë 1 minutë, e lëre më dy orë, të simplifikohet dhe të fokusohet te një funksionar, sepse ministri i Jashtëm nuk është asgjë më shumë as më pak se një funksionar në Qeverinë e Kosovës, ndërsa politika e jashtme e Kosovës nënkupton Kryetarin e Republikës së Kosovës, Kryeministrin e Republikës së Kosovës dhe resorin e politikës së jashtme. Edhe me Kushtetutën tonë në fuqi, kjo punë është kështu: nuk krijon politikë të jashtme, por ekzekuton Ministria e Punëve të Jashtme dhe kjo është mirë të jetë e qartë edhe për deputetët, edhe për opinionin dhe për njerëzit në shkalloren e përgjegjësive të politikës së jashtme.

Prandaj, unë mendoj që kur të bisedohet për këtë çështje, që është çështje shumë e madhe, më mirë është të bëhet interpelancë për Qeverinë, për Kryeministrin ose të thirret të mbajë fjalë para Kuvendit Kryetari i Kosovës, sesa të simplifikohen problemet. Aq më tepër, kur është një dije elementare që fuqia politike e politikës së jashtme të një vendi nuk është asgjë tjetër veç se derivim i fuqisë së brendshme të atij vendi, qoftë politike, ekonomike, civilizuese, kulturore, demokratike, si të doni e quani, kështu që ne mund të bëjmë këtu fizkulturë fjalësh çfarë të doni, por nuk mund të kemi fuqi në politikën e jashtme të një supermeni që i bie resorit të ëndrrave të fëmijëve, cilindo qoftë ta qesim, më të mirin të mundshëm, me konsensus jo qeveritar, por edhe popullor, që ta bëjë të fuqishme politikën e jashtme të Kosovës. Ajo është reflektim i fuqive të brendshme. Sa më shumë të organizuar, sa më shumë fuqi të kemi në rajon, në botën shqiptare, në komunikimet me fuqitë e tjera, aq do të jetë kjo politikë.

Prandaj, është mirë që mos ta luajmë lojtarin vetmitar të fuqishëm në Kosovë, sepse ju e dini shumë mirë që edhe kjo pavarësi e shpallur është pavarësi e kontraktuar me Bashkësinë Ndërkombëtare, dhe politika jonë e jashtme mos mendoni që është e pavarur, por shumë e varur, politikë e jashtme e Kosovës e varur nga shtetet që e kanë pranuar deri tash Kosovën, ose që në kuptimin më elementar të fjalës e kanë sponsoruar edhe pavarësinë, edhe shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Është mirë ta them unë si deputet, nëse nuk donë ta thonë publikisht adresantët më të mëdhenj përfaqësues të Kosovës, sepse qoftë edhe zgjidhjet përfaqësuese politike janë të detyruara të bëhen në konsultime me ta dhe kjo ka ndodhur dhe do të ndodhë, andaj nuk është mirë që sendet që i dimë, t'i plasojmë si çudira në opinion.

Edhe puna e rikonstruktimit të Ministrisë së Jashtme është punë që duhet të bëhet shpejt. Ajo është punë absolutisht e ministrit, nën udhëheqje të tij, por jo edhe zgjedhja e përfaqësuesve. Le t'i dimë gjërat! Ju e dini shumë mirë që përfaqësues të Kosovës në botën e jashtme ministri i Jashtëm, alias Skënder Hyseni, sot nuk i ka zgjedhur, as s'ka për t'i zgjedhur. Ju e dini shumë mirë që ajo zgjedhje është bërë kryesisht në konsultim Kryeministër-Kryetar i vendit, dhe është mirë, të gjithë deputetët e dinë, nuk di pse e luajnë këtë lojë të çuditshme? Sepse, me Kushtetutën në fuqi, Kryeministri mund të propozojë, por Qeveria është ajo që e propozon njeriun dhe është Kryetari i shtetit që e dekreton dhe, ju i dini këto punë, se jeni parlamentar.

Shiko, unë sharmin e të folurit e pranoj, por dilni, flisni këtu, nuk ka problem, unë ju përgjigjem më vonë pastaj. Kështu, vërejtja ime është që, më në fund, t'i afrohem realës, jo virtuale, pra asaj që është e mundshme, jo asaj që dëshirohet.

Ne kemi kaluar nëpër këto dy faza. Unë kam thënë këtu edhe në këtë foltore, nuk më është marrë shumë për të mirë, kam thënë ta lëshojmë festivitetin dhe të kalojmë në punë! Mirë është që po shkojmë kah puna, festivitetet mbaruan, por kjo sjellje e ka edhe gjuhën

e vet, se ne kemi pasur gjuhën entuziaste, edhe të numrave, edhe të afateve që e ka plasua Qeveria për arsye të veta dhe për interesa të veta dhe për propagandë për Kosovën, në fund të fundit, po kemi pasur edhe një tërheqje tjetër pos të kësaj pune, tërheqje totale ku thuhet kemi shenja, një semasiologji e veçantë që prapë nuk thotë asgjë, se është tërheqje totale. Ne kemi shkuar prej ekstremit të afishimit total në një tërheqje totale. Nuk është thënë shkurt e qartë që pavarësia e Kosovës varet prej gjendjes së përgjithshme të saj dhe gatishmërisë së fuqive të na njohin, nuk varet nga dëshirat tona. Ju e dini që dëshirat tona janë paskajë dhe na do të kishim dëshirë që të gjitha shtetet e Kombeve të Bashkuara të na njohin që sot, po ajo nuk ndodhë dhe nuk ka për të ndodhur. Ajo që ndodhë sot në debat, dhe unë mendoj se është shumë me rëndësi, është të bëhemi real.

Politika e jashtme e Kosovës do të ketë probleme të mëdha, do të ndeshet me vështirësi të jashtëzakonshme, Kosova do të ndeshet me probleme të mëdha edhe të brendshme dhe në komunikime të jashtme. Për këtë punë duhet strukturim total i institucioneve të Kosovës. Duhet strukturim edhe brenda Kuvendit, edhe Qeverisë, edhe Presidencës po edhe përtej kësaj. Ky strukturim i plotë nuk ta japë një kuadër të atij supermeni, që po them unë të çuditshëm, që mendohet që këtu veç vullneti nuk ekziston, se kapacitetet ekzistojnë. Jo, jo, është në defekt kapacitetesh në politikën e jashtme Kosova. Kur ta marrim vesh ne këtë, ne do të punojmë shumë më shumë. Nuk është problemi i mungesës së vullneteve, është problemi i mungesës së vërtetë të kapaciteteve dhe të strukturimit të tyre. Këtë mund ta bëjmë ne, të shkojmë kah optimumi, por jo maksimumi, se ne maksimum nuk kemi, se atëherë mbërrijmë në atë situatën e, për t'u bë pak popullor, bretkosës që ka dashur të bëhet buall. Ju e dini çka ndodhë. Këto janë leksione të Ezopit dhe të La Fontenit, por janë esenciale. Por, edhe te ajo tjetra, e fajit të nuses, a! Po ai plaku i mençur ka thënë, nëse ajo bën faj gjithë, le të ha bukë ajo, e ju rrini unët, pra! Problemet as në politikë të brendshme, as të jashtme nuk duhet të personifikohet dhe janë reflektim i zhvillimeve të brendshme, jo i një njeriu, cili do qoftë ai. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

KREMINISTRI HASHIM THAÇI: Edhe si kryeministër, edhe si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ju faleminderit zoti Kryetar!

Të nderuar deputet,

Unë dua të shpreh opinionet dhe qëndrimet me të cilat jemi ballafaquar gjatë kësaj periudhe të rëndësishme për vendin tonë në procesin e shpalljes dhe të njohjes së pavarësisë së vendit tonë.

E pra, unë dua të potencoj shumë fuqishëm para të gjithë juve dhe para opinionit publik se ky vit është viti apo kulmi i të arriturave kosovare, e në kuadër të kësaj edhe i diplomacisë kosovare. Pse? Pavarësia e Kosovës është shpallur në mënyrë të koordinuar, duke respektuar vullnetin e qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur, sovran dhe demokratik, por me mbështetje të fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Evropian.

Kemi, u theksua, diplomaci të varur. Unë mendoj dhe besoj se diplomacia jonë është e koordinuar dhe kjo është mirë. Do të duhej të vazhdojmë në këtë drejtim. Është e koordinuar plotësisht me politikën e drejtë të integriteteve euroatlantike. Do të duhej

shqetësuar nëse do të ishte e mbyllur dhe e izoluar dhe jo e koordinuar me miqtë, partnerët tanë. Në këtë drejtim nuk do të ketë luhatje.

Sot, Kosova është njohur prej 47 shteteve. Njohje kualitative dhe e fuqishme. U theksua se Qeveria është e përgjegjshme për këtë periudhë kohore që kemi kaluar. E potencoj para jush, edhe jemi të përgjegjshëm, por edhe jemi krenar me këtë të arritur të përbashkët, sepse është njohur prej 47 shteteve, prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës, prej 22 vendeve të Bashkimit Evropian, prej 7 vendeve të G-8-shit, të Japonisë, Australisë dhe të vendeve tjera.

Është keqkuptuar nganjëherë çështja e lobimit. Fillimisht duhet qartësuar shumë shkurt dhe qartë, çka nënkupton lobimi? Lobimi është aktivitet për realizimin e një qëllimi të caktuar, pra të njohjes së pavarësisë së Kosovës. Ky është qëllimi jo vetëm i Qeverisë, ky është qëllimi i të gjithë neve, siç ka qenë qëllimi, përkushtimi, sakrifica e të gjithë neve dhe e qytetarëve të Kosovës. Prandaj, në këtë drejtim unë ju ftoj të gjithëve të punojmë bashkërisht si Qeveri, si koalicion, si opozitë, si politikë kosovare me partnerë ndërkombëtarë që ta rrisim numrin e njohjeve për shtetin tonë. Mundësitë kanë qenë dhe janë të hapura për të gjithë.

Në këtë drejtim, unë mendoj se mund të punohet edhe më tepër edhe do të punohet, por edhe dua të potencoj se edhe vendet tjera, të cilat ende nuk e kanë shpallur vendimin për njohjen e pavarësisë së Kosovës, në veçanti ato, disa prej të cilave janë edhe anëtare të Bashkimit Evropian, që presim edhe prej Portugalisë, natyrisht Rumania që e përkrah Kosovën dhe që ka filluar diskutimi në Bukuresht, Sllovakia që është prezentë edhe në Kosovë edhe që ka filluar të diskutojë, por kemi edhe hapa të tjerë të rëndësishëm që kanë filluar t'i njohin pasaportat e Republikës së Kosovës, është hapi i parë i njohjeve.

Në këtë drejtim kemi edhe ftesën nga autoritetet e Greqisë për hapjen e Zyrës ndërlidhëse të Kosovës në Athinë dhe kjo nuk ndodhë rastësisht. Gjithashtu, edhe Spanja që ende nuk e ka njohur Kosovën, është mbështetëse e Kosovës, është në Kosovë, është prezente dhe luan rolin e vet të rëndësishëm.

Gjithashtu, unë nuk dua të besoj dhe as që mund të imagjinoj që të shoh politikën kosovare në dy taborë sa u përket njohjeve. Koalicionin qeverisës në opinion të njëjtë me vendet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, dhe një pjesë të caktuar atë opozitës me opinione të njëjta me vende që nuk a kanë njohur Kosovën. Në këtë drejtim nuk duhet, së paku, kjo të na ndodhë neve.

Sa i përket çështjes së kërkesës së Serbisë drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për ta kërkuar mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, të nderuar deputetë, ndiej obligim që para jush t'i them disa fjalë rreth kësaj çështjeje:

E para, kjo nismë e Serbisë është një nismë shumë e keqe dhe fare nuk i kontribuon përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet të dy shteteve tona: Kosovës dhe Serbisë. Me këtë veprim, Serbia edhe një herë po e dëshmon politikën e saj jovizionare në raport me paqen, stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal, por edhe me integrimin në strukturat euroatlantike. Prandaj, kjo nismë edhe nismat e tjera të kësaj që mund t'i presim nga Serbia, nuk duhet të ngjallin huti dhe të na frikësojnë ne apo të na hamendin për asnjë çast nga rruga jonë, edhe për integrim, edhe për zhvillim ekonomik, edhe për

demokratizim dhe të gjithë duhet që të themi botërisht se e ardhmja jonë kalon përmes Brukselit, Uashingtonit dhe nuk është e lidhur me Beogradin.

Jemi të informuar me kërkesën e Serbisë, mirëpo në çdo rast, çdo rrethanë që mund të krijohet në Asamblenë e Përgjithshme, nuk ka hapësirë, nuk ka rrethana që duhet të ngjallin zhgënjim. Përkundrazi, unë ju ftoj të gjithëve që të mobilizohemi si politikë kosovare që të vazhdojmë dhe të fitojmë njohje të reja, ta zhvillojmë ekonomikisht vendin tonë dhe të sigurojmë rrugë më të shpejtë, më të qartë e më të sigurt për integrim në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Për më tepër, edhe nëse kjo çështje e Serbisë, kjo kërkesë mund të diskutohet në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, apo Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë do ta japë mendimin për Kosovën, kjo nuk do të thotë se Gjykata Ndërkombëtare do të japë mendim kundër pavarësisë së Kosovës.

Prandaj, ne duhet të jemi të përkushtuar dhe jo të dramatizuar me veprimin e Serbisë. Unë ju ftoj të gjithëve të mos e ekzagjerojmë rolin e Serbisë, por të punojmë me seriozitetin dhe përgjegjësinë më të madhe, por, natyrisht, nuk duhet edhe ta injorojmë dhe s'e kemi injoruar si politikë shtetërore e Kosovës së bashku me miqtë partnerë ndërkombëtarë. Por, dua edhe të potencoj tjetër se edhe për një kohë nuk duhet të presim veprime konstruktive nga Serbia, edhe pse pretendohet se atje është instaluar një qeveri pro perëndimore.

E kam potencuar dhe më herët dhe e ritheksoj edhe sot. Do të mund të kemi edhe në të ardhmen e afërt vështirësi të natyrave të ndryshme, por asgjë nuk do të na ndalë në procesin e njohjes së pavarësisë së Kosovës dhe të bërjes së saj pjesë të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Kryeministër!

Për fjalë, do të thotë edhe pse iu ka prishur rendi, fjalën e ka Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Selam svima koji su prisutni,

Želim da kažem nekoliko riječi, mada smo svi jako zamoreni ovom dugom pričom, i sa njamerom da ne ponovim neke stvari koje su se do sada čule.

Zaista je pitanje priznanja Kosova jedno kapitalno pitanje, kao što je već rečeno, i jedno od najvitalnijih pitanja sa kojim se Kosovo susreće ne samo ovih godina, nego i pitanje o kom smo razmišljali ili se pripremali već nekoliko, možda i deset ljeća. Naravno, moram da istaknem i ono što su već prethodnici rekli, da to nije samo posao ministra Hysenija, i ne samo da nije posao samo ove vlade, predsednika, nego je posao svih ovih garnitura vlada koje smo imali poslije rata, jer je to jedno naporno pitanje za koje smo se pripremali i pravo pitanje na koje treabamo dati odgovor je ne samo da li je ovaj ministar Hyseni i ova vlada, nego da li bi i bilo koja vlada na njenome mjestu mogla biti uspešnja i šta trebamo uraditi da bi bila uspešnija u procesu priznavanja Kosova, do koga nam je svima i te kako stalo. Naravno i meni, svima nam je stalo do toga.

Činjenica je da je 47 zemalja priznalo Kosovo, ostalo je još oko 150 zemalja. Dakle, jedna četvrtina zemalja je priznalo Kosovo, ostale su još tri četvrtine. To je veliki problem, to je veliki problem koga moramo biti svjesni, sa kojim se moramo suočiti i na koji treabamo tražiti rješenje.

Ja ću dati neke prijedloge koji se tiču ovoga rešenja, naravno sa najboljim namjerama da pomognem svemu ovome i naravno da se slažem, kao što je malo prije rekao gospodin predsjedavajući, odnosno predsjednik da to jeste poso institucija, to jeste posao vlade i, naravno, da je posao i predsjednika Parlamenta, i predsjednika Kosova, i ministra Hysenija, ali naravno da je to posao i poslanika koji su ovdje...

KRYETARI: Aq është koha nga një minutë, nuk kanë më shumë deputetët. Ti, a je në grupin e veçantë apo je në AAK? Unë po ju noftoj edhe sa kohë kanë grupet parlamentare, që të prëgatiteni:

Partia Demokratike, prej 37 minutave i ka harxhuar 10, i ka edhe 27 minuta, LDK-ja i ka 25 minuta, i ka harxhuar 12 minuta, i ka edhe 13, AKR- a i ka edhe 12 minuta, LDD- i ka edhe 6 minuta, AAK- i ka plus 4 minuta, „7+“ i ka 3 minuta, SLS-ja i ka hargjuar minutat e vet.

Numan Baliqit po ia vazhdojmë edhe një minutë. E lus regjinë, le t'ia vazhdojë fjalën Numan Baliqit!

Lexone Rregullohen, unë Rregulloren nuk e kam bërë, e ka bërë Parlamenti, kurse ne duhet ta respektojmë. Interpelanca, me Rregullore zgjatë dy orë dhe mbi bazë të kësaj është ndarë për fuqitë politike të grupeve politike nga 1 minutë për deputetë, 120 minuta bëjnë dy orë. Parlamenti i ka 120 deputetë, i ka 120 minuta.

Lus Regjinë le t'ia vazhdojë fjalën Numan Baliqit edhe 2 minuta.

NUMAN BALIĆ: ... Bëmë pazar, në rregull! Nastojaću da budem..., eto nemam vremena, mislio sam da kažem nešto pametno, ali nažalost...

U redu, hajde, daću gas. Mislim, predložiću i Vladi, i ljudima koji se bave ovim odgovornim pitanjem, jedno moje razmišljanje.

Mislim da smo se do sada usredsredjivali na politiku Evrope i Sjedinjenih Država. Gospodin Hamiti je odlično rekao da su to sponzori. Oni, jesu sponzori. Oni će ostati sponzori, i neka budu sponzori, naravno bez, nadam se da mi nećete zameriti. I mi razumijemo značaj ovoga pitanja. Ali zato nam je važno da osim ova dva bloka važnih zemalja, postoje još devet desetina svijeta, postoje novi centri svijeta. Mi ne živimo više u 88. godini – 89. godini, kada su Sjedinjene Države bile jedina super sila i kada nema blokova. Živimo u doba formiranja novih regija svijeta. Imamo Kinu sa zemljama oko nje, imamo Indiju sa zemljama oko nje, imamo Jugoistočnu Aziju, imamo Afriku, Latinsku Ameriku. Iz Latinske Amerike nismo imali nijedno priznanje. Argentina je bila juče jedno od zemalja koja se snažno založila da Specijalni komitet stavi na dnevni red Generalne Skupštine Ujedinjenih Nacija.

Žao mi je što nije Premijer tu, koji je tek tako olako odbacio inicijativu Srbije, govoreći da – eto, nije važno. Vjerujte mi, veoma je važno to što je Specijalni komitet donio odluku da se na Generalnoj skupštini Ujedinjenih nacija raspravlja o tom pitanju. Iako odluka Međunarodnog suda nije obavezujuća, ali činjenica je da će na svjetskoj Skupštini zemalja govoriti o pitanju, odnosno o mogućnosti poništenja priznanja Kosova. To je jedan veoma veliki problem.

Dakle, mi nemamo odgovor, ovo hoću da kažem. Mi nemamo odgovor na diplomatsku ofanzivu Srbije. To je suština problema. Oni imaju diplomatsku ofanzivu i mi nemamo odgovor na to. I to je pitanje, kojim moramo da se bavimo, i premijer, i predsjednik i naravno gospodin Krasnići koji mi je dao dva minuta.

Dakle, suština pitanja je da ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Të gjithë e dimë se pavarësia e Kosovës është një fakt i kryer dhe nuk kthehet prapa, kështu që për në atë drejtim mos u shqetësoni shumë.

Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla. Grupi i AAK-së i ka edhe 4 minuta.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Fillimisht dëshiroj të falënderoj veç e veç secilin nga shtetet që e kanë njohur Kosovën, veçanërisht SHBA-në dhe shtetet e BE-së. Por, më lejoni të jem praktike, më tej. Megjithatë, është i rëndësishëm angazhimi i vetë Qeverisë së Kosovës, sepse e ka përgjegjësinë.

Zoti ministër,

Pyetja ime është se sa takime i keni aranzhuar ju dhe Presidenti në Nju-Jork, në nivelet e juaja. Pse nuk e keni zbatuar nenin 3.2 të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, sipas të cilit Ministria formon dhe zbaton politikën e jashtme të Kosovës. Sepse, s'keni fare politikë.

Keni deklaruar në gusht se së shpejti do të ketë njohje nga rajoni i Amerikës Qendrore dhe Jugore. Na informoni cilat shtete dhe ku?

Pikërisht për shkak të mungesës së fuqisë politike dhe të sfidave, nuk keni formuar një mision shtetëror për njohjen e shtetit të Kosovës, i cili do të ishte gjithëpërfshirës: pozitiv, opozitiv, njerëz jashtë politikës, diplomat të huaj, që kanë kontakte serioze me botën.

Sa e keni shfrytëzuar diplomacinë publike, sa keni qenë në mediat prestigjioze ndërkombëtare, siç është SNN, BBC e tjerë, sa keni pasur shkrime autoriale në mediat e njohura, siç është Frankfurter Allgemeine Zeitung ose në New York Times?

Në fund, ne kemi ndërtuar një shtëpi të re, që quhet shteti i Kosovës. Pse ka dështuar organizimi i mëparshëm i Qeverisë, që në qershor të këtij viti të ftohen liderët e botës këtu për t'iu treguar se si duket shtëpia jonë dhe për t'iu kërkuar mbështetjen për njohjen e shtetit? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për fjalë, ndoshta edhe i fundi, nga radhët e AAK-së është lajmëruar Rasim Selmani.

RASIM SELMANI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë fjalën time të plotë, në formë të shkruar do t'ia dorëzoj Sekretarisë së Kuvendit, por sido qoftë, dëshiroj të theksoj se në mesin e të gjithë kësaj shtate edhe një gjë është e vërtetë dhe shumë e dhembshme. Megjithë dëshirën e tij për dituri e zotësi, ministrit tonë të Jashtëm, Skender Hyseni, i mungojnë kredencialet për t'iu kundërvënë të diplomuarit të Harvardit, ministrit serb Jeremiq, dhe për të lobuar me efikasitet për pavarësinë e vendit tonë. Megjithatë, duhet theksuar se fajin kryesor nuk e mban Skender Hyseni, por shefat e tij të cilët e kanë avancuar atë në postin e ministrit të Jashtëm.

Prandaj, është e domosdoshme që pa humbur kohë, Ministria e Jashtme të angazhojë disa nga personalitetet e respektuar të vendit tonë për të vënë kontakte me këto shtete dhe për t'ua sqaruar të vërtetën historike për shqiptarët dhe për Kosovën. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Zylfije Hundozi, një minutë e keni në dispozicion.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti Kryetar!

Kosovën shtet të pavarur e kanë pranuar gjer më tani 47 shtete, shtete këto ekonomikisht dhe politikisht të fuqishme, gjë që e ka krijuar ndjenjën te Qeveria e tanishme e Kosovës se puna është kryer dhe shtetet e tjera të botës me inercion gradualisht do ta pranojnë Kosovën dhe kështu i kanë dhënë vetit komoditet në këtë drejtim të lobimit të mëtejshëm për pranimin e pavarësisë së Kosovës që, një kohë, të mos bëjë gati asgjë dhe pas një kohe, gjithashtu me vonesë, të krijojë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të caktojë ministrin e saj, kështu që është krijuar një vakum kohor i veprimit.

Ndërkohë, diplomacia serbe ka punuar me intensitetin më të madh dhe atë jo vetëm në këtë periudhë, por edhe në kohën e negociatave për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe për këto aktivitete vazhdimisht nga diaspora jonë na kanë tërhequr vërejtjen...

(Ndërprerje nga regjia)

(Në vijim jepet diskutimi i dorëzuar me shkrim i Zylfije Hundozit)

...që të mos kotemi dhe mos të kënaqemi me këtë çka është arritur, por të punohet edhe më tepër, mirëpo fjalët e tyre kanë hasur në vesh të shurdhër duke mos u marrë seriozisht paralajmërimet e tyre.

Sa aktive ka qenë dhe është diplomacia serbe, u pa edhe në këtë javë, ku ka arritur të radhitë në rend dite të Asamblesë së Përgjithshme të KB çështjen e ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe me këtë diplomacia serbe e ka fituar raundin e parë.

Çka ka bërë Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës në këtë drejtim, a ka dërguar ndonjë letër në Kombe të Bashkuara që të mbrojë legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës apo vetëm i lutet zotit që Serbisë mos t'i shkojnë punët ashtu si ia ka mësy. Obligimet në fushën e politikës së jashtme janë shumë të mëdha, sidomos në këtë fazë në të cilën ndodhet Kosova dhe nuk mjafton që ministri i Punëve të Jashtme të jetë anëtar i partisë në pushtet dhe të dijë anglisht.

Mungesa e vigjilencës dhe mungesa e parashikimit të ngjarjeve që do të vijnë nga ana e Qeverisë na kanë pru gjer te ky stagnim. Në kohën deri sa është krijuar Ministria e Punëve të Jashtme, ka qenë detyrë e Kryeministrit që të kërkojë pranime nga të gjitha shtetet të cilat nuk na kanë pranuar dhe t'u tregojë argumentet tona për shpalljen e Kosovës shtet i pavarur. Argumente ka mjaft dhe, nëse jo të gjitha, disa prej tyre do ta ndërronin mendjen për pozitivisht. Më në fund, kur edhe u krijua Ministria e Punëve të Jashtme, ministri e fillon punën e vet pa program dhe strategji të cilën e kanë të gjitha institucionet serioze. Argumentet për këtë janë ueb-seiti i kësaj ministrie që gjer vonë ka qenë i zbrazët.

Hapja e përfaqësive të Kosovës është bërë me vonesë dhe në këto poste nuk dihet se cilat kanë qenë kriteret që të emërohen njerëzit që janë emëruar dhe me gjasë edhe këtu

afërsia me Kryeministrin dhe Presidentin e Kosovës dhe përkatësia partiake ka gjetur shprehje. Sa shkurtpamës dhe pa vizion kanë qenë ata që kanë vendosur për këta njerëz, do të tregojnë rezultatet e punës së tyre, por ne jemi mësuar kështu pa plane dhe pa analiza paraprake dhe në fund çmimi që e paguajmë është gjithnjë më i madh. Në asnjë moment nuk i ka rënë në mend qeverisë, por as Presidentit se në Kosovë ka femra shumë të afta për këto poste, që me mençuri, sjellje, urtësi politike do të ishin përfaqësuese të denja të Kosovës dhe sidomos në këto 10 vendet e para ku janë çelur ambasadat, por po mbetet të kuptohet se femrat nuk konsiderohen si qenie njerëzore, të cilat meritojnë të sfidohen edhe në detyra të rëndësishme.

Pata shpresë se kjo interpelancë do ta vetëdijësojë qeverinë dhe ministrin e Punëve të Jashtme që t'i përvishen punës seriozisht, por nga ekspozoja e ministrit Hyseni e kuptova se vetëdijësimi i tyre është larg dhe neve na mbetet që të shpresojmë se ndoshta fati do të jetë në anën tonë.

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Adem Salihaj. Njoftoj se LDD ka në dispozicion edhe 6 minuta.

ADEM SALIHAI: Do të mundohem për një dy minuta të them diçka, edhe pse do të jetë sigurisht e pamundur.

U tha se deri dje Kosovën e njohën 47 shtete, duke përfshirë këtu edhe një shtet që ka 147 mijë banorë, që në këtë situatë të skamjes së madhe s'duhet ta nënçmojmë, por ta falënderojmë që e ka pranuar Kosovën dhe është vërejtur se ministri ynë i Punëve të Jashtme veçanërisht kohëve të fundit lobon te mini-shtetet që ndoshta është në përputhje me mundësitë dhe kapacitetet e tij dhe, secili me takatin e tij, normalisht. Por situata jonë nuk është shumë për humor, ndonëse nganjëherë njeriu qesh edhe nga zori. Ne shpresonim që në vjeshtë të kishim pranimin e gjysmës së shteteve të botës dhe të aplikojmë në OKB. Tash po shohim sa joreale ishte e gjithë kjo.

Ministri i Punëve të Jashtme, zoti Skender Hyseni ka paraqitje tepër të zbehta, nuk ka koncept për zhvillimin e proceseve. Kur flet për procesin mezi gjend fjalët për të formuluar disa fjali. Mundohet të improvizojë për të përfunduar në fund pa thënë pothuajse asgjë. Populli thotë: "më fol - mbushma mendjen". Nëse e dëgjojmë këtë ministër, nuk na e mbush mendjen për asgjë. Është aq e zbehtë, jo bindëse dhe pa efekt paraqitja e tij. Ka rrezik që edhe disa shtete që ndoshta janë afër ta marrin vendimin për njohje, kur e shohin dhe dëgjojnë ministrin tonë, të heqin dorë nga njohja.

(Të qeshura)

Mua, po më shkojnë minutat, ju lutem! Dhe, a e dini cili është shpjegimi i ministrit tonë për gjithë këtë. Thotë, jo që ne nuk po bëjmë sa duhet, por ata, tjerët domethënë, rusët dhe serbët po bëjnë një ofensivë të madhe. Domethënë, është një shpjegim gjenial që tregon krejt paaftësinë për t'u ballafaquar me kundërshtarët tanë në skenën politike ndërkombëtare.

Në fund, dëshiroj ta theksoj edhe një çështje. Unë nuk kam asgjë kundër zotit Skender Hyseni. Ai e ka personalitetin e tij. Por, aftësitë dhe kapacitetet e tij janë tepër në disproporcion me punët dhe detyrat që ka marrë. Është interes, jo vetëm i Kosovës, por edhe i partive në koalicion dhe i atyre që përfaqësojnë ata, që zoti Skender Hyseni të ndërrohet nga ky post dhe të vendoset aty një njeri që vërtet ka kapacitete dhe e çon

Kosovën përpara në procesin e njohjes së pavarësisë. Ky do të ishte një vendim i mirë dhe në interes të Kosovës. Procesi i madh i njohjes së pavarësisë nuk duhet të jetë viktimë e as peng i interesave të ngushta individuale e grupe. Shërbimin më të madh këtij procesi të njohjes së pavarësisë së Kosovës ministri do t'ia bënte duke u larguar nga ky post. Vërtet vetëm në këtë formë ne mund të ecim përpara dhe ndoshta mund të ç'blokohet procesi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! LDD-së i mbetën edhe 3 minuta. Sipas renditjes, fjalën e ka deputetja Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Deputetë të nderuar,

Qeveri e nderuar,

Po diskutojmë një temë jashtëzakonisht të rëndësishme. Me ju thënë të drejtën, nuk po më pëlqen qasja, toni as qeshjet që po i bëjmë, sepse situata është shumë më serioze, sesa ne që po i bëjmë ballë me këtë nivel të qëndrimit.

Politika e jashtme e Kosovës ka startuar shumë mirë. Startoi me një njohje të fuqishme, mirëpo çka ndodhi më tutje, mendoj se iu adresohet drejtpërsëdrejti institucioneve që janë përgjegjëse për këtë punë.

Fare nuk u pajtova me konstatimin që “këta janë njerëz dhe individë”. Ministrat janë institucion dhe kanë përgjegjësitë për këto punë dhe me këtë rast, megjithëse në rastin tonë, rasti i ministrit të Jashtëm nuk e di a është legjitim me faktin se nuk ka kaluar në Parlament, po edhe këto ministritë e reja. Megjithatë, dua të shtroj disa çështje të cilat janë karakteristikë e punës dhe, për mendimin tim, kanë mbërritur shkallën e improvizimeve të patolerueshme.

E para, dy dështime shoqërojnë politikën e jashtme dhe Ministrinë e Jashtme prej momentit të formimit. Shtatori është pritur të jetë kohë e njohjeve – diku në parashikim: 100 shtete. 50-përqindëshi nuk është realizuar. Kush është përgjegjës, kush po i analizon dhe kush pra po merr masa që të ndryshohet gjendja? Pranimi i kërkesës së Serbisë, dje, që të procedohet, është dështim i joni, është dështim i Kosovës. Janë punë serioze dhe, do të kisha thënë që ta kthejmë situatën, të bëhemi një politikë e jashtme proaktive, të gjejmë aty ku janë dhe ku s'janë njerëzit e aftë kompetent dhe të qëndrueshëm që t'i çojmë proceset përpara.

Unë e kuptoj kohën e konsolidimit. Çdo ministri e re i ka sfidat e saj, por koha e konsolidimit ka mund të mbushet me mekanizma ad-hoc. Ka mund të krijohet menjëherë ditën e parë të Ministrisë mekanizmi ad-hoc për diplomaci, ka mund të krijohet këshilli për interesin nacional, ka mund të krijohet instituti për politikë të jashtme në mënyrë që ta ndihmojë Ministrinë, ministrin dhe Qeverinë që të vendosë bazat e një strategjie të suksesshme në politikën e jashtme. Mos harroni, blloku antipavarësi është shumë serioz. Pastaj, paradigma e marrëdhënieve ndërkombëtare po ndryshon. Krizat e reja, që po krijohen, po krijojnë nivele më të larta – ndryshimin e raporteve të forcave. Në qoftë se vazhdojmë një herë në muaj takim me një ministër të jashtëm, diku 150 shtete që s'na kanë njohur, i bie diku 10-15 vjet udhëtim të ministrit.

Ju lutem, le ta marrim të gjithë seriozisht, sepse po ashtu, fare nuk po më pëlqen se çështja e politikës së jashtme po vihet në raport pozitiv-opozitiv. Gjithkund në botë, por

vetëm atje ku njihen mirë senset e politikës së jashtme, opozita dhe pozita bashkohen që të ndihmojnë procesin e avancimeve.

Unë po flas si kompetente në fushën e politikës së jashtme. Nuk jam e kënaqur me nivelin e arritjeve. Improvizimi është i madh, duhet të merren masa nga të gjitha instancat në mënyrë që të ndërrojmë kahen e politikës së jashtme drejt një veprimi proaktiv. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit për sqarim! Ministrat janë legjitim. Lexoni Kushtetutën dhe atje thuhet se Qeveria ministrat edhe i shkarkon, edhe ndërrimet që bëhen i bën Kryeministri, prandaj edhe janë legjitim. Fjalën e ka deputeti Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Marrë, përgjithësisht, njohja e pavarësisë së Kosovës është relativisht e kënaqshme. Njohja e afër 50 shteteve apo e një të katërtës të të gjitha shteteve anëtare të OKB-së për një periudhë kohore shtatëmuajshe nuk është pak dhe, aq më shumë, kur njohja e pavarësisë është bërë nga shtetet më të zhvilluara dhe më me ndikim në botë.

Megjithatë, kjo njohje e deritashme nuk është në shkallën të cilën e kemi pritur dhe dëshiruar. Askush nuk e ka pritur abstenimin e deritashëm të pakuptueshëm të shumë vendeve anëtare të Konferencës Islamike. Nuk është pritur as kundërvënja kaq e ashpër dhe drastike e Rusisë ndaj pavarësisë së Kosovës. Nuk është pritur as kundërvënja e disa shteteve anëtare të BE-së, siç janë Spanja e Sllovakia. Askush nuk e ka pritur që pikërisht në kohën e shpalljes së pavarësisë ose pas shpalljes së pavarësisë të dalë nga shtypi një libër nga ish-kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës me plotë akuza, shpifje, fyerje e gënjeshtër të paskrupullta kundër luftës çlirimtare në Kosovë, të cilat, mediat, politika dhe diplomacia serbe i përpunuan, i shfrytëzuan dhe i shpërndanë me zellin më të madh gjithandej nëpër botë, kurse institucionet tona heshtën.

Sigurisht se për suksesin apo mospjesëmarrjen e njohjes së pavarësisë ekzistojnë edhe shkaqe të tjera të brendshme. Vonesat për formimin, strukturimin dhe funksionimin e Ministrisë së Jashtme, vonesa e formimit të shërbimit diplomatik si dhe mungesa e një strategjie të qartë për lobim, tashmë janë të dukshme. Mospjesëmarrja në nivele më të larta apo mospjesëmarrja fare në takimet e rëndësishme ndërkombëtare, siç është Konferenca e Vendeve Islamike apo ajo e Unionit Afrikan, kanë bërë që lobimi serb të tregojë njëfarë suksesi. Dhe, pse të mos themi faktin se propozimet dhe pastaj emërimet në Ministrinë e Jashtme nuk ishin të qëlluara. Vërejtje ka edhe në emërimin e personelit diplomatik, si dhe të stafit civil në këtë Ministri, e cila që në fillimin e funksionimit të saj ka treguar shenja të qarta të dështimit.

Unë nuk mund të pajtohem me deklaratën e ministrit të Jashtëm se Rusia po ndikon në mosnjohjen e pavarësisë nga vendet arabe. Kjo nuk është deklaratë politike e as diplomatike. Përkundrazi, mund të jetë fyese për shumë vende të cilat presim të na njohin së shpejti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për fjalë, sipas radhës, është deputeti Riza Smaka. Shihet se nuk është këtu. Në radhë është deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,
I nderuar zoti ministër Skender Hyseni,
Jam përpjekur që karshi qytetarëve të këtij vendi të gjej se çfarë ka ofruar Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës sa i përket një plani edhe afatshkurtër të ngritjes dhe të strukturimit të saj. Singerisht, në këtë plan nuk ka asnjë prurje, asnjë gjë që do të na bënte të besojmë për rolin që ka kjo Ministri në përfaqësimin e Kosovës në botën e jashtme dhe lobimin për njohjen e pavarësisë së saj.

Unë besoj se në lidhje me këtë çështje do të debatohet prapë në këtë seancë, por unë do të fokusohesha kryesisht në një çështje e cila ka të bëjë me përfshirjen e gruas apo të femrës në misionin diplomatik tuajin.

Fjala është për mospërfshirjen e femrës në diplomacinë e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,
Është e pakuptueshme, për të mos thënë e dhembshme, që trajtimi i femrës në këto hapësira tona vazhdon të bëhet sipas mentaliteteve të shekujve të kaluar. Ne femrat që, po një soj, kemi marrë votën dhe besimin e qytetarëve të këtij vendi, sikurse e kanë marrë votën kolegët e gjinisë tjetër, kur vjen puna për t'u vënë në ndonjë pozicion, prapë se prapë këta janë të parët, të cilët neve na anashkalojnë, na injorojnë dhe na deklatojnë dhe, si duket, këtë vlerësim e bëjnë jo nga fuqia e trurit, por nga fuqia e muskujve, zoti ministër.

Është edhe një argument tjetër shumë i fuqishëm, e ai është se përqindjen më të madhe të popullsisë së Republikës së Kosovës e përbën gjinia femërore. Atëherë, zoti ministër, si është e mundur që në përzgjedhjen e diplomatëve tuaj të mos përfshihet as edhe një femër e cila do të kishte përfaqësuar korin tënd diplomatik.

Dua t'ju ofroj edhe një argument të tretë me radhë, zoti ministër, se edhe në vitet e 90-ta dhe në dekadat e mëhershme në rrethana krejtësisht ndryshe nga këto të sotmet, pra në rrethana të okupimit klasik, zëri i Kosovës është përçuar anekënd botës e deri në Kongresin Amerikan edhe nga femrat shqiptare.

Zoti ministër,
Ju lutem, cili është komenti juaj rreth këtyre argumenteve? Unë, duke parë gjendjen reale, do të përpiqem t'ju ndihmoj në përgjigjen tuaj. Ju e keni injoruar, e keni përçmuar afinitetin, cilësinë dhe atdhedashurinë e femrës duke mos e përfshirë në korin tuaj diplomatik.

Zoti ministër,
Cilat janë cilësitë dalluese të gjinisë tuaj karshi gjinisë femërore, që u bën juve të ndiheni kaq komod në institucionin që ju e përfaqësoni. Çfarë barre më të rëndë, më të vështirë paska bartur gjatë rrjedhave të historisë së përgjakshme të këtij vendi dhe çfarë kontributesh më shumë keni dhënë ju karshi femrës, në këtë rast specifikoj – nënave, vajzave dhe studenteve tona, të cilat gjithmonë ndodheshin gjithherë aty ku e kërkonte nevoja për ta rezistuar sistemin e kaluar.

E dini ju, zoti ministër, se sa femra të këtij vendi kanë mbaruar shkollim superior këtu dhe jashtë vendit tonë, e që janë njohëse të mira të gjuhës angleze dhe të gjuhëve të huaja që kishin mund të përfaqësojnë në mënyrë të dinjitetshme.

Zoti ministër,

Nëse emancipimi i një populli vlerësohet në bazë të përfshirjes së femrës në jetën institucionale dhe politike, ju i keni dhënë një mesazh shumë të keq botës me mospërfshirjen e asnjë femre në grupin tuaj diplomatik.

Në planin e brendshëm, zoti ministër, mospërfshirja e femrës ose përfshirja e saj në nivele më të ulëta, aq sa për të thënë, është një mesazh dekurajues për të gjitha femrat e këtij vendi, të cilat po i ngjeshin shkallët e sukseseve në shkollimin e tyre superior. Domethënë, kjo i bie që “ju shkollohuni, ndërsa ne vendosim për pozita si duam ne”.

Përballë këtyre fakteve të argumentuara, unë mendoj se ju duhet të pranoni para këtij Kuvendi, të nderuar, se keni treguar qasje jo të drejtë të përfshirjes së kësaj shtrese në grupin e diplomatëve të parë. Është për të ardhur keq, zoti ministër, dhe shumë keq edhe sa i përket ndërtimit të brendshëm strukturor të Ministrisë. Ju nuk keni treguar asnjë lloj vlerësimi në përfshirjen e gjinisë femërore për të udhëhequr dikastere të caktuara. Nuk do të dëshiroja që këtu të bëj vlerësimin e cilësive profesionale të pak atyre kuadrove që sillen përreth jush e që janë të gjinisë femërore.

Dhe, përballë gjithë kësaj që u argumentua më sipër, vijmë tek dilema e madhe, të cilën ju duhet sot këtu ta zbardhni para këtij Parlamenti.

Keni qenë të shtrënguar nga eprorët tuaj, përkatësisht nga politikat e Qeverisë që e aplikoni këtë diskriminim gjinor, apo ju, personalisht, jeni dizajnues dhe kreator i politikave diskriminuese gjinore.

Nëse është e para, zoti ministër, pse nuk e deklaroni pafuqinë tuaj për vendimmarrje. E, nëse është e dyta, ju, ky Parlament dhe qytetarët e Kosovës duhet ta kuptojnë se cili do të ishte hapi juaj më i ndërgjegjshëm dhe më kuptimplotë në lidhje me këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju njoftoj se ia keni marrë grupit 5 minuta. Për fjalë është në radhë deputeti Behgjet Pacolli.

BEHGJET PACOLLI: I nderuari Kryetar!

Ministra, kolegë,

“Shkoni ju në Kazakstan”! Kazakstanin ju e keni prishur, gjegjësisht koalicioni juaj kur ka thënë “Kazakstani është drejt”. Ajo më shkruhet dhe më thuhet gjithmonë, prandaj nuk keni të drejtë ta përmendni. Kazakstani i punëson sot 7 mijë punëtorë kosovarë, të cilët i ka pranuar pa pasaporta të rregullt dhe pa viza, prandaj duhet t’i falënderohemi atij shteti, tani për tani. Ata janë qytetarë të Kosovës dhe ata i mbajnë mbi 90 mijë anëtarë të familjeve të tyre dhe unë, para se ta them këtë, kisha menduar, zotëri, kolegë.

Zoti ministër, qytetari i Kosovës është në konfuzion sot. Ne kemi diskutuar, por qytetari i cili e përcjell këtë seancë, asgjë s’ka kuptuar. Tregoni ju tani – çka keni në plan të bëni me politikën e jashtme të Kosovës?

Keni thënë se Kosovën do ta pranojnë mbi 100 shtete deri në muajin shtator. Muaji shtator po kalon.

Ku është strategjia juaj? Me kënd kontaktoni? Çka do të bëni? Kush janë njerëzit të cilët ju ndihmojnë juve në implementimin e kësaj strategjie?

Zoti ministër, lobimi është pjesë përbërëse e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Ju nuk mund ta thoni këtë se lobimi nuk ka lidhje me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Kolegu, parafolësi pati të drejtë. Nëse ju nuk loboni, çka pritni, çka do të bëni aty. Ju do t'i zgjidhni problemet e mëdha botërore!? Ju nuk jeni në gjendje atë ta bëni.

Prandaj, loboni për njohjen e Kosovës nga shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Unë ju them se lobimi është me rëndësi dhe unë ju them sot dhe ju konfirmoj se në tri shtete kam lobuar dhe tri shtete e kanë njohur Kosovën. Po mos të kishte qenë ai lobim, ndoshta nuk kishin për ta njohur, sepse ka qenë votim i parlamenteve të këtyre shteteve dhe është dashur të bisedohet me secilin deputet veçmas.

Prandaj, zoti ministër, zgjedhni stafin tuaj, zgjedhni njerëzit. Ju kemi propozuar ne, si Aleancë Kosova e Re, njerëzit të cilët kishin për të kontribuar shumë më tepër në vend të ambasadorëve, njerëz me tradita, njerëz me të cilët janë propozuar prej këtij shteti, prej atyre shteteve ndoshta. Ju nuk i keni marrë në konsiderim.

Kam qenë edhe te Presidenti i juaj, gjegjësisht i koalicionit të juaj dhe se Presidenti deri tani nuk ka treguar se është President i Kosovës. Kam qenë dhe atë vizitë e ka minimalizuar si vizitë private. E kam qitur në tavolinë logjistikën tonë se ku ne mund të japim kontributin tonë. Besoni se AKR sot ka një logjistikë të fortë që mund të japë kontributin në njohjen e Kosovës nga shumë shtete sot, si të Amerikës Jugore, të Azisë, të Evropës. Prandaj, të bashkëpunojmë për këtë, ashtu sikur që e tha edhe Kryeministri, së bashku dhe të jetë si qëllim i përbashkët.

Ju, nëse e thoni këtë, që u dëgjua edhe nga kolegët tuaj të koalicionit, nuk dihet tani a jeni ministër apo jeni zëdhënës i dikujt. Nëse dikush tjetër vendos për politikën e jashtme të Kosovës, atëherë, zoti ministër, ju nuk jeni ministër. Atëherë, thoni se jeni zëdhënës, e asgjë tjetër. Pra, na tregoni çka mendojnë shefat tuaj për ardhmërinë politike dhe strategjinë e jashtme të Kosovës.

Në këto pyetje duhet të jeni të qartë dhe të përgjigjeni para qytetarit të Kosovës. Qytetari i Kosovës ka bërë çdo gjë për një ardhmëri, për një liri, për pavarësi. Prandaj, nuk duhet ta trajtoni me joseriozitet.

Dhe, ju duhet të na thoni, zoti ministër, çka na ndodhi neve që shumë anëtarë të Këshillit të Sigurimit dje u pajtuan që problemi, gjegjësisht iniciativa e Serbisë të hyjë në rend të ditës. Çka keni bërë ju me ta, me kë jeni takuar. Thoni me emër e mbiemër: me këtë, me këtë, me këtë. Atëherë, nëse jeni takuar me ta, ne do të kërkojmë falje ndoshta për mocionin që kemi bërë sot ndaj jush.

Me askënd nuk jeni takuar, zoti ministër. Jeni takuar, ndoshta nëpër qoshet e ndërtesës së Kombeve të Bashkuara me ndonjë nënsekretar, bile as me ambasadorë jo.

Zoti ministër, vitin e kaluar, më 26 tetor të vitit të kaluar, unë kam arritur në ndërtesën e Kombeve të Bashkuara për t'i bashkuar 4 presidentë dhe 3 kryeministra dhe kemi folur dhe shqyrtuar problemin e Kosovës. E ju, jo, zoti ministër. Prandaj, ju duhet të jeni shumë të qartë kur është fjala për ardhmërinë politike të Kosovës dhe keni përgjegjësi

shumë të madhe. Nuk duhet ta injoroni asnjë gjë, asnjë kritikë që shkon drejt jush, në këtë moment. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjala është për deputeten Njomza Emini. Ju njoftoj se keni vetëm një minutë kohë.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, Kryetar!

I nderuari ministër,

Përveç shkeljeve ligjore, me rastin e emërimit të të ngarkuarve me punë, Qeveria, Presidenca dhe Ministria juaj nuk janë përkushtuar aq seriozisht në seleksionimin e kuadrove që kanë qenë të ngarkuar për diplomaci, që edhe nuk kanë qenë me kualifikim superior.

Unë kam edhe argumente për secilin diplomat, mirëpo meqë ata janë nominuar nga Qeveria, unë do ta kisha bërë direkt një pyetje, do të thotë, për juve zoti ministër: - Cilat kanë qenë motivet e pushtetarëve të Kosovës për të emëruar në Berlin një qytetar i cili, siç shihet qartë, nuk i plotëson kushtet dhe i cili nuk është pritur mirë nga opinioni gjerman? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Veç ta keni parasysh, interpelanca është interpelancë dhe nuk është çështje e pyetjeve parlamentare. Vazhdojmë. Sipas radhës, e ka fjalën deputeti Berim Ramosaj, nga LDD. I keni edhe 3 minuta.

BERIM RAMOSAJ: Të nderuar deputetë,

Meqenëse u folën shumë çështje dhe pajtohëm me të gjithë ata deputetë që mendojnë se politika e jashtme është politikë shumë globale dhe pajtoj edhe me atë se politikën e jashtme të Kosovës nuk e bën Skender Hyseni, por është në fakt politikë që me Kushtetutë është e rregulluar, që bëhet edhe në vija të trasha, edhe në vija më të holla nga Kryetari apo Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri që, në fakt, Skender Hyseni duhet të jetë propozues dhe ekzekutor i asaj politike.

Meqenëse u prekën shumë çështje këtu, për të cilat kam pasur mendjen të flas dhe meqë mundësitë tona në kohë nuk janë aq të mëdha, unë vetëm kisha një vërejtje, më tepër kolegjiale për zotin Hyseni, si ministër.

Të gjitha ato premtime që iu kemi bërë përfaqësuesve të diasporës apo mërgatës shqiptare me vite të tëra se do të jenë të involvuar në procesin e ndërtimit të diplomacisë së Kosovës në ato vende ku ishin ambasadorë, pa letra, të një periudhe relativisht të gjatë në Kosovë dhe që vërtet mbrojtën çështjen e Kosovës, ngritën vlerat e kosovarëve dhe të shqiptarëve në përgjithësi dhe organizuan aq shumë tubime dhe që luajtën rolin e një diplomacie alternative në Kosovë për vite të tëra – u harruan në procesin e ndërtimit të përfaqësuesve tanë në këto dhjetë vende si përfaqësues, qoftë si ambasadorë, qoftë si përfaqësues në nivel sekretarësh.

Unë e kuptoj se diplomacia e Kosovës është diplomaci e koordinuar dhe tani e shfrytëzoj rastin të përshëndes dhe të falënderoj Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat bënë edhe atë që ne ishte dashur ta bëjmë. Por, prapëseprapë ajo pjesë e punës që ka mbetur e jona për t'u kryer, që është pjesë krejtësisht teknike, është çështje e ministrit, që është dashur ta respektojë ligjin dhe në procesin e përzgjedhjes së sekretarëve të ambasadave është dashur të hapë konkurs, të involvojë së pari përfaqësuesit tanë të diasporës apo mërgatës shqiptare, të cilët vërtet janë të indisponuar dhe bile janë ndoshta edhe të ofenduar me një

proces të tillë. Andaj, mbaj obligim, të cilin obligim shumë vite më parë, si kolegë apo si përfaqësues të Presidentit, e kishim të dytë së bashku, por ky i harroi shumë shpejt ato obligime që i kishte marrë në atë periudhë.

Kjo ishte çështje, e cila më preokupoi si çështje, ndoshta më e ngushtuar. Nuk dua të marrë minutazhin e përfaqësuesve të tjerë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Minutazhin e ke harxhuar! Sipas radhës, e ka fjalën deputetja Muzejene Selmani, një minutë. Meqë deputetja s'është këtu, atëherë fjalën e ka Suzan Novobërdaliu, sipas radhës.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Jemi të vetëdijshëm se prezenca në botën arabe ka qenë mjaft e zbehtë, me vetëm një vizitë e cila nuk u konkretizua me nivele të qeverive, nga të cilat presim njohje. Ju u takuat me sekretarin e Organizatës së Konferencës Islamike, i cili ka më shumë rol teknik në mbarëvajtjen e kësaj Organizate, sesa në influencimin e vendimmarrjes politike. Ju nuk keni tentuar në asnjë mënyrë që të argumentoni si ministër i parë i Punëve të Jashtme nevojën e botës arabe në raporte të reja me Kosovën.

Më lejoni që të përmend vetëm një fakt se në Kosovë ekzistojnë kontingjente ushtarake në kuadër të KFOR-it, siç janë kontingjenti Maroken, me spitalin ushtarak, kontingjenti nga Pakistani, kontingjenti nga Egjipti e të tjerë që shërbejnë në Kosovë nga fillimi dhe këto kanale nuk i keni shfrytëzuar asnjëherë. Kjo sjellje e çuditshme në raport me këto shtete që janë prezente në Kosovë, padyshim se ka konotacione negative, kur dihet se këto struktura iu raportojnë qeverive të tyre në vazhdimësi për zhvillimet politike në Kosovë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Arsim Rexhepi, që ka kohë për një minutë.

ARSIM REXHEPI: Ajo që deshi opozita, është të kërkojë "Thembrën e Akilit" në Qeverinë Thaçi dhe indirekt këtu sot është sulmuar Hashim Thaçi dhe Fatmir Sejdiu, ndërsa e gjithë kjo, që pretendon të quhet interpelancë, e ka forcuar edhe më shumë zotën Skender Hyseni dhe ka dëshmuar dhe vënë në pah një mosnjohje totale të gjeostrategjisë politike nga ana e tyre që kanë kërkuar këtë interpelancë.

Richard Hollbruck ishte para do dite këtu dhe të gjithë u çuam i duartrokitëm për ato të cilat ai i tha dhe ai tha se është një luftë në mes Amerikës dhe Rusisë për njohjen e Kosovës. Të tentosh, është edhe e kundërta, e edhe unë mund të them ashtu. Të tentosh sot ta kryqëzosh Skender Hysenin pse nuk njihet Kosova nëpër botë, është njësoj sikur ata dje që kanë bërë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Driton Tali, gjithashtu për një minutë.

DRITON TALI: Faleminderit!

Pikësëpari më lejoni të diferencohem, nuk jam me një parti me Arsim Rexhepin.

Një minutë, e kemi shumë të vogël, zoti Kryetar. Por megjithatë, po e shfrytëzoj t'i falënderohem këtu ministrit, por edhe disa të tjerëve për ligjërata, për diplomacinë dhe, për tjetër send s'mjafton kjo minutë. Për diplomacinë, unë e ndjej veten të iluminuar me gjithë ato shpjegime që u dhanë në lobim. Ishte kënaqësi të dëgjosh, aq më shumë kur e kam parasysh eksperiencën e tij diplomatike, është pjesë e aristokracisë diplomatike botërore. Ne jemi të nderuar që e kemi si ministër! A kam filluar të tingëlloj si Arsimi, po më duket!

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ke marrë, jo si në një parti me Arsimin, por si deputet. Fjalën e ka deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Ftesa për interpelancë të anëtarëve të Qeverisë para Kuvendit të Republikës së Kosovës është e drejtë ligjore e deputetëve dhe e grupeve parlamentare, e përcaktuar edhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Por, për të ftuar në interpelancë ministrin, zëvendëskryeministrin apo Kryeministrin, duhet të ketë arsye, në mënyrë që, si deputetët, edhe opinionin publik të kuptojë rëndësinë e thirrjes në interpelancë dhe vlerësimin e punës së Ministrisë apo të Qeverisë.

Me vëmendje dëgjuam arsyen dhe brengat e Grupit Parlamentar të AKR-së lidhur me punën e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të ministrit në këtë Ministri. Gjithashtu, dëgjuam edhe raportin e punës së ministrit, zotit Skender Hyseni, për punën që e ka bërë dhe është duke e bërë kjo Ministri.

Duke krahasuar vërejtjet e opozitës në lidhje me punën e kësaj Ministrie dhe raportin e ministrit Hyseni, mendoj se vërejtjet dhe brengat e opozitës janë të pabazuara dhe se interpelanca është e parakohshme.

Dinamika e njohjes së Republikës së Kosovës nga vende që ende nuk e kanë njohur, nuk varet vetëm nga Ministria dhe Qeveria, por varet nga shumë faktorë, përfshirë këtu edhe angazhimin e opozitës.

Mendoj se Kosova ka gëzuar njohje shumë të rëndësishme, pasi që vendet më të fuqishme të botës na kanë njohur shikuar nga aspekti ekonomik, politik, ushtarak dhe demokratik. Këto vende kanë dominim kryesor në mbarë botën. Andaj, duhet t'iu jemi mirënjohës.

Maqedonia e ka shpallur pavarësinë para 17 vjetësh dhe deri më tani është e njohur nga rreth 160 vende, që do të thotë, është njohur nga më pak se 10 vende për çdo vit. Ndërsa, Republikën e Kosovës e kanë njohur tashmë 47 vende për më pak se 6 muaj.

Ministria dhe Qeveria janë duke kryer punën në mënyrë të suksesshme konform Kushtetutës dhe ligjit, gjë që duhet përgëzuar. Për të konstituuar ministrinë nga themelimi, nevojitet së paku një vit. Ndërsa, Ministria e Punëve të Jashtme ende nuk i ka mbushur 5 muaj nga themelimi i saj. Andaj, mendoj se Ministria në këtë kohë ka treguar mjaft sukses.

Sa i përket emërimit të shefave të misioneve diplomatike, mendoj se ligji e përcakton shumë qartë mënyrën dhe procedurën e përzgjedhjes së tyre. Nuk qëndron vërejtja se Komisioni parlamentar për punë të jashtme duhet të bëjë përzgjedhjen e ambasadorëve. Neni 7, pika 2, thotë: “Ministri i Punëve të Jashtme, në konsultim me Presidentin dhe Kryeministrin, ia dërgon një listë të ngushtë prej 3 kandidatëve Komisionit për Punë të Jashtme për secilin post vakant, i cili do të verifikonte se kandidatët a i plotësojnë kriteret sipas nenit 6 të këtij ligji”. Por, raporti i Komisionit nuk përbën rekomandim lidhur me kandidatët. Nga ana tjetër, Ministria është duke themeluar misionet diplomatike. Pra, nuk kemi pasur misione dhe nuk i kemi njerëzit dhe vendet janë vakant.

Pajtohem me kërkesën që Ministria e Punëve të Jashtme dhe Qeveria sa më parë që të jetë e mundur të hapë konsullata në ato vende ku ne e kemi diasporën tonë, për shembull, në Zvicër, Gjermani, Itali, SHBA, Francë, e tjera. Pra, mendoj se të gjitha vërejtjet që janë bërë në këtë drejtim, kanë më tepër qëllime propagandistike dhe asgjë më tepër.

Në fund, më lejoni që në emrin tim, si deputet i Parlamentit të Kosovës, dhe në emër të demokristianëve të Kosovës, t’i përcjell mbështetje të plotë Ministrisë, ministrit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Zoti ministër,

Duke respektuar dhe mirëkuptuar kërkesën e kolegëve opozitarë për zhvillimin e kësaj interpelance në Kuvend, dëshiroj të përcjell në këtë sallë edhe mendimin tim rreth çështjes që po debatohet.

Do ta nis diskutimin duke iu referuar njoftimit më të fundit të mediave – Samoa njeh zyrtarisht shtetin e pavarur të Kosovës. Ky shtet, që gjendet në pjesën jugore të Oqeanit Pacifik, shënon anëtarin e 47 të OKB-së që njeh zyrtarisht shtetin tonë.

E përmenda këtë fakt për të dalë më drejtpërdrejt në thelbin e shqetësimit të kërkesës për zhvillimin e kësaj interpelance me ministrin Hyseni që, për mua, është ngadalësimi i njohjes së shtetit të pavarur të Kosovës nga subjektet shtetërore të komunitetit ndërkombëtar.

Pas bumit të njohjeve ndërkombëtare, menjëherë pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë prej nesh, pati njëfarë ngadalësimi, që nganjëherë nga disa edhe është përjetuar e konsideruar “si stopim”.

Njohja ndërkombëtarisht e pavarësisë së Kosovës nga demokracitë më të konsoliduara dhe më të fuqishme të globit. Pavarësia jonë u njoh shumë shpejt nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe 21 vende të BE-së. U njoh menjëherë nga 3 prej 5 vendeve me të drejtë vetoje në Këshillin e Sigurimit. U njoh nga 7 shtete të G-8-shes, krijoi te të gjithë ne jo vetëm iluzionin, por edhe bindjen për pandalshmërinë e njohjes nga shtetet e bashkësisë ndërkombëtare. Dhe, kur prisim që rrjedha e njohjeve ndërkombëtare të vazhdojë me të njëjtin ritëm, përjashtuam ngadalësimin, madje edhe njohje, dhe në ndonjë rast edhe kundërshtimin. Kjo është një dukuri që bie ndesh me dëshirat dhe aspiratat e mbarë kosovarëve dhe të gjithë shqiptarëve. Dhe, dëshira, jo rrallë, bie ndesh me arsyen. Një

pjesë e konsiderueshme e opinionit, por edhe klasës politike kosovare ia faturojnë ngadalësimin e njohjes së shtetit të Kosovës nga anëtarët e OKB-së fshehtësisë ose, e thënë edhe ndryshe, paafësisë dhe inaktivitetit të diplomacisë së shtetit të Kosovës. Dhe, për këtë kemi thirrur sot këtu të përgjigjet dhe të japë llogari ministri i Jashtëm. Bëjmë mirë se e nxisim atë dhe gjithë stafin e dikasterit për më shumë angazhim në misionin e tyre. Mirëpo, për kushtet tona, që mendoj janë specifike, duhet të mos harrojmë: Në Rambuje, në ballafaqim me Serbinë, Kosova nuk u përfaqësua nga diplomatë karriere, por nga personalitete të përkushtuara dhe me kontribute të njohura për të arritur pavarësinë e Kosovës dhe delegacioni ynë nuk gaboi.

Në bisedimet 120-ditëshe, të ndërmjetësuara nga Grupi i Kontaktit, përfaqësuesit e Kosovës, që nuk pretendojmë të kenë mbaruar shkolla diplomacie, arritën të ballafaqoheshin me dinjitet me përfaqësuesit e Serbisë me përvojë gati 200 vjeçare si shtet dhe diplomaci aktive. Secili prej nesh, pjesëtar në këtë sallë, pa marrë parasysh përkatësinë partiake apo statusin pozitë – opozitë, ka bërë diplomaci në çdo rast takimi zyrtar apo miqësor me zyrtarë të lartë të shteteve të tjera për njohjen dhe mbështetjen e shtetit të pavarur të Kosovës.

Ministria jonë e Jashtme, si dikaster më i ri, nuk ka përvojën e duhur profesionale dhe historike. Kosovës, edhe kur ishte Krahinë autonome dhe subjekt thjeshtë i barabartë me status brenda Federatës jugosllave, i ishte mohuar jo vetëm struktura, por edhe çdo raport i mëvetësishëm diplomatik me vendet e tjera. Shqiptari mund të shkollohej për diplomat vetëm në Beograd dhe mund të njihej e ta ushtronte punën vetëm me miratimin dhe bekimin e Beogradit.

Në përfundim të këtij diskutimi, dua të vë në dukje një sentencë: “trishtimi – shqetësimi fillon kur nuk vlerësohen ato që janë arritur”. E them këtë, sepse kam përshtypjen se nuk po i vlerësojmë, siç e meritojmë, arritjet tona pas shpalljes së pavarësisë. Në gati 7 muaj pas shpalljes së pavarësisë jemi njohur nga 47 shtete. Priten së shpejti njohje nga Maqedonia, Mali i Zi dhe, sipas deklaratës së Presidentit Sejdiu, Kryeministrit dhe institucioneve të shtetit, Greqia dhe vende të tjera të rajonit që ende nuk janë shprehur mbi qëndrimin që do ta bëjnë për pavarësinë, do ta njohin së shpejti shtetin e ri.

Thirren zyrtarisht në takim me Presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës Presidenti dhe Kryeministri i shtetit të Kosovës. Nuk është pak. Drejtori i Komisionit Evropian për Ballkanin Pjer Mirel deklaroi para 5 ditësh se Kosova de-facto është në procesin e stabilizim-asocimit me Bashkimin Evropian, ndonëse ajo, de-jure nuk ka nënshkruar një marrëveshje të tillë. Projektuesi dhe arkitekti i statusit të strukturave të shtetit të sotëm të Kosovës, zoti Marti Ahtisari, i cili duke dhënë mendimin e vet për zëvendësimin e UNMIK-ut nga EULEX, që po ecën më ngadalë nga sa ishte parashikuar, shprehet thjeshtë: “Një vonesë e vogël, jo katastrofike, ndërsa treni ka kaluar tashmë stacionin”.

Në fund të fjalës, dua të vlerësoj angazhimin e institucioneve të shtetit të Kosovës që për herë të parë promovuan 10 ambasadorë dhe ndërmori nisma personale në funksion të njohjes ndërkombëtare të shtetit të Kosovës. Në arritjet apo mosarritjet e këtyre nismave dhe këtë e dinë të gjithë në këtë sallë, duhet të mbajmë parasysh statusin tonë, konjunkturën politike, ekonomike dhe strategjike ndërkombëtare. Po të mbajmë në vëmendje këta elementë, do të bindemi se personalizimi i pakënaqësive apo vërejtjeve tona ndaj politikës së jashtme të Kosovës nuk është shumë i arsyeshëm. Faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti Haliti! Ju njoftoj se PDK-ja i ka edhe 13 minuta, LDK-ja edhe 7 minuta. Të tjerët i kanë harxhuar minutat e vet. E thërras, sipas rendit, për fjalë Hajdin Abazin.

HAJDIN ABAZI: Zoti kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Me të vërtetë, unë personalisht kam pritur nga kjo interpelancë se do të kritikohet mungesa e vizionit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, por njëherësh edhe do të jepen në një farë mënyre udhëzime ose propozime se çka duhet bërë në të ardhmen, se si duhet ndrequr kjo që është menduar se nuk është në rregull. Për fat të keq, propozime të tilla konstruktive që do ta ndihmonin Ministrinë e Punëve të Jashtme për të ecur përpara, unë nuk dëgjova, me ndonjë përjashtim. Këtu doli konkretisht fjala e zotit Pacolli dhe nxori në shesh se ka disa mundësi që të jepen kontribute për njohjen e pavarësisë dhe besoj se kjo do të merret parasysh edhe nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Mendoj se fryma vetëm për të kritikuar nuk ka shumë vend në këtë moment. Jo se janë punët për mrekulli, por pikërisht se jemi në fillim të krijimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe, sikur që të gjithë e dimë, sapo u emëruan dhjetë diplomatët e parë.

Unë jam njëri nga disa që kemi përvojë nga aktiviteti jashtë vendit dhe e di saktësisht se sa është vështirë për të depërtuar në ato vende të cilat nuk janë të gatshme për të pasur qëndrime pozitive ndaj Kosovës. Me dekada, jo me vite, por me dekada, vende të ndryshme të Bashkimit Evropian nuk kanë dashur as të dëgjojnë dhe as ta qajnë kokën për gjendjen në Kosovë duke mohuar realitetin ekzistues. Është dashur një veprimtari kontinuitive, do të thotë, me dekada, të ndryshohet ajo dhe sidomos proceset e vendeve, që ndodhën, e ndryshuan atë bindje. Tani, vërtet, Kosova ka nevojë për një dinamizëm më të madh në kuadër të diplomacisë, përkatësisht të politikës së jashtme. Prej disa kontakteve që edhe unë personalisht i kam pasur dhe këtu duhet të fokusohemi kryesisht në dy aspekte, në njërin aspekt – forcimi, bashkëpunimi edhe i lidhjeve tona me vendet që na kanë njohur, përfitimi më i madh i ndihmave nga ta dhe sidomos i përvojave, dhe, në anën tjetër duhet ta angazhohemi në ato vende të cilat nuk janë ende, për një arsye ose për një tjetër, të gatshme të na njohin dhe të zbulojnë cilat janë pengesat e tyre dhe ne pastaj të gjejmë mënyra se si mund të veprojmë për t'i eliminuar ato paqartësi dhe të shtojmë gatishmërinë e atyre vendeve për ta njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës. Dhe, mund të them se, nga pak informacione prej kontakteve që kam pasur edhe gjatë kohës së pushimeve, vërtet ka disa vende që janë të gatshme dhe duan të kenë informacion më të madh se çfarë po ndodh në Kosovë, cili do të jetë rregullimi i brendshëm që të mund të veprojnë më me siguri për të njohur shtetin tonë. Dhe, kjo është detyra jonë që duhet ta bëjmë. Kjo është detyra parësore e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Mendoj që edhe diskutimi i sotëm do të jetë një stimulim i mirë për të bërë një strategji më efikase dhe të gjithë ne që jemi në këtë sallë, edhe si deputetë, kemi mundësi përmes formave të ndryshme të japim kontributin tonë që njohja e pavarësisë së Kosovës të ecën përpara.

Kur është fjala për njohjen e shtetit të Kosovës, për njohjen e pavarësisë sonë, konsideroj se këtu nuk duhet të ndahemi në opozitë dhe pozitë, sepse të gjithë jemi shtetas të shtetit të ri dhe të gjithë e kemi për detyrë, në radhë të parë të kontribuojmë për njohjen, e pastaj të përpiqemi edhe t'i eliminojmë të metat dhe defektet që janë manifestuar.

Potenciali dhe përvoja që ekziston nga veprimtarët e ndryshëm në kuadër të diasporës, do të jenë një bazament i mirë dhe mundësi e mirë që Ministria e Punëve të Jashtme t'i shfrytëzojë në të ardhmen për ta dinamizuar punën dhe për të dhënë efekte më të mëdha.

Unë dëshiroj sukses dhe kam besim se do t'ia dalim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Sadik Idriz, që i ka në dispozicion 3 minuta për grupin e vet.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedavajući! Optimizam je pozitivno osećanje, ali kada čujemo danas da je posao završen – puna është krye, mislim da je to dosta komotno izrečeno i to smo čuli od predsednika Parlamenta.

Ja mislim da će posao biti završen onda kada Kosovo postane članica Ujedinjenih nacija i drugih međunarodnih organizacija. Sve dotle, naši ljudi imaju problema. Imaju problema u svetu. Samo da znate koliko se maltretiraju sa dokumentacijom, sa pasošima, sa priznavanjem – nepriznavanjem, sa diplomama ovde i u okruženju. Zatim, koliko naši ljudi imaju problema na Kosovu po pitanju zapošljavanja i sve je to u jednu ruku i proizvod posledica onoga što Kosovo još nije ravnopravna članica mnogih organizacija i ne može da koristi privilegije koje koriste drugi.

Ako tako komotno posmatramo, taj proces će biti dugotrajan. Samo da kažem kakve probleme imaju kosovski sportisti, koji ne mogu da učestvuju, koji ne mogu da idu napred, i tako dalje.

Porediti Kosovo sa Makedonijom u pogledu priznavanja i broja zemalja, mislim da je neprimereno, jer Makedonija nije imala prepreke kakve ima Kosovo u Savetu bezbednosti. Makedonija je nastala raspadom prethodne Jugoslavije, ali je nešto u povoljnoj situaciji od Kosovo, kao što su bile Slovenija, Hrvatska i tako dalje.

Jedan problem koji je započet i koji ima i u ovom Parlamentu i u opšte na Kosovu, jeste jedno osetljivo pitanje – odnos prema islamskim zemljama. 58 islamskih zemalja su značajan faktor u svetu. Ne možemo mi posmatrati... Jeste, Ustav Kosova garantuje da je Kosovo sekularna odnosno laička država, ali mi ne možemo posmatrati i biti sa takvih pozicija. Šest zemalja islamskih zemalja je priznalo Kosovo i to je veoma malo. Među njima Albanija, Turska, Senegal, Siera Leone. Albanija je islamska zemlja i Salih Berisha je davnih 90-tih godina učestvovao na Samitu Islamskih zemalja a i učestvuje i danas. Ne možemo posmatrati, znači, i imati takav odnos. Samo da kažem, kada je Bush prije posete i dolaska u Albaniju na jedno pitanje: zna li u koju zemlju odlazi u posetu? Odgovorio je: “znam, to je jedna muslimanska zemlja u Evropi”. Ne možemo mi posmatrati takvim očima. Kosovo je multikonfesionalna zajednica – država i boriće se za prava svih verskih zajednica, ali ne možemo mi pobeći istini da 90 i više posto stanovnika su islamske veroispovesti. Nije priznavanje čin islamski, to je najmanje, ali moramo voditi računa znači i u tom sensu. Možda ima razloga, zbog nekada našeg odnosa, da islamske zemlje nas ne priznaju ...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për korrektësi, ju informoj se PDK-ja i ka 9 minuta dhe janë paraqitur për fjalë 6 vetë. Unë po ua jap fjalën të gjashtëve me rend. Nëse e harxhon kohën i pari, të tjerët mbeten... E ka fjalën Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: I nderuari, zoti kryesues,
Të nderuar zotërinj deputetë,
Me keqardhje mund të them se interpelanca e sotme më ka zhgënjyer si qytetar i Kosovës dhe si deputet.

Unë mund t'ju them se defektet e ish sistemit totalitar monist ekzistojnë edhe në këtë sallë dhe nga këto defekte nuk e kisha përjashtuar as veten time. Mirëpo, mund t'ju them se një prej defekteve në vetëdijen tonë të bartur nga sistemi totalitar, është edhe linçimi i njerëzve. Dhe, kjo interpelancë m'u duk si një linçim ndaj një kolegu tonë që për momentin – çastin është edhe ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës.

Një prej defekteve tjera të totalitarizmit në mendjen tonë është edhe egocentrizmi, sepse njerëzit mendojnë se nuk janë vetë në një pozicion, se sikur të kishin qenë aty gjithçka do të rridhte mirë dhe gjithçka do të shkonte në rregull dhe se vetëm ata janë të thirrur për të zgjidhur një problem të caktuar. Ky defekt vjen edhe nga traditat tona kanunore, prej këtyre traditave të anës më të errët të kanunit të autoritarizmit si një kategori tradicionale e etnokulturës sonë.

Problemet tjera, që u shfaqën këtu gjatë këtij debati, janë shqetësuese për kulturën e debatit politik brenda institucioneve të Kosovës dhe, në përgjithësi, në shoqërinë tonë kosovare.

Unë do të isha futur akoma në analizat e kësaj natyre, mirëpo do të mundohem që të mos bie edhe unë pre e këtyre defekteve.

Një prej defekteve tjera të politikës, në përgjithësi, si veprimtari shoqërore është edhe manipulimi, intriga konspiracioni. Këtu u vërejt qartë se opozita dhe një pjesë edhe e deputetëve që janë të pozitës, për shkak të pakënaqësive të veta personale dhe pasionit të tyre për pushtet, për shkak të mosrealizimit të ambicieve brenda partive ekzistuese në pozitë, tentuan të përdorin manipulimin e opinionit si një kategori politike për të krijuar një opinion në Kosovë dhe më gjerë.

Unë po ju them se të gjitha këto tri kategori që i përmenda janë mjete politike, mirëpo janë mjete ireale të politikës. Dhe, ju kisha dëshiruar që konteksti i njohjes së pavarësisë së Kosovës dhe, përgjithësisht, forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit të ri të Kosovës, të mos shfrytëzohet në Parlament në të ardhmen me atë se gjëja për të mirën e qytetarëve po flasim këtu e nëpërmes shumë vështirësive, që kanë qytetarët e Kosovës, të mundohen individët të realizojnë qëllimet e veta politike dhe interesat e veta politike.

Unë ju them se u ngritën shumë shqetësime për të cilat unë nuk mendoj se jam i thirrur, por mund t'ju them se në asnjë rast, në asnjë vend, në historinë e mendimit politik, në historinë e krijimit të shteteve, të subjekteve ndërkombëtare – njohjet nuk kanë ardhur si rezultat i interesave, si rezultat i simpatie qofshin ato ideologjike, qofshin ato fetare apo të simpatie individuale të një shteti ndaj një individi, të një shteti aspirant për t'u bërë subjekt ndërkombëtar.

Ishin krejt absurde disa diskutime këtu se gjëja “unë kam kontribuar personalisht që Kosovën ta njohin 3 shtete aktualisht”. Nuk ka një shtet në botë që mund të sakrifikojë interesat e veta ose të bie nën ndikimin e një individi për ta njohur një shtet ndërkombëtarisht. Është krejt absurde kjo ide.

Fuqia diplomatike e Kosovës, zotërinj të nderuar këtu, varet nga fuqia ushtarake e saj, nga fuqia politike e saj, nga fuqia ekonomike e saj dhe nga pozicioni i saj gjeostrategjik. Në asnjë vend të botës nuk mund të projektohet një politikë e jashtme pa i pasur parasysh këto elemente të cilat i thashë unë. Edhe fuqia politike, edhe fuqia diplomatike e Qeverisë së Kosovës dhe e ministrit të nderuar, varet nga këto që unë i përmenda.

Këtu u dha një ide se gjëja në Kosovë ka deficite diplomatike, sidomos në përzgjedhjen e kandidatëve për diplomatë. Në rast se dikush ka dëgjuar për emrin e Karll Dojçit, një këshilltar për siguri kombëtare në disa qeveri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ai thotë se në aspektin e përgatitjes profesionale diplomatike, diplomatët amerikanë janë pothuaj se më të dobët, jo më të dobët në botë, por më të dobët se diplomatët që vijnë nga bota e tretë. Mirëpo, fuqia ushtarake, ekonomike dhe politike e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ua mbulon këto dobësi diplomatëve amerikanë. Kurse, diplomatët që vijnë nga bota e tretë janë shumë më të formuar intelektualisht, shumë më të zellshëm në punën e vet, sepse mundohen ato deficite që i ka shteti i tyre t'i kompensojnë me personalitetin e vet. Dhe, nuk është gjithmonë në diplomaci. Deficitet individuale diplomatike ose intelektuale të ministrit nuk janë gjithmonë përcaktues se a do të ketë një diplomaci ose një kryediplomat sukses në arenën ndërkombëtare, por është fuqia e shtetit e cila qëndron prapa atij diplomati. Dhe, në këtë kuptim, unë duke mos marrë më kohë të kolegëve të mi, sepse më duket edhe e teprova dhe rrëshqita, shkarazi, pa dashur në ato defekte të cilat i përmenda në fillim. Prandaj, unë besoj se me ndihmën e faktorit ndërkombëtar që është ndihmë e pakompensueshme, ne do të arrijmë t'i realizojmë qëllimet tona. Ngjarjet historike që kanë ndodhur në Kosovë e kanë mbyllur një epokë, por e kanë hapur një epokë të re dhe unë pajtohem shumë me ikonën e lirisë në Kosovë – me bacin Adem, që thotë: “Bac u nis”. U nis një epokë e re, e cila nuk do të jetë e lehtë për forcimin e shtetit të Kosovës. Nuk kisha dëshiruar që shtetet myslimane të udhëhiqen nga ndjenjat myslimane për ta njohur Kosovën si shtet sovran dhe demokratik. Kurse, nuk përfundon puna për shtetin e Kosovës, forcimin e subjektivitetit të tij ndërkombëtar me njohjen e Kosovës ndërkombëtarisht edhe me arritjen e subjektivitetit të saj ndërkombëtar në OKB. Ju falënderoj për vëmendjen. Po m' duket, vërtet e teprova.

KRYESUESI: Po de po, egoist, ia more partisë kohën. Edhe tre minuta i ka Ramadan Avdiu dhe, fund.

RAMADAN AVDIU: Unë, do të përpiqem t'i kursej dy minuta në mënyrë që të kenë mundësi edhe kolegët e tjerë të flasin.

I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ne do ta kemi vështirë si shtet që politikën e jashtme ta konsolidojmë edhe brenda këtij mandati, e të mos them brenda një seance. Prandaj, ajo çka është bërë deri tash, marrë parasysh raportet ndërkombëtare, marrë parasysh konfliktet e interesave në botë, konsideroj se ka qenë një vit shumë i suksesshëm për Kosovën, për diplomacinë e saj. Tani jemi futur, do të thotë, edhe në kornizimin e diplomacisë dhe të politikës së jashtme përmes mekanizmave edhe të Presidentit, të Kryeministrit dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e cila është në formim e sipër. Konsideroj se disa konstatime, që ishin të mëhershme, janë të paqëndrueshme. Janë të paqëndrueshme për arsye se, do të thotë, është vetëm për të thënë diçka dhe janë gracka të konstruktura përmes mediave në opinion publik. Kështu që, rreth politikës së jashtme ka pak nebulozë. Është mirë dhe duhet të falënderohet Grupi Parlamentar i AKR-së që e ka iniciuar këtë interpelancë në këtë debat, në mënyrë që të hiqen disa dilema dhe të ndahen dëshirat nga mundësitë.

Unë, për të mos u zgjatur, konsideroj se Ministria e Punëve të Jashtme, krahas angazhimit permanent për rritjen e numrit të njohjeve të shtetit të Kosovës, duhet të përqendrohet edhe në kompletimin e rregullativës ligjore në mënyrë që t'ua mundësojë misionet dhe konsullatat e ambasadave të Kosovës që të punojnë, sepse ato duhet ta mbështesin punën e tyre në ligj për punën protokollare dhe shërbimin diplomatik. Këtë duhet ta kompletojë shpejt dhe gradualisht, domethënë, të fokusohet më shumë për zhvendosjen e mekanizmit përcjellës të Stabilizim-asocimit në marrëveshje të plotë për Stabilizim-asocim. Do të thotë, unë e vlerësoj punën e Ministrisë së Jashtme deri tash që është bërë, natyrisht që e mira nuk ka kufij, por konsideroj se Ministria deri tash në hapat e parë për këta tre muaj ka bërë ose është përpjekur që të bëjë maksimumin nga vetja e saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Memli Krasniqi, e ka fjalën, për një minutë.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse unë kisha planifikuar të flas pak më gjatë, brenda një minute është e pamundshme të them diçka substanciale dhe këtë minutë po ia kaloj kujtdo prej kolegëve që janë pas meje.

KRYESUESI: Fjalën e ka Bujar Bukoshi.

BUJAR BUKOSHI: Faleminderit, zoti kryesues! A bën në fillim ta di sa minuta i kam.

KRYESUESI: LDK i ka 7 minuta të pashfrytëzuar ende, Bujar Bukoshi është anëtar i Grupit.

BUJAR BUKOSHI: Atëherë, faleminderit që më dhatë fjalën!

Ju përshëndes të gjithëve,

Zoti kryesues,

Zotëri ministra,

Zoti ministër i Punëve të Jashtme dhe të nderuar e të nderuara zonja e zotërinj deputetë, Natyrisht, është gati e pamundur që në mënyrë kështu koherente diçka të flitet kur njeriu nuk e di së pari as sa minuta i ka. Ndoshta në të ardhmen është mirë të mendohet kur ka këso temash interesante, që janë vërtet interesante, të pajtohen të gjithë deputetët që, të zgjatë ndonjë diskutim deri kah përtej syfyrit, për shembull. Pra, të diskutojmë mirë, e jo “alla-kazakstançe” por me një frymë kështu, vërtet si i ka hije kësaj shoqërie.

Unë do të filloja atëherë kështu, shpejt e shpejt dhe telegrafisht. Arsyeja pse kërkoja fjalë, sepse m'u mbush mendja më s'pari ta marr fjalën sepse kisha përshtypje se filloi kjo interpelancë ose ky debat të degjeneronte në banalitet. Pra, arsyeja e vetme që dola këtu është arsyeja e rezo deta. Do të thotë, kjo do të duhej të ishte emëruar i përbashkët i punëve tona në këto momente shumë dramatike dhe para se t'më kalojë minutazhi, e të mos kthehem, domethënë, t'më shpëtojë mikrofonin, së pari ta them qëllimin dhe atë motivin se cili është mesazhi im. Mesazhi im është që ta inkurajoj ministrin e Punëve të Jashtme, zotin Hyseni, që të vazhdojë të punojë me përkushtim dhe, natyrisht, t'i ketë në konsideratë të gjitha ato probleme që i kanë këto punët tona, institucionet tona, për të cilat mundet me të vërtetë në mënyrë shumë të gjatë të elaborohen dhe të gjenden 100 defekte. Por, defekti i seleksionimit negativ, për shembull, është një defekt i madh i joni. Zotëri ministrit nuk është mirë tash t'i hidhemi apo t'i gjuhemi në qafë dhe nuk do të ishte e ndershme dhe do të ishte shumë hipokrite që tani të bëhet një lloj, ta quaj,

vetëkënaqësie pseudoopozitare, e mos të përdor tash terma edhe më të forta. Edita tha se e ndien veten kompetente për politikë të jashtme. S’di a guxoj edhe unë të them që jam, që edhe unë jam pak kompetent, por t’ju përkujtoj se politika e jashtme e Kosovës, ashtu në atë formën primordiale të saj, ka filluar edhe në vitet e 90-ta, kur ne trokitnim nëpër dyer apo nëpër kancelari të niveleve nga më të ulëtat. Sot është përparësi, domethënë, e ministri duhet ta shfrytëzojë atë përparësi.

Por, edhe njëherë të kthehem rreth kësaj interpelance. Do të dëshiroja që iniciatorët e interpelancës t’i kenë rënë pishman kësaj pune. Herën e ardhshme ose të përgatitet interpelanca e mirë dhe të dilet e të bëhet debat si duhet. Pra, edhe njëherë, ju dëshiroj sukses në punët e ardhshme. Mos u brengosni për Kazakstanin fort. Kjo është kështu, një këshillë e imja personale, sepse gjithmonë ne po harrojmë se jemi njohur nga vendet më të fuqishme dhe s’bën të harrojmë sepse e kemi sponsorin e fortë. Përderisa është sponsori i fortë, Kazakstani ose Turkmenistani, Kirgistani e të gjitha ato republikat që janë shkëput nga Bashkimi Sovjetik, të cilat e kanë në mendjen e tyre që opozitën e tyre ta likuidojnë fizikisht, duke e torturuar në ujë të valë dhe duke e mbytur! Merreni me mend! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Janë kaluar të gjitha limitet e kohës. Shikoni, vetëm dy fjalë dëgjoni. Unë e di, nevojat lindin për të folur. Strikt po zbatohet Rregullorja për interpelancë. Bile, është kaluar koha. Ju tashti, nëse ia jep dikujt fjalën, e ka të drejtën edhe dikush ta lypë. Ti ke folur. Ti, vetëm një minutë, Besë. E ka fjalën Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Profesor, ju lutem, për një minutë nuk po e marr fjalën hiq, por po ju lus për procedurë. Edhe kur e ndatë kohën, sepse shkruan në Rregullore, në bazë të grupeve parlamentare, por ju e ndatë në proporcion një gjysmë ore me opozitën me një orë e gjysmë me pozitën dhe nuk ia ndatë deputetit strikt minutazhin e vet. Kjo nuk bën dhe kjo çështje duhet të diskutohet në seancën tjetër dhe të ngrihet mocion për shkelje të Rregullores dhe për shkeljen e të drejtës së deputetit. Ju lutem shumë, profesor a zotëri kryesues, unë mendova që do të kërkoj pikërisht ndoshta nga kolegët e pozitës të më japin mundësi 2-3 minuta dhe të diskutojmë si njerëz. Nuk kemi nevojë këtu as të fyhemi, as të ndahemi në pozitë e opozitë, as të themi kjo temë është relevante, as jorelevante, sepse është një interpelancë dhe duhet të diskutohet ashtu si duhet. Unë për një minutë nuk mund të them asgjë. Të lutem, të keni parasysht. Tek e fundit, opozita e ka ngritur këtë interpelancë dhe opozitës duhet t’i mundësohet...

KRYESUESI: Zonja deputete, zonja Gaxherri, ti po flet për temë krejt tjetër tërë kohën. Tema është shumë konkrete – interpelanca. Unë po ju them, me Rregulloren në fuqi, unë s’i kam ndarë, i ka ndarë Rregullorja. Unë erdha tash këtu dhe, ju lutem, fjalën e ka ministri i Jashtëm, Skender Hyseni, t’iu përgjigjet pyetjeve.

SKENDER HYSENI: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

(Trokitje në tavolinë, ndërhyrje)

Unë do të përpiqem që me krejt pak fjalë t’iu përgjigjem të gjithë parafolësve dhe do të filloj me përgjigjen në shqetësimet që ishin emëruar i përbashkët i shumë paraqitjeve. Kjo ka të bëjë me rolin, përkatësisht me kompetencat dhe pushtetet që i përcaktohen secilit prej nesh.

(Ndërhyrje e deputetes B. Gaxherri – nuk dëgjohet për transkriptim)

SKENDER HYSENI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Roli i Ministrisë së Punëve të Jashtme është i përcaktuar qartë me Kushtetutë dhe me ligjet në fuqi, siç është i përcaktuar qartë edhe roli i institucioneve tjera të Republikës, në radhë të parë të Presidentit dhe Kryeministrit të Republikës. Kjo më sjell te përgjigja në pyetjen tjetër – emërimi i të ngarkuarve me punë dhe procedurat e përfillura me këtë rast. Gjithnjë, në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjet në fuqi, natyrisht se emërimi i të ngarkuarve të përkohshëm me punë, jo ambasadorët, mos iu referoni këtyre të emëruarve si ambasadorë, sepse nuk janë ambasadorë, është bërë nga Presidenti i Kosovës në konsultim me Kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm. Është zgjidhje e përkohshme dhe zgjidhje e mesme deri në aprovimin nga ju të Ligjit për misionet diplomatike të Kosovës, që është kaluar në Qeveri dhe shumë shpejt duhet të mbërrijë në Parlament. Pse është vepruar kështu? Që të kompensohet nevoja për përfaqësim diplomatik shumë e madhe e Kosovës aktualisht, në njërën anë, dhe të shkurtohet rruga deri te përfaqësimi. E vetmja mënyrë për ta shkurtuar rrugën ka qenë përmes të emëruarve ose të ngarkuarve me punë të përkohshme. Posa ta aprovojë ligjin ky Kuvend, i cili ligj është dashur të presë hyrjen në fuqi të Kushtetutës dhe të Ligjit themelor për Ministrinë e Punëve të Jashtme, do të shpallen konkurset për të gjitha dhjetë vendet e themeluara tashmë dhe për një numër ambasadash tjera të cilat Kosova do t'i themelojë në progresion gjatë vitit të ardhshëm.

Përzgjedhja dhe përfaqësimi i gruas. Deputetja Hajzeraj, iku. Nuk priti ta dëgjojë përgjigjen time, sepse më bëri përshtypje. Dhe, për hir të korrektësisë ndaj, absolutisht, mbi 50% të popullsisë së Kosovës, unë dua të them këtu – 4 nga 9 drejtorë, gati 50% të punësuar tashmë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, janë të gjinisë femërore. 2 nga 4 këshilltarët aktual që ka ministri i Jashtëm, janë të gjinisë femërore – 50%.

Me hapjen e konkursit për ambasadorë, natyrisht që secili qytetar i Kosovës është i mirëseardhur të konkurrojë dhe unë e siguroj këtë Parlament, por mbi të gjitha, e siguroj 50%-shin e popullsisë së Kosovës, që ministri i Jashtëm i Kosovës, Ministria e Jashtme e Kosovës dhe asnjë institucion tjetër nuk ka paragjykime, përkundrazi, ka preferenca që ta avancojë dhe shtyjë tutje integrimin dhe avancimin e gruas në institucione dhe në gjithë jetën politike e shoqërore të Kosovës.

U përmend Çekia dhe Shqipëria. Edhe ata, që e shtruan këtë dilemë, nuk janë këtu për ta dëgjuar përgjigjen. Madje u shtrua edhe Çekia dhe Shqipëria si sugjestion pse duhet të shkojë ministri i Jashtëm në Çeki kur Çekia na ka njohur. Ministri i Jashtëm i Kosovës është ftuar nga ministri Shvarcenberg që e merr kryesinë e Unionit Evropian më 1 janar të vitit të ardhshëm dhe ky takim ka prodhuar absolutisht rezultate shumë të prekshme për Kosovën dhe diplomacinë e Kosovës. Për herë të parë Kosova do të akreditojë njerëz zyrtarë të lartë ndërlidhjeje në Ministrinë e një kryesuesi të radhës së Bashkimit Evropian. Është ky një prej rezultateve të këtij takimi. Pastaj, bashkërendimi rreth iniciativës serbe, rreth lobimit me vendet që na kanë njohur, është i domosdoshëm, është i pazëvendësueshëm. Është i pazëvendësueshëm sidomos me Republikën e Shqipërisë dhe me shumë vende të tjera në rajon që janë përkrahëse të Kosovës. Dhe, nëse logjika thotë që Ministria e Punëve të Jashtme dhe ministri i Jashtëm duhet të takojë vetëm përfaqësues të vendeve që s'na kanë njohur, e te kjo do të vi tash së shpejti, është logjikë totalisht e mbrapshtë dhe e rrotulluar përmbys.

Pjesëmarrja në samite, zoti Luzha e shtroi. Nuk ka samit shumëpalësh në të cilin Kosova nuk ka bërë kërkesë të marrë pjesë dhe që nuk ka bërë përpjekje madje edhe përmes

shteteve më të fuqishme në botë që të jetë e pranishme. Dhe, jo në të gjitha rastet, ka qenë e suksesshme. Sepse, Kosova, ose nuk është anëtare e organizatave që kanë organizuar samite ende, ose është në gjysmë të rrugës për t'u bërë anëtare.

Juve, të gjithëve ju kujtohet e gjithë situata gati skandaloze në Samitin e procesit për bashkëpunim në Evropën Juglindore, në Promorje, kur natyrisht, Kosova mori pjesë, e shfrytëzoi mirë edhe për të lobuar. Ministri i Jashtëm e pati fjalën, ministri i Jashtëm e ka marrë fjalën edhe në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit dhe ministri i Jashtëm edhe Ministria e Jashtme, edhe Presidenti edhe Kryeministri do të jenë gjithandej ku iu mundësohet dhe janë duke u bërë përpjekjet maksimale. Është shtrembërim i skajshëm i të vërtetës nëse thuhet ndryshe. Dhe, është, madje – madje do të thosha, është një vlerësim i lehtë apo një justifikim i lehtë dhe mua më vjen keq kur gjenden justifikime të tilla të lehta për mungesa në rrafshet në të cilat Kosova nuk e ka mundësinë të ndikojë. E thamë më herët, ka një parabolë mbi Kosovën dhe pika në atë parabolë ku ndeshen interesa të llojllojshme dhe të cilat ndonjëherë përthyhen edhe në kurrizin e Kosovës, por pa fajin e Kosovës. Pa fajin edhe të opozitës dhe unë do të flisja krejtësisht njësoj edhe sikur njëri nga opozita, që fliste me zë shumë të madh, sikur nuk dëgjonim ne të tjerët, e unë e siguroj se veshët i kam krejt në rregull edhe ju besoj të tjerët njësoj, dhe e kemi dëgjuar çka ka pasur të thotë.

Çka po bën Kosova rreth iniciativës serbe? Ka bërë, të gjitha çka janë të mundshme. Përgjigja është: Kam takuar mbi 100 ambasadorë, më pak ministra të jashtëm për shkaqet që i përmenda më herët. Dhe, iniciativa serbe është një prej pikave kyçe që është rrahur në të gjitha këto takime. Sepse, iniciativa serbe nuk është prej dje, kur është futur në rend dite dhe janë bërë përpjekje edhe dje nga vendet kyçe përkrahëse të Kosovës që të parandalohet edhe futja në rend dite. Dhe, natyrisht, Presidenti i Kosovës dhe ministri i Jashtëm, gjatë qëndrimit të tyre në Nju – Jork, jo për të marrë pjesë në mbledhje të Këshillit të Asamblesë së Përgjithshme, sepse s'jemi anëtar dhe s'marrim pjesë. Në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme kanë bërë kërkesa për mbi 70 takime kryesisht, për të mos thënë ekskluzivisht, me vende që nuk na kanë njohur ende, me një të vetmin qëllim. Dhe këtë po ua them troç – e kemi përkrahjen e fuqishme të 5-shes ndërkombëtare, madje edhe përkrahjen e tyre që të vijë....

KRYESUESI: Zoti ministër, 10 minuta i bëtë. Ua jep edhe një minutë, të rezymoni!

SKENDER HYSENI: Zoti kryesues, unë për një minutë po përpiqem ta rezymoj, por vërtet është e pamundshme, prandaj kërkoj të paktën 3, për ta rezymuar. Sepse, këtu u ngritën shumë çështje.

Përfshirja e segmenteve të tjerë të shoqërisë Kosovare në lobim. Asnjëherë Ministria e Jashtme nuk ka thënë se s'janë të mirëseardhur të gjithë ata që mund të llobojnë. Përkundrazi, ka qenë politikë e proklamuar me zë shumë të lartë që secili është shumë i mirëseardhur të bëjë punë në lobim. Ndërkaq, Ministria e Jashtme lobon institucionalisht dhe, keni parasysh, ka një kornizë edhe buxhetore, edhe ligjore, brenda të cilës Ministria e Jashtme patjetër që duhet të sillet. Nuk mund të dalë jashtë asaj kornize buxhetore dhe, ta zëmë, të paguajë udhëtime për lobim. Pra, për cilindo qoftë anëtar të opozitës ose parti politike ose komision parlamentar të Kuvendit, të gjithë janë super të mirëseardhur, t'i bëjnë këto nga burimet vetjake, por Ministria e Punëve të Jashtme e ka kornizën ligjore, brenda të cilës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Rezymo, zoti ministër, rezymo!

SKENDER HYSENI: Krejt në fund. Unë, edhe një herë dua të falënderoj të gjithë anëtarët e Parlamentit të Kosovës për të gjitha shqetësimet që janë ngritur dhe dua t'i siguroj të gjithë ata, pa përjashtim, se Ministria e Punëve të Jashtme do të bëjë maksimumin në kuadër të mundësive që ka. Mos të harrojmë, aktualisht, Ministria e Punëve të Jashtme është duke e ndërtuar strukturën me dinamikën maksimale që e lejojnë ligjet dhe legjislativi në fuqi. Unë ju falënderoj shumë për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Sipas rregullit dhe Rregullores, 5 minuta i ka Grupi Parlamentar që e ka paraqitur interpelancën, për ta përmbyllur. Në emër të Grupit e ka fjalën Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Sinqerisht, falënderoj shumë kontributin e secilit veç e veç dhe të gjithëve bashkë që dhatë sot në ngritjen për debat në një opinion më të gjerë, meqë kemi qenë edhe drejtpërdrejt për opinionin publik për një çështje fundamentale, të një, siç u tha këtu, pjese shumë të rëndësishme të politikës së shtetit të Kosovës në ndërtim e sipër.

Dua, thashë fillimisht, t'i falënderoj veç e veç edhe ata që nuk kanë qenë në akordancë shpeshherë me atë që, në fakt, e ngriti interpelanca.

Ajo që është shumë e rëndësishme këtu, është se kjo interpelancë nuk është thirrur me qëllim ta linçojë askënd. Është pjesë e një veprimi demokratik, qysh e bën bota demokratike. Është, pastaj, pjesë e akteve tona normative parlamentare. E dyta, nuk është thirrur me qëllim që të manipulohet opinioni, por përkundrazi që të sqarohet opinioni dhe unë mendoj se qëllimi është arritur skajshmërisht fuqishëm dhe opinioni tash e ka të qartë se në politikën e jashtme të Kosovës ka defekte të ndjeshme, të cilat, prej kësaj foltore, në emër të gjithë atyre që i vërejtën këto defekte, e ftoj ministrin që të reflektojë shumë përgjegjshëm me aktin moral që ai e konsideron se është i përshtatshëm për barrën e përgjegjësisë që e ka.

Dua disa zërave që këtu u munduan ta personalizojnë, dua edhe një herë të potencoj se qëllimi i kësaj interpelance nuk ka qenë që ndokush të linçohet dhe nuk ka qenë i drejtuar personalisht ndaj askujt. Dua të distancohem nga ata zëra që deshën interpelancën ta interpretojnë si tendencë për ta personalizuar. Në fakt, personalizimet erdhën prej vetë atyre. Le t'iu jetë për nder.

Të nderuar deputetë,

Duke ndjekur nga afër punën e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe duke dëgjuar shqetësimet që sot ngritët ju të gjithë këtu, mendoj se ka vend që të evidentohen dhe të konstatohen disa mangësi evidente që ashikare u vërejtën nga kjo interpelancë.

E para, ministri nuk qe në gjendje të na thotë se ka plan paraprak, ka program me të cilin ka ardhur të qeverisë në Ministri.

Ministri, po ashtu, nuk na bëri të qartë, vetëm tregoi 3-4 raste çka ka bërë. Unë dyshoj se shifra 100 ambasadorë është pak e madhe. Ne këtë nuk e kemi parë. Atë çka kemi parë në

opinion është shumë më e vogël dhe kjo flet se, nëse ka pasur, atëherë ministrit i shtohet edhe një përgjegjësi e jotransparencës në punën e kësaj Ministrie që, unë po them, ka qenë shumë e dukshme dhe opinionin beson këtë sepse nuk kemi ditur gjë, nuk e dimë as kush janë këshilltarët, as kush janë të punësuarit, por vetëm – hynë në ueb faqe, i gjend 7-8 emra. Dhe, kjo është krejt.

Prandaj, them, nuk ka edhe strategji afatmesme të zhvillimit. Pra, sa është mandati i këtij ministri. Nuk e kemi parë këtë strategji, nuk na u tha sot këtu. E tëra çka u tha, është se Kosova i ka kaq mundësitë dhe është mbështetur te diplomacitë mike. Kjo është një e vërtetë që ne e dimë, të nderuar. Por, punën që duhet ta bëjë diplomacia kosovare s'mund ta zëvendësojë diplomacia mike. Ajo bën shumë, por ne do të flasim për vete atje kur shkojmë. Ajo na hap derën, por ata nuk flasin për ne.

Pastaj, u përmendën do doktrina, pa të keq, po them, vip të asaj fushe. Nuk është mirë me u sjell në doktrinën treizen deta se i takojnë shekullit XVII, në diplomacinë franceze ose diplomacia e real-politikës, ka doktrina moderne të diplomacisë.

(Ndërhyrje nga salla, nuk dëgjohet për transkriptim)

Shiko, i nderuar. Unë pata konsideratë, nuk të përmenda...

OK. Vazhdojmë. Pastaj dua të them edhe një diçka që është evidentuar ashiqare në këtë, se Ministria është orientuar shumë që të llojë te vendet që e kanë njohur Kosovën. Për fat të keq, është pak i nënçmuar grupi i vendeve të botës së tretë, që dikush e tha këtu me cinizëm e me injorancë. Unë mendoj se është një fuqi e madhe, të cilës, mungesën e prezencës dhe aktiviteteve të diplomacisë kosovare e ka shfrytëzuar diplomacia serbe. Ne nuk është turp të jemi në krejt samitet, qoftë edhe te dera, që t'i presim kah të dalin. Pastaj, ne kemi sugjerime të qarta nga diplomacia mike se nuk po bëjmë aktivitete të mjaftueshme lobizuese. Edhe sekretari i Konferencës Islamike, ministri e di cila ishte përgjigja e tij: se bota arabe nuk e njeh Kosovën, nuk e njeh si materie, nuk e njeh si gjeografike...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti deputet, të lutem shumë, e ke një minutë – rezymë. Po ta jap edhe një minutë, sepse të kaloi koha.

IBRAHIM GASHI: Unë po dua edhe ta rikapituloj krejt atë çka u tha këtu. Sepse, u tha në mënyrë shumë të mirë, shumë të përgjegjshme dhe shumë profesionale e kompetente. Dhe, unë, edhe njëherë i falënderoj krejt deputetët për kontributin e tyre që e dhanë. Edhe njëherë e thërras para opinionit publik ministrin Hyseni, sepse interpelanca sot konstatoi se ka vend për përgjegjësi dhe shkalla e reflektimit të tij të përgjegjshëm le të jetë ajo që ai e konsideron. Pra, le të jetë akti moral që e konsideron, sepse një pjesë e madhe e politikës së Kosovës që reflektohet përmes politikës së jashtme ka ngecje të konsiderueshme. Faleminderit, edhe për kohëzgjatjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Kjo pikë e rendit të ditës, u krye. Bëjmë pushim deri në orën 15,30.

(Vazhdimi i seancës pas pauze)

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, po vazhdojmë punën.

Në vazhdim, kemi pikën e katërt të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij Projektligji.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 18 korrik 2008.

Ftoj ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryetar,

E nderuar Kryesi,

Të nderuar deputetë dhe kolegë ministra,

Projektligji për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi të ndërtesës rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e pronarëve të njësisë të ndërtesës në lidhje me shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të përbashkëta dhe pajisjeve të ndërtesës ose bashkëpronësinë në ndërtesë.

Nevoja për këtë Projektligj ekziston, sepse në Kosovë aktualisht nuk ka mekanizma ligjor të cilët do të rregullonin bashkëpronësinë në ndërtesë dhe sidomos organe apo autoritete përgjegjëse të cilat do të merreshin me administrimin dhe mirëmbajtjen e fondit të ndërtesave. Aktualisht nuk ekziston fondi i ndërtesave ose gjendet pa u administruar. Arsyetimet për Projektligjin janë: aspekti ekonomik, arsyeja e parë për hartimin e këtij Projektligji; mungesa e mirëmbajtjes shkakton degradimin e banesës, për renovimin e të cilës nevojitet investim i konsiderueshëm. Banesa e shkatërruar dhe jo e mirëmbajtur ka vlerë të ulët dhe kjo reflektohet si në buxhetin individual të një familjeje, ashtu edhe në atë shtetëror. Aspekti tjetër është aspekti social, sepse mungesa e mirëmbajtjes e cila rezulton me shkatërrimin dhe rrënimin e banesës krijon mundësi për rritjen e numrit të rasteve sociale dhe të pastrehëve. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për administrimin dhe mirëmbajtjen e fondit të ndërtesave në mënyrë të qëndrueshme dhe teknike profesionale është nevojë jetike dhe fundamentale.

Të nderuar deputetë,

Projektligji përmban 5 kapituj.

Kapitulli i parë – dispozitat e përgjithshme;

Kapitulli i dytë – shfrytëzimi i njësisë në ndërtesë;

Kapitulli i tretë – administrimi dhe mirëmbajtja e bashkëpronësisë në ndërtesë;

Kapitulli i katërt – kundërvajtjet dhe gjobat;

Kapitulli i pestë – dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Sa u përket risive të avancimi të këtij Projektligji, Projektligji mundëson fleksibilitet. Sa i përket menaxhimit dhe administrimit të ndërtesave, pronarët me marrëveshje vendosin për mënyrën e menaxhimit ose të administrimit.

Programi i këtij projektligji bazohet në udhëzuesin për bashkëpronësi në banesa të UNC, si dhe përvojat e vendeve të rajonit dhe të Bashkimit Evropian, të sjella përmes ekspertëve të Institutit Gjerman IVIU ose Instituti për Banim dhe Urbanizëm.

Të nderuar deputetë, në fund, ju ftoj të votoni për Ligjin në parim, duke e proceduar në Parlamentin e Kosovës përmes komisioneve edhe në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit nuk e ka kërkuar fjalën. Kalojmë te radha e shefave të grupeve parlamentare. Sipas radhës, fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar ose në emër të Partisë Demokratike është lajmëruar deputeti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka lexuar dhe e ka analizuar me vëmendje Projektligjin për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi.

Ky Projektligj është më se i nevojshëm për Kosovën. Ka me mijëra ndërtesa në bashkëpronësi anekënd Kosovës të cilat, me vite të tëra nuk kanë pasur asnjë mirëmbajtje dhe përkujdesje, gjë që ka pasur për pasojë shumë keqpërdorime, ndërtime e mbindërtime pa kurrfarë leje dhe pa kurrfarë baze dhe përgjegjësie. Pikërisht për këtë, ky Projektligj është shumë i domosdoshëm.

Me këtë Projektligj rregullohen dhe precizohen qartë përgjegjësitë, obligimet dhe të drejtat e detyrimit e atyre që juridikisht gëzojnë të drejtën në bashkëpronësi ose e kanë të bartur atë të drejtë.

Ky Projektligj krijon kushtet për përgjegjshmëri dhe përkujdesje të organizuar për t'u shfrytëzuar hapësirat me ndjenjën e përgjegjësisë për përbashkësinë, rregullon ndryshimet eventuale dhe marrjen e pëlqimit detyrimisht nga drejtuesit. Administrimi krijon një organ përgjegjës i cili duhet të përkujdeset, të përcjellë dhe të kontrollojë mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi.

Me këtë Projektligj rregullohet rendi, rregulli dhe kontrolli i ndërtesës në bashkëpronësi duke mbuluar një vakum ligjor, vakum i cili ka shkaktuar një gjendje kaotike të papërgjegjësisë thuaja se totale të ndërtesave në bashkëpronësi.

Me këtë Projektligj, Qeveria e Republikës së Kosovës, konkretisht Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, ka bërë një punë serioze të përkushtuar dhe profesionale.

Duke e konsideruar nevojë të ngutshme këtë Projektligj, me të cilin eliminohet anarkia dhe gjendja kaotike e mirëmbajtjes në ndërtesat në bashkëpronësi, Grupi Parlamentar i PDK-së i jep mbështetje të plotë këtij Projektligji për shfrytëzim, administrim dhe mirëmbajtje të ndërtesës në bashkëpronësi, të shkojë në procedurë të mëtutjeshme dhe do të japë kontributin e vet në komisionet përkatëse. Ne, e votojmë pra, në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Radhën e ka Lidhja Demokratike. Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për administrimin dhe mirëmbajtjen e fondit të ndërtesave në mënyrë të qëndrueshme dhe teknike profesionale është nevojë jetike dhe fundamentale, gjë që duhet të rregullohet në bazë ligjore.

Projektligji për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi e plotëson vakumin në infrastrukturën ligjore në këtë sferë dhe mundëson që menaxhimi i ndërtesave të jetë në funksion dhe në interes të të gjithë pronarëve dhe njësive të ndërtesave në atë mënyrë që përmes definimit dhe rregullimit të raporteve bashkëpronësore të arrihet definimi i përgjegjësisë dhe krijimi i autoriteteve të cilat do të merren me mirëmbajtje dhe administrim të ndërtesave në nivel të qëndrueshëm.

Buxheti i Kosovës nuk do të ndikohet me rastin e zbatimit të këtij ligji. Sipas këtij ligji, shfrytëzimi, administrimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave në bashkëpronësi bëhet përmes fondit rezervë, financimi i të cilit sigurohet nga pagesa e pronarëve të ndërtesave në bashkëpronësi. Këto mjete do të shpenzohen sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj. Gjithashtu, vlerësohet se edhe buxhetet e komunave nuk do të ndikohen nga ky ligj.

Prandaj, duke parë nevojën për ekzistimin e një ligji të këtillë, me të cilin pra do të plotësohet infrastruktura ligjore në këtë lëmi, Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, pas shqyrtimit të këtij Projektligji, është për miratimin e këtij Projektligji në parim, ndërsa kontributin tonë do ta japim në kuadër të komisioneve përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit! Ju njoftoj se në sallë janë 63 deputetë. Sipas radhës, fjalën e ka Grupi Parlamentar i AKR-së, deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka analizuar këtë Projektligj. E dimë rëndësinë çfarë e ka miratimi i një ligji të tillë, prandaj të njëjtin e përkrahim në parim dhe vërejtjet tona, eventuale do t'i japim në formë të shkruar në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, deputete! Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Po ashtu, edhe Grupi Parlamentar i yni e mbështet hartimin e këtij Projektligji. Mendoj se gjendja aktuale çfarë mbizotëron në Kosovë është mjaft kaotike, prandaj si të tillë e mbështesim dhe vërejtjet tona eventuale do t'i japim gjatë punimeve në grupet e caktuara. Po ashtu, dua të them se edhe ligji për banim dhe ky ligj do ta plotësojnë një vakum që ka ekzistuar për një kohë të gjatë tek ne në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, deputet! Në radhë është fjala e shefit të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetit Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, e përkrah në parim miratimin e këtij Projektligji, duke konsideruar se ky projekt adreson në mënyrë shumë të qartë përgjegjësitë dhe autoritetet përkatëse, krijon obligime, ndërsa konsiderojmë se rregullimi i raporteve në bashkëpronësi në ndërtesë është me rëndësi të madhe duke pasur parasysh edhe vakumin që ekziston dhe në sistemin e ri Kosova nuk ka arritur të ndërtojë një sistem i cili do t'i evitonte këto mangësi që ekzistojnë aktualisht. Prandaj, ky Projektligj besojmë se do t'i plotësojë dhe do të japë pasqyrë shumë më të qartë për rregullimin e kësaj materie. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+” Shpresa Murati.

ZYLFI MERXHA: Zoti Kryetar i Parlamentit, pasi s’e kam kartelën, e kam marrë fjalën me anë të kartelës së Shpresës. Prandaj, unë do ta përfaqësoj Grupin “7+”. Edhe ne, të Grupit “7+”, si të gjithë deri më tani, edhe ne do të presim deri në afatin e dytë që Komisioni edhe diçka do të përmbushë në këtë drejtim, kështu që tash për tash jemi dakord që të kalojë ligji.

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputetja Kosara Nikoliq.

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

S obzirom da znamo kakva je situacija sa našim stanovima, mi kao Parlamentarna grupa smo razmatrali ovaj zakon i mi ga u načelu podržavamo, a svoje primedbe i sugestije daćemo na komisiji.

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, deputete! Radha është e deputetëve. Për fjalë është paraqitur deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Auditor i nderuar,

Ky dokument, parimisht, është i pranueshëm. Nuk ekziston thënia se në këtë fushë nuk ka pasur dispozita. Ka dispozita, por mjerisht nuk përfillen. Ky është një problem serioz në jetën tonë shoqërore e politike. Natyrisht se ka vend për t’u plotësuar dhe përmirësuar, prandaj ky dokument do të duhej përkrahur parimisht dhe parimisht do ti jap disa vërejtje të përgjithshme, kështu.

Ky dokument e ka pasur për bazë Ligjin për banim të Sllovenisë, që mendoj se është praktikë e mirë dhe duhet kultivuar kështu diçka, të merret gjithmonë një ligj i një shteti të avancuar, si bazë, e pastaj, natyrisht disa specifika. Mirëpo, ai quhet ligj për banimin dhe ky e ka një titull të stërzgatur dhe të panevojshëm dhe do të duhej rishikuar kjo çështje.

Në këtë ligj, në shumë vende përmendet gjykata dhe i adresohet gjykatës, por nuk e specifikon cilës gjykatë.

Më pastaj, apelohet në disa pika në procedurë urgjente, e tash procedura urgjente do të duhej të terminohej, të përkufizohej sepse ndryshe do të mbetej jo urgjente dhe gjithmonë do të kishte justifikim për atë që duhet të aplikonte, në mënyrë arbitrare. Domethënë “urgjente” po, por nuk ka sanksione, prandaj nuk do të ishte urgjente.

Ky dokument përmban shumë dispozita të panevojshme të inkorporuara në të. Sepse, shkoqiten fragmente të ligjit për detyrimet ose për përgjegjësinë, e tjera ku janë në këto institute juridike të rregulluara shumë mirë, ndërsa këtu fragmentarisht dhe do të dilnin probleme të interpretimit. Prandaj, kjo është praktikë e keqe, sepse në vend që të bëjmë ligje të shkurtra dhe të thukta e të qarta dhe për aq më tepër edhe të aplikueshme, i stërgrumbullojmë me dispozita të ndryshme, bëjmë një ligj të fryrë, që është e panevojshme.

Me nenin 17, sikur të miratohej, do të krijohej një bazë juridike solide për spekulime tani e tutje në bazë ligjore, çfarë janë bërë deri më sot. Do të thotë, mbindërtime, ndërndërtime, anashndërtime ilegale, që janë të dëmshme, e prishin estetikën, teknikën, stabilitetin e tjera, e tjera.

Thotë, mbi 50%. Këtu do të duhej të shkojmë në një kërkesë për konsensualitet, sepse janë çështje shumë të rëndësishme ndërrimet e strukturës banesore.

Neni 17, thotë: “kur pronarët nuk kanë mundësi për të ardhur deri te një marrëveshjeje për ta miratuar planin e administrimit, çështja do t’i adresohet gjykatës për kundërvajtje”. Ky është një nonsens. Gjykata e kundërvajtjeve i gjykon kundërvajtjet, një sharje, një fyerje dhe një prishje të rendit a të qetësisë dhe këtu nuk është fjala për një kundërvajtje apo delikte kundërvajtjeje, por nuk merren vesh dhe s’mund të arrihet marrëveshja dhe nuk është kundërvajtje. Është çështje njerëzore, janë për gjykatën civile, gjykatën komunale, e kështu.

Këto janë vërejtje parimore. Ka edhe shumë të tjera që, shpresoj, në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi do të japim një kontribut konkret dhe të dobishëm.

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, deputet! Në listë nuk kemi të lajmëruar për fjalë. Atëherë, kërkoj nga regjia dhe deputetët të bëhen gati për votim.

Në sallë janë 64 deputetë. Pa kartelë, s’do t’i njehim! Faleminderit! Këtu janë prezent 85 deputetë.

Pra, votojmë tash:

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi.

Në bazë të Rregullës 23 pika 7 dhe 35 pika 4 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues;
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa;
3. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi;
4. Komisioni për Komunitete, dhe
5. Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet, brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, duhet t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime.

Në radhë është pika e pestë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-20 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit**

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij Projektligji.

Ftoj përfaqësuesin e Ministrisë, Tregtisë dhe të Industrisë, ministër zotin Lutfi Zharku, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar Kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të jap shkurtimisht arsyet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, fushëveprimin e këtij Projektligji si dhe rolin dhe rëndësinë që ka për sistemin e gjithmbarshëm ekonomik të Kosovës.

Në cilëndo shoqëri moderne ekzistojnë shumë produkte të cilat mund të shkaktojnë lëndime apo vdekje, nëse janë të dizajnuara dhe prodhuara në mënyrë të gabuar. Prandaj, këto duhet të projektohen dhe prodhohen në mënyrë të tillë që të mos shkaktojnë lëndime dhe rreziqe për përdoruesit e tyre.

Për këtë arsye, Qeveria zhvillon legjislacionin në mënyrë që të mbrojë qytetarët e vet nga rreziku që vjen nga produktet jo të sigurta.

Këto rregullore teknike mund të jenë të ndryshme ndërmjet shteteve, shpesh për shkak të historisë së zhvillimit të veçantë të tyre, të rregullativës së tyre dhe praktikës industriale. Këto ndryshime teknike shpesh shkaktojnë barriera shumë të mëdha tregtare, të njohura si barriera teknike. Tregu i unifikuar i Bashkimit Evropian është një hapësirë e gjerë ekonomike, ku mallrat, shërbimet, kapitali dhe puna mund të qarkullojnë lirshëm, kurse siguri i një prosperiteti, siç është vendi ynë, është integrimi në këtë treg.

Në funksion të përmbushjeve të obligimeve për të asociuar në mekanizmat e BE-së dhe duke pretenduar për një qasje të mundshme në tregun unik të BE-së, industrisë kosovare i nevojitet infrastrukturë e nevojshme për të filluar procesin e përafrimit me kërkesat themelore që shtrojnë direktivat e Bashkimit Evropian.

Ligji ka bazë në direktivat e qasjes së re dhe asaj globale, si njëri ndër ligjet horizontale që rregullon produktet e fushës industriale nga i cili dalin shumë akte nënligjore, të ashtuquajtura, rregullore teknike e të cilat paraqesin njërin ndër elementet e domosdoshme për integrim në strukturat evropiane.

Industria e BE-së përfshin 27 fusha të produkteve industriale, të cilat janë të rregulluara me ligjin, në dy mënyra të ndryshme. Në këto fusha industriale përfshihen industria kimike, farmaceutike dhe ajo e tekstilit, të cilat përfshihen në qasjen globale, përderisa produktet e industrisë elektrike dhe të makinerisë janë të rregulluara me direktivën e qasjes së re. Direktiva e qasjes së re përbëhet nga dy degë të industrisë, nënkuptojnë vendosjen e obligueshme të markës CE në produkte, pas vlerësimit të konformitetit me të cilin vërtetohet se produkti i plotëson të gjitha kërkesat e një apo më shumë direktivave. E përbashkët ndërmjet qasjes së re dhe asaj globale është se ato kufizojnë ndërhyrjen publike ndaj asaj që është kërkesë themelore dhe krijojnë biznese të industrisë me mundësi më të shumta për të përmbushur detyrimet publike.

Zbatimi i këtij ligji ndikon drejtpërdrejt në zvogëlimin e dështimit të produkteve, mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë së njeriut, mbrojtjen e interesave të ligjshme të

konsumatorit përmes plotësimit të kriterëve të caktuara të produkteve, si dhe të shërbimeve që në ligj e quajmë konformitet, respektivisht përputhje e kërkesave të produkteve, të shërbimeve dhe të sistemeve me standardet dhe kërkesat tjera të specifikimeve teknike, që praktikisht mund të vlerësojmë produktet, shërbimet, pajisjet dhe sistemet e menaxhimit.

Neni 5 i Ligjit në fuqi, për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit përcakton nxjerrjen e rregullave teknike për produkte dhe grupe produktesh.

Njësia e rregullave teknike e cila funksionon në bazë të Ligjit në fuqi, gjatë hartimit dhe implementimit të rregulloreve të ndryshme teknike që dalin nga direktivat e BE-së ka hasur në vështirësi në kapitullin III të Ligjit në fuqi, sepse procedurat e vlerësimit të konformitetit janë të mangëta dhe në të nuk përfshihen të gjitha procedurat e vlerësimit të konformitetit që përmbajnë direktivat e BE-së, si për shembull, rasti kur vendosja e shenjës së konformitetit nuk mund të vendoset në produkt për shkak të natyrës së tij.

Po ashtu, në Ligjin aktual kanë munguar disa procedura për vlerësim të konformitetit, e të cilat me Projektligjin e propozuar plotësohen edhe me gjashtë sosh, siç janë: vlerësimi i konformitetit me zgjedhje sipas rastit; vlerësimi në ndërmarrje dhe mbikëqyrja e funksionimit të sistemit; vlerësimi i konformitetit me një tip të produktit të certifikuar; vlerësimi i aktiviteteve lidhur me prodhimin e produkteve; vlerësimi në fazën e projektimit, e tjera.

Në fund, duke marrë parasysh rëndësinë e konformitetit të produkteve, po ashtu kemi propozuar edhe rritjen e ndëshkimeve.

Duke pasur parasysh që një ndër kërkesat themelore për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-asocimit me BE-në është zhvillimi paralel i infrastrukturës kryesore të SCI-së, bazë e të cilës janë Zyra e rregullave teknike, së bashku me atë të standardizimit, metrologjisë dhe akreditimit, si dhe duke pasur parasysh rëndësinë që paraqet ky ligj për Republikën e Kosovës dhe legjislacionit të saj në ngritjen e infrastrukturës së cilësisë, rekomandoj që Projektligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për kërkesat teknike, për produkte dhe vlerësim të konformitetit, pas shqyrtimit, të miratohet dhe të dërgohet në procedim të mëtutjeshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, ministër! Tani është radha e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ligji ekzistues për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, pra, siç u tha, përcakton detyrimet për të vendosur në treg produktet që nuk janë të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njeriut dhe njëkohësisht nuk janë të dëmshme as për mjedisin.

Procedurat për vlerësim të konformitetit, organet që bëjnë vlerësimin e kërkesave që duhet të plotësohen janë inspektimet dhe ndëshkimet. Ligji është shumë i rëndësishëm sepse ka për qëllim që në treg të jenë produktet që nuk e dëmtojnë konsumatorin në përgjithësi dhe njëkohësisht nuk e dëmtojnë as ambientin në të cilin jetojmë.

Ndryshimet dhe plotësimet e bëra e bëjnë më të implementueshëm Ligjin ekzistues, sidomos sa i përket zbatimit të procedurave për vlerësim të konformitetit të produkteve dhe nxjerrjen e rregullave teknike.

Grupi ynë parlamentar është i mendimit se ndryshimet e bëra në nenin 5 të Projektligjit që kanë të bëjnë me nenin 8 të Ligjit, i qartësojnë procedurat e vlerësimit të konformitetit për produktet, por është i mendimit se duhet të ketë një qartësim më të madh sa u përket organeve për vlerësim të konformitetit dhe kërkesave që duhet të plotësohen.

Nga deklarata financiare, e cila i është bashkëngjitur këtij Projektligji, shihet se ka një kosto shtesë ky Projektligj për dy vitet e ardhshme, sepse parashihet shtimi i 4 zyrtarëve. Kjo kosto nuk është e përfshirë edhe në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, kështu që mbetet që Ministria ta bëjë përshtatjen e brendshme, ashtu që të merren parasysh rekomandimet që vazhdimisht po iu bëhen institucioneve tona që të mos ketë shtim të stafit civil. Prandaj, kjo kosto shtesë, në njëfarë mënyre duhet të reduktohet brenda Ministrisë pa detyrim të shtimit të numrit të punësuarve.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-20 për kërkesat teknike për produktet dhe vlerësim të konformitetit dhe përmes deputetëve që ka në komisionin funksional do të paraqet vërejtjet dhe sugjerimet dhe do japë kontributin e vet në amendimin e këtij Projektligji. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë u paraqita për fjalë kështu, por po e shfrytëzoj rastin edhe në emër të Grupit Parlamentar, pra do të flas edhe për vërejtjet që pata në Projektligj. Ne e kemi shqyrtuar sot, grupet parlamentare e kemi shqyrtuar në grup, i përkrahim në parim këto ndryshime të paraqitura nga sponzoruesi. Vetëm me vërejtjen, do me thënë edhe me politikat e Qeverisë, që bie ndesh edhe me Kornizën afatmesme të shpenzimeve, shtimin e numrit të punëtorëve, është mirë që para se të na i sjellin ligjet në Parlament, sepse është i vetmi problem që shumë herë po na paraqitet dhe ligjet po kthehen për shkak të kostos buxhetore të papërbalueshme.

Ndërsa, atë çka desha edhe unë ta them, mos ta kaloj, ka të bëjë me nenin 8. Grupet punuese duhet të kenë kujdes që pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ne nuk prekim në kompetencat e rezervuara të UNMIK-ut dhe nuk ka nevojë që ato të figurojnë në projektligjet e paraqitura.

Grupi i LDK-së e përkrah në parim në procedurat e mëtutjeshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të AKR-së, shefi i Grupit, deputeti Ibrahim Makolli. Unë në regjistër i kam dy veta, do të thotë dy deputetë dhe njëri prej tyre është shef i Grupit. Unë jam i obliguar që fjalën t'ia jap shefit të Grupit.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Do të ishte mirë që të sqarohen këto çështje.

Në emër të Grupit Parlamentar i përkrahim këto ndryshime që kanë të bëjnë me këtë ligj, të vetëdijshëm se edhe ato mangësi të cilat u cekën më lart, që i ka ky ligj, do të mund të rregullohen në komisionet të cilat do ta trajtojnë këtë çështje deri në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të AAK-së, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar ministra, zëvendësministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah këtë projektligj dhe ndryshimet, për arsye se projektligji ka kaluar në këtë Parlament, mirëpo nuk do të thotë se gjithmonë duhet t'i plotësojë të gjitha kriteret, por në praktikë shpeshherë ligjet duhet të plotësohen dhe të harmonizohen me direktivat e BE-së. Prandaj, këtu është synimi i këtij ndryshimi të këtij projektligji, për këtë arsye edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës përkrah këtë projektligj, i cili do të jetë shumë me rëndësi për produktet industriale të harmonizuara me direktivat e BE-së. Prandaj, Grupi i Aleancës do ta japë kontributin në komisionin funksional dhe në komisionet kryesore ku do të kalojë ky projektligj.

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Edhe ne si Grup Parlamentar përkrahim në parim ligjin, duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj fushe, respektivisht mbrojtjen potenciale edhe të konsumatorëve, edhe të bizneseve dhe duke marrë parasysh situatën mjaft kaotike në importin, qoftë të produkteve ushqimore, qoftë të produkteve të tjera industriale, është momenti i fundit që edhe ne në Kosovë t'i respektojmë direktivat e Unionit Evropian, respektivisht të jemi në harmoni edhe me legjislacionin, por edhe në kuptimin përmbajtësor të mundësive të tregtimit me produkte të cilat, vërtet, i plotësojnë standardet.

Kemi disa vërejtje në emërtimin e vetë ligjit, sepse konformiteti nuk përfshinë të gjitha produktet në përgjithësi, në aspektin e origjinalitetit, në aspektin e standardizimit, mirëpo meqenëse jam në këtë komision funksional, atëherë do të japim edhe kontributin tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+" fjalën e ka deputetja Mufera Şinik.

MUFERA ŞINIK: Ju faleminderit, Kryetar!

Sayın Başkan, Bakanlar ve Millet vekilleri!

Ürünlerin teknik gereçleri ve uyumun değerlendirilmesine ait Yasa Tasarısının çok büyük önem taşıdığını biliyoruz. Avrupa Birliği talimatları ve yasamasıyla uyumlaştırılmış olması ve yasanın hazırlık döneminde Kosovadaki ihtiyaçların ve şartların gözönünde bulundurulmuş olması, aynı zamanda Anayasa çerçevesiyle öngörülen gerekli uluslararası enstrümanlarında dikkate alınmasıyla bu Yasa daha büyük ağırlık taşımaktadır. Kosova Hükümeti tarafından geçenlerde sözkonusu Yasa Tasarısını görüşecek ve tamamlayacak olan bir çalışma grubu oluşturulmuştur, ancak bu çalışma

grubunun içerisinde topluluklardan hiçbir temsilcinin bulunmaması dikkat çekmektedir. Bunu vurguladıktan sonra, 7+ Parlamenter Grubu olarak bu Yasa Tasarısını prensipte kabul ediyoruz, konuyla ilgili öneri ve uyarılarımızı Meclisin İşlevsel Komisyonuna sunduğumuzda dikkate alınmasını rica ediyoruz.
Teşekkür ederim. Faliminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të SLS-së. Këtu është deputetja Kosara Nikoliq.

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!
Mi kao Parlamentarna grupa SLS, u načelu podržavamo ovaj Zakon, ali svoje primede i sugestije daćemo u radu na komisijama.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Radha është e deputetëve. Fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti Kryetar!
Ky është një dokument tepër i rëndësishëm dhe tepër i nevojshëm si për ekonominë e tregut në Kosovë, ashtu edhe për konsumatorin në Kosovë, i cili është i atakuar në çdo aspekt nga të gjitha anët. Nga veriu e jugu, lindja e perëndimi, horizontalisht e vertikalisht, domethënë është krejtësisht i pambrojtur edhe produktet tona nuk janë autoritative, sepse nuk përkojnë me standardet elementare dhe, si të tilla, nuk kanë kualifikim për eksport, po e zëmë.

Unë do të isha angazhuar, parimisht, ju lutem, që ministrit t'i jepen prerregullativa ligjore gjatë amendimeve, që të ketë autorizime, të ketë ingerenca më të gjëra se zakonisht për të miratuar akte juridike të përgjithshme nënligjore, në konformitet me standardet teknike ndërkombëtare, se ato osilojnë e ligji vështirë ndryshohet e plotësohet. Kjo është e para, kurse e dyta, ky dokument duhet të precizohet dhe të pajiset edhe me autoritetet publike, të cilat do të ishin të thirrura për ndërmarrje për caktimin e kriterëve të objektivizuara edhe për sanksionet në rastet kur nuk përfillen dispozitat, që mungojnë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!
Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, Kryetar!
Veç desha të rikujtoj se çdo herë, pas leximit të Projektligjit, fjala i jepet kryetarit të Komisionit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit edhe për këtë!
Radha është e deputetes Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Ligji për të cilin po flasim sot, është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2005 dhe është nënshkruar nga PSSP-ja në vitin 2006. Do të thotë, gjatë këtyre dy viteve, si duket, Ministria ka ardhur në përfundim se rregullat dhe procedurat e caktuara në ligj nuk janë të mjaftueshme që ligji ta arrijë qëllimin e vet. Prandaj, kërkesa për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji ka të bëjë me zgjerimin e këtyre procedurave për vlerësimin e konformitetit.

Vështirësitë në zbatimin e këtyre procedurave nuk kanë qenë të mjaftueshme, prandaj paraqiten nevoja për rregulla tjera, por edhe për një organ mbikëqyrës, i cili do të bëjë mbikëqyrjen e vlerësimit të konformitetit.

Por, nga ana ime mendoj se një element shumë i rëndësishëm për arritjen tani të këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit, ka të bëjë pikërisht me implikimet buxhetore. Janë paraparë ndikimet buxhetore shtesë për dy vjetët 2009 dhe 2010, të cilat janë në vlerën prej 27.724 euro. Meqenëse sipas Kornizës afatmesme të shpenzimeve nuk janë paraparë shpenzimet e tilla, unë nuk shoh se Ministria ka ofruar mundësinë se është një gjendje t'i absorbojë këto brenda buxhetit të vet.

Prandaj, në qoftë se Ministria nuk mund të dëshmojë se do të jetë në gjendje të ofrojë mbulimin financiar të nevojshëm për zbatimin e këtij ligji, atëherë do të ndodhemi në një pozitë që Qeveria e Kosovës, duhet pastaj përmes aprovimit buxhetor t'i parasheh këto.

Prandaj, zoti ministër, a është në gjendje Ministria t'i absorbojë brenda Ministrisë shpenzimet buxhetore shtesë, ashtu siç janë paraparë për zbatimin e këtij ligji?

Në parim e mbështes. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Asnjë deputet nuk është paraqitur për fjalë. Vazhdojmë me procedurën tjetër. Kërkoj deklarimin e deputetëve me anë të votimit. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se më 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, nr. 02/L-20 për kërkesat teknike për produktet dhe vlerësimin e konformitetit.
Ju njoftoj se në sallë janë 68 deputetë.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, si komision funksional dhe raportues;
2. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
3. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
4. Komisionin për Komunitete dhe
5. Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet, brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, duhet që Kuvendit t'ia paraqesin Raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij projektligji.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 28 korrik 2008.
Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.
Ftoj pra zëvendësministrin, zotin Ramë Manaj.

RAMË MANAJ: I nderuar Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,
Kompletimi i infrastrukturës legjislativë është një nevojë, padyshim imediate edhe në kontekstin e përmbushjes së detyrimeve kushtetuese nga plani i rregullimit të materies juridike, nga aspekti i të drejtave dhe detyrimeve të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe të familjes së tij gjatë dhe pas mandatit të tij.

Projektligji në fjalë paraqet angazhimin direkt të Qeverisë dhe të Presidencës për plotësimin e këtij detyrimi institucional.

Ky projektligj është shqyrtuar dhe miratuar nga Qeveria mbi bazën e një përgatitje dhe të një trajtimi profesional preliminar ose paraprak nga grupi punues qeveritar, në koordinim me Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Projektligji është pjesë e legjislacionit të ri dhe nuk ekziston ndonjë akt tjetër ligjor në fuqi, natyrisht, përveç dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që rregullon këtë materie në Kosovë.

Ky projektligj ka për qëllim përcaktimin e bazës ligjore për të drejtat e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe të familjes së tij, gjatë dhe pas përfundimit të mandatit.

Kapitulli i parë i ri i rregullon dispozitat e përgjithshme, ndërsa kapitulli i dytë rregullon të drejtat e Presidentit të Republikës së Kosovës pas përfundimit të mandatit, të drejtat e familjes së tij dhe pjesa tjetër ka të bëjë me të drejtat e familjes së Presidentit të Republikës së Kosovës, në rast të vdekjes së Presidentit gjatë ushtrimit të mandatit.

Gjithashtu, me këtë projektligj rregullohet edhe teksti i betimit të Presidentit të Republikës së Kosovës. Ky projektligj ka gjithsej 30 nene.

Unë, dëshiroj t'ju informoj se me përmbajtjen e këtij ligji është synuar të rregullohet materia që është prezantuar dhe kjo drejtpërdrejt, po përsëris, reflekton qëndrimin, vlerësimet dhe pajtimin e Qeverisë së Kosovës bashkë me trupën koordinuese që ka punuar në hartimin e tij nga Presidenti, respektivisht Presidenca dhe në këtë rast, ju ftoj që ta aprovonë në parim, në mënyrë që me aprovimin dhe hyrjen e tij në fuqi pas procedimit të mëtejshëm, të krijohet edhe kornizë përkatëse ligjore e kësaj fushe dhe faktikisht të mbulohet kjo mungesë.

Ju faleminderit! Shpresoj se do ta ketë përkrahjen tuaj për ta proceduar më tutje.

KRYETARI: Ju faleminderit, zëvendëskryeministër!
Sipas radhës, po e respektoj vërejtjen, po e konsideroj të mirë, fjalën do duhej ta kishte kryetari i komisionit funksional. Unë nuk e di cili është. Bahri, a e ke kërkuar fjalën në emër të Grupit Parlamentar, apo në emër të Komisionit?
Urdhëro!
Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, në emër të Partisë Demokratike.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Përshëndetje zëvendëskryeministër, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Që në fillim thashë se do të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Projektligji për Presidentin është një projektligj që është proceduar nga Qeveria, konform Rregullës 33.3 dhe kjo nënkupton që me rastin e procedimit në Kuvend iu kanë përmbajtur rregullave të shkruara dhe është proceduar me tri shkresat e domosdoshme. Domethënë, e ka shkresën shpjeguese, e ka deklaratën financiare dhe, gjithashtu, e ka deklaratën që është konform standardeve evropiane apo është në përputhje me *acquis communautaire*.

Projektligji ka një rëndësi të veçantë, duke marrë parasysh se e rregullon në thelb dhe në përmbajtje çështjen e të drejtave, të obligimeve, të përgjegjësiave dhe të detyrimeve që dalin për Presidentin aktual dhe për presidentët të cilët do të emërohen në mandatet e ardhshme apo do t'i lënë këto mandate.

Me rastin e hartimit të Projektligjit, natyrisht, është përcjellë edhe nomenklatura legjislative dhe gjuha juridike, mirëpo Komisioni i cili ka punuar në këtë projektligj, në dispozitat në fillim nuk e ka paraparë qëllimin e ligjit, nuk i ka paraparë përkufizimet dhe gjithsesi nuk e ka paraparë edhe fushën e zbatimit. Mirëpo, shpresojmë që në komisionin funksional këto do të përmirësohen dhe, nëse ka mundësi, do t'i vendosim edhe përkufizimet. Kurse, në pjesën konkrete mendoj që projektligji në nenin 11.1 ka paraparë edhe pagën e Kryetarit të Kosovës, që është në rregull. E ka paraparë që të jetë paga më e lartë në vend, mirëpo neni 11.2, mendoj që duhet të ndryshohet, sepse atje shkruan që paga e Presidentit të vendit duhet të jetë 25% më e madhe se të ardhurat e përgjithshme të pagës së Kryetarit të Kuvendit apo ndonjë institucioni tjetër mbikëqyrës. Konsideroj se kjo çështje nuk duhet të rregullohet me këtë ligj, sepse Qeveria e Kosovës duhet që sa më parë të fillojë hartimin për rregullimin e pagave për funksionarët e lartë dhe kjo çështje duhet të rregullohet me atë ligj, i cili nuk do të rregullojë vetëm pagën e Presidentit, por do t'i rregullojë pagat e të gjithë funksionarëve të lartë publikë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe, natyrisht, edhe Komisioni për Legjislacion e përkrahin në parim që të aprovohet projektligji në fjalë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Një sqarim për kryetarët e komisioneve. Kryetarët e komisioneve kanë të drejtë ta marrin fjalën e tyre para shefave të grupeve parlamentare, atëherë kur kanë mbajtur mbledhje dhe flasin në emër të Komisionit përkatës. Si deputetë, e marrin fjalën pas shefave të grupeve parlamentare.

Tani është radha e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit shumë, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet Projektligjin për Presidentin. Arsyshmërinë e dha edhe kryetari i Komisionit, në këtë rast nga Grupi Parlamentar i PDK-së. Besojmë që në

komisione do ta japim kontributin tonë, në mënyrë që ligji të vijë sa më shpejt në lexim të dytë dhe të miratohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka shefi i Grupit, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Më lejoni që, fillimisht, ta përgëzoj grupin punues për këtë draftligj, sepse është nisur nga pozicioni që është, tashmë gjendja në Presidencën e Kosovës, duke ngrirë dhe shkrirë funksione, prandaj edhe ky ligj brenda vetvetes paska ngrirje të funksioneve, që është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës.

Si Grup Parlamentar, natyrisht, të vetëdijshëm për nevojën që ka Kosova të ketë një ligj të tillë, e përkrahim në parim dhe besojmë që vërejtjet të cilat do të paraqiten edhe nga deputetët, por edhe nga grupet parlamentare, do të merren parasysh nga ana e komisioneve të tjera. Në veçanti e kam fjalën për nenin 7.3, i cili është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës, por edhe në nenet tjera, të cilat Presidentit i japin kompetenca më shumë sesa që parasheh Kushtetuta e Republikës dhe kjo do të ishte në pajtim atëherë kur Kosova Presidentin do ta zgjidhte drejtpërdrejt dhe jo me votë të Parlamentit të vendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit të AAK-së, deputetja Donika Kada.

DONIKA KADA: Ju faleminderit, Kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në parim e mbështet ligjin, ndërkaq kontributin tonë të mëtutjeshëm në përpunimin e këtij ligji do ta japim në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së e ka analizuar këtë ligj. Ne, në parim do ta përkrahim, por kemi disa vërejtje konkrete dhe mendojmë që pa sqarimin e këtyre çështjeve, ky ligj nuk duhet të kalojë në Kuvend.

Vërejtje kemi, konkretisht, te neni 4, sepse nuk është definuar qartë mënyra e zgjedhjes së Presidentit, në sa vota, në sa rrathë e tjera. Te neni 7 pika 3, po ashtu, kemi një vërejtje shumë serioze ku thuhet se gjatë ushtrimit të detyrës si President i Republikës së Kosovës, Presidenti mund t'i delegojë detyrat e funksioneve të tij paraprake. Çka nënkupton kjo, duhet të sqarohet? A është fjala për detyrat e tij partiake? Nëse është fjala për këtë, atëherë ky nen është në kundërshtim me Kushtetutën dhe nuk mund t'i rregullojë çështjet e brendshme partiake nëpër parti të ndryshme.

Pra, duhet të sqarohet fjala për këtë apo për diçka tjetër. Unë mendoj se ka të bëjë, pikërisht, me pozitën aktuale të Presidentit të Kosovës edhe duhet ky nen të hiqet edhe të mos figurojë fare këtu.

Po ashtu, kemi vërejtje edhe te neni 18, ku parashihen të drejtat e Presidentit ose të familjes së tij pas largimit nga mandati. Mendoj se duhet të sqarohet edhe pozita

Presidentit të parë të Kosovës, pozita e presidentit Rugova. Të shihet se a vlen ky ligj edhe për të edhe për familjen e tij apo duhet të nxirret një ligj i veçantë për të. Pra, edhe kjo çështje duhet të definohet. Mendoj se me këto vërejtje mund ta përkrahim, në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë më tutje. Në emër të Grupit Parlamentar "7+," e ka kërkuar fjalën Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala, gospodine predsedniče!

Parlamentarna Grupa "7+" je takodje razmatrala ovaj Nacrt zakona i smatra da ovaj nacrt zakona ispunjava uslove za jedan zakon ovakve prirode i u načelu ga podržava, a naše eventualne primedbe podnećemo u funkcionalnoj komisiji. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, fjalën e ka kërkuar deputetja Kosara Nikolliq.

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

U ime Parlamentarne grupe SLS, u načelu podržavamo razmatranje ovakvog zakona i mislimo da je vreme da udje u skupštinsku proceduru.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Vazhdojmë, radha tani është e deputetëve. Tash deputetët flasin në emër të tyre personal. Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit!

I nderuari Kryetar i Kuvendit,

I nderuari zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në parim edhe unë e përkrah ligjin. I kam dy vërejtje.

Në nenin 5, ku është mandati dhe betimi, nën pikën 1 është: "Betohe se tërë fuqinë time do t'ia kushtoj ruajtjes së pavarësisë dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës në tërësinë territoriale të saj". Mendoj se është një ngatërrim i panevojshëm. Nuk duhet ndarë, të jetë ndaras pavarësia, sovraniteti dhe integriteti territorial dhe duhet të jetë fjalja e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë, në të cilën duhet të thuhet se: "Betohe se tërë fuqinë time do t'ia kushtoj ruajtjes së pavarësisë, të sovranitetit dhe të integritetit territorial të Republikës së Kosovës". Thjesht, jo ashtu të ngatërrohet në atë formë shumë të paqartë.

Në nenin 7, te papajtueshmëria, këtu i bashkohen mendimit të dy deputetëve të mëhershëm, është i panevojshëm neni, pika 3 e këtij neni. Mendoj se kjo thjesht vetëm duhet të shlyhet, sepse kompetencat nuk mund të delegohen. Është në kundërshtim me kapitullin 5, nenin 88, pikën 2 të Kushtetutës të Kosovës, ku thuhet: "pa kurrfarë mundësie të interpretimit se Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në partitë politike". Edhe kjo sikur në rastet e tjera, ju e dini kur thuhet kështu, atëherë ai, shprehimisht, jep dorëheqje. Pastaj, është çështje e partisë të caktuar se a dëshiron t'ia ruajë vendin Presidentit apo jo, por kjo duhet të shihet se a e lejon Ligji për organizimin e partive politike. Pra, duhet të shihet edhe vullneti i secilës parti veç e veç.

Këtu, më tepër nënkuptohet për Presidentin aktual se po ndreqet ligji, ndërkaq ligji nuk e thotë shprehimisht se gjithmonë duhet prej Lidhjes Demokratike të jetë Presidenti, mund të ndodhë që të jetë edhe ndryshe.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në radhë është deputetja Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Ju faleminderit!

Përsëritet zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Në parim e përkrahu ligjin. Mendoj se ligji do të duhej të plotësohej edhe me disa specifika të tjera. Për shembull, në nenin 3, te kualifikimet për zgjedhjen e Presidentit, përmendet që Presidenti duhet të jetë i moshës 35 vjeçare dhe të ketë vendbanim në Kosovë, së paku dhjetë vjet.

Mendoj se kësaj pike do të duhej t'i shtohet që Presidenti duhet të jetë i lindur në Kosovë dhe të ketë vendbanim në Kosovë për dhjetë vjet, si dhe mosha 35 vjeçare, që është në rregull.

Neve na është bërë praktikë të mësojmë nga demokracitë e zhvilluara dhe kur merret parasysh Kushtetuta amerikane. Për shembull, ajo në nenin 2, në pikën 1 e përmend që kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet, të jenë së paku të moshës 30 vjeçare dhe të jenë të lindur në Amerikë dhe të kenë jetuar në Amerikë për 14 vjet. Prandaj, në qoftë se nisemi nga këto praktika, mendoj se edhe kjo gjë do të ishte shumë e levërdishme edhe për ligjin në fjalë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit,

Radhën e ka deputetja Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Lidhur me Projektligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës desha të jap disa mendime. E para, ka të bëjë me mënyrën e zgjedhjes së Presidentit. Në Kosovë, pas luftës, Presidenti zakonisht është zgjedhur edhe tash me këtë projektligj, përmes Parlamentit dhe unë mendoj se kjo praktikë duhet të ndryshojë dhe të krijojmë mekanizmin që Presidenti të dalë nga zgjedhjet e drejtpërdrejta të qytetarëve.

Arsyeja e parë është, sepse Presidenti është garantues i unitetit të popullit dhe mendoj se legjitimiteti më i qëndrueshëm arrihet përmes votës së drejtpërdrejtë.

E dyta, ne kemi krijuar mënyrën e zgjedhjes së kryetarëve të komunave me votën e drejtpërdrejtë edhe mendoj se është një nonsens, pra një pozicion absurd që Presidenti i shtetit shkon ende me mënyrë parlamentare, veçmas kur kihet parasysh se presidentët e Kosovës, pas luftës kanë pasur probleme në zgjedhje, vazhdimisht me disa vështirësi i kanë marrë ato vota, duke përfshirë edhe këtë të fundit. E kam parasysh Kushtetutën, e cila thotë dhe e mbështet këtë mënyrë, mirëpo për Kushtetutën nuk na është dhënë mundësia për të diskutuar për këtë. Edhe unë besoj se ju zoti Kryetar do të angazhoheni që kjo kushtetutë në disa aspekte të bëhet subjekt i rishqyrtimit dhe veçmas në këtë pikë, meqë po diskutojmë tani, sepse nuk është e mundur, i kuptojmë rrethanat e votimit të Kushtetutës, po tash mund të krijohen mundësitë që disa gjëra të korrigjohen në interes të Kosovës dhe në interes të funksionimit sa më të mirë të institucioneve të Kosovës.

E treta, kemi një fenomen me kryetarët e Kosovës që, kur po i marrin postet, sikur nuk e kanë mjaft, s'po japin dorëheqje prej funksioneve të tjera. A ka mundësi që ky ligj të reflektojë qartë që në momentin që bëhet Kryetar i vendit personi i caktuar, pra është edhe e moralshme, po tash t'ia vejmë edhe me ligj, që atë ditë duhet kryer me funksione të tjera, sepse nuk e ndihmon as funksionimin e mirë, as legjitimitetin e tij, por edhe të institucioneve të Kosovës.

E katërta, mendoj që, nuk po i theksoj këtu nenet, i kam para sysh. Neni 4 ishte i pari këtu, ky është neni 7. Pastaj kur është fjala të shkarkimi, mendoj se duhet të precizohet nëse një president i vendit vjen puna të shkarkohet, atëherë duhet të precizohet qartë çfarë janë efektet pas saj. Domethënë, a i gëzon ato privilegje pas atij statusi, apo i humb në momentin e shkarkimit?

Tjetër çështje që desha të diskutoj është fjala për statusin diplomatik të fëmijëve. Mendoj se zonjës së parë i takon statusi diplomatik, por te rasti i fëmijëve nuk e di si janë ligjet e tjera, por ka raste kur fëmijët, pra, mund të jenë shkelës. Nuk e di si thotë ligji, shkelës të situatave të caktuara dhe çështja e garantimit të statusit diplomatik apo e pasaportave diplomatike. Mendoj se duhet të precizohet kjo me disa nënne, pra që nuk ia bëjnë statusin e përhershëm, por në rast të shkeljeve të ndryshme, ai status humbet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Unë mendoj që ne nuk mund ta ndryshojmë me ligj Kushtetutën dhe Kushtetuta përcakton shumëçka që thuhet. Me qenë se unë nuk jam, do të thotë jam krejt kundër asaj që e tha Edita, unë mendoj që edhe me Kushtetutë, edhe me ligj, Presidenti ka më shumë kompetenca se sa do t'i kishte një republikë parlamentare. Fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu:

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në parim e përkrah këtë projektligj. Mirëpo fillimisht dëshiroj të theksoj se në këtë projektligj shumë më tepër iu kushtohet rëndësi privilegjeve në krahasim me kompetencat e Presidentit.

Vërejtjet dhe propozimet e mia janë, si në vijim:

Neni 6, ceket neni i Kushtetutës, por nuk përmenden kompetencat e Presidentit. Mendoj se duhet të shkruhen të gjitha kompetencat e Presidentit sipas nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Neni 8, respektivisht paragrafi 8.4, thuhet: “Imuniteti i Presidentit, sipas këtij neni vazhdon edhe pasi Presidenti të ketë përfunduar mandatin e tij”. Mendoj se pas fjalës “vazhdon” duhet të precizohet koha deri kur.

Neni 19, respektivisht paragrafi 19.2, thotë: “Presidenti i Republikës së Kosovës dhe familja e tij, pas përfundimit të mandatit, në pajtim me nenin 18.1 nga ky ligj, kanë të drejtë në siguri të plotë shëndetësor dhe shërbime mjekësore në spitalet ushtarake gjatë tërë jetës. Mendoj se duhet të jetë: “gjatë kohës derisa të zgjatë pagesa e pensionit edhe atë vetëm në spitalet ushtarake”

Neni 19. Tek neni 19 propozoj të shtohet edhe një aline, ashtu që të sqarohet që tranzicioni në jetën private nënkupton vetëm atëherë kur ish- Presidenti nuk është i sistemuar në vend të punës ku realizon të ardhura.

Gjithashtu, është e paqartë dhe mendoj se në rastin konkret ka kolizion në mes të paragrafit 19.3 dhe neni 20. Paragrafi 19.3 thotë: ” Ka të drejtë në kompensim monetar, kalimtar për një periudhë 7 mujore të tranzicionit në jetën private”, derisa neni 20 thotë: ”pas angazhimit 5 vjet”.

Neni 22, paragrafi 22.2:” Presidenti i Kosovës, të cilit i ka përfunduar mandati, në pajtim me nenin 18.1, me këtë ligj merr pjesë në solemnitetet e tjera”- vazhdon fjalja. Në vend të fjalës “merr” duhet të jetë fjala “mund të marrë pjesë në solemnitete”

Paragrafi 22.3: ” Presidenti i Republikës së Kosovës, të cilit i ka përfunduar mandati, në pajtim me nenin 18.1 të këtij ligji, vazhdon ta përdorë pasaportën diplomatike të Republikës së Kosovës”. Pas fjalës “vazhdon” duhet të precizohet koha deri kur. Po kështu, thotë “edhe familja e tij”, duhet të ndryshojë dhe të jetë, po kështu, “edhe bashkëshortja e tij”.

Neni 25, paragrafi 25.1 duhet të vazhdohet me një fjali “pas aprovimit paraprak nga Qeveria e Republikës së Kosovës.”

Nenin 27, paragrafi 27.4- është e paqartë se çka nënkuptohet me “vdekje të panatyrshme.” Duhet të precizohet “vdekja e panatyrshme”. Pastaj thotë: “ka të drejtë në kompensim në të holla për një përdorim”. Gjithashtu, edhe kjo fjalë ”për një përdorim” të konkretizohet çka nënkupton.

Paragrafi 27.5, thotë: ”Në rast të vdekjes së Presidentit të Republikës së Kosovës, gjatë ushtrimit të mandatit, familja e Presidentit mund të përdorë edhe disa të drejta të tjera për të cilat merr vendim Qeveria”. Duhet të definohej cilat të drejta? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar ministra ,
Deputetë të respektuar,

Vërejtje parimore kështu, si të them, ndoshta edhe fundamentale në këtë dokument, sipas vlerësimit tim do të ishte kjo: Me ligj, me këtë dokument duhet të përcaktohet statusi juridik i Presidentit të Republikës së Kosovës. Me Kushtetutë është përcaktuar statusi kushtetutar dhe me këtë ligj, domethënë, ky projekt do të bëhet ligj, do të thotë, nuk mund të përcaktohet statusi kushtetutar, sepse do të ishte një kontradikcio in adiekcio, i paparë, i paprecedencë që çdokush do ta vlerësonte tepër keq, sepse është edhe e pamundur, apo jo? Edhe në konformitet me këtë, do të duhej që përafërsisht gjysma e dispozitave të këtij dokumenti të dëlireshin, sepse ato janë kushtetutare. Pra, me Kushtetutë janë të normuara, të sanksionuara edhe nuk do të duhej të përsëriteshin edhe këtu. Pastaj, çdo akt ligjor, medoemos duhet të jetë në koherencë edhe në konsistencë me realitetin. Këtu thuhet: “spitali ushtarak”. Kosova nuk ka spital, Prishtina nuk ka spital. Ju lutem, spital civil a ushtarak, nuk kemi. Prandaj, do të ishte e mjaftueshme të thuhet” në spital” dhe, natyrisht, Presidentin do ta kishin trajtuar në nivelin më të lartë të kujdesit.

Ju lutem, zoti Kryetar, ka terma që janë të ngatërruara, herë “emërohet”, herë “caktohet”. Pra, për emërimin aplikohet procedurë tjetër, kurse për caktimin procedurë tjetër dhe ka efekte juridike të ndryshme. Kjo duhet të definohet qartë.

Nuk po i tregoj dispozitat, gati gjysma, dikush do të kishte thënë 70%, nuk mund të them 70% apo 80% se s’kam të dhëna statistikore, por një pjesë e madhe e dispozitave të këtij dokumenti janë shkoqitur nga Kushtetuta dhe ato duhet të kthehen pas, si imuniteti, më pastaj pasaporta. E kemi miratuar Ligjin për dokumente të udhëtimit, prandaj nuk duhet të merren ato dispozita dhe të inkorporohen këtu sepse janë të painkorporueshme.

Neni 15, paragrafi 2, thotë: “Sekretari duhet të ketë kualifikim të duhur”. Cili është ai kualifikim i duhur? Këtu jep bazë juridike për arbitrarizëm edhe për abuzim, do të thotë, cilido kualifikim, nëse konvenon personi i caktuar, domethënë e ka kualifikimin e duhur. Nuk është korrekte.

Ndërmjet teksteve në shqip, në boshnjakisht-serbisht dhe në anglisht ka diskrepanca. Për shembull, neni 21: “I përfundon mandati” ose terma që nuk përdoren në kushtetuta. Bie fjala, thotë: after the end of this, domethënë termination përdoret në Kushtetutë. Po e zëmë konkretisht, kolegja e përmendi atë amerikane. Ndërsa në boshnjakisht – serbisht, thotë: “Predsjednik Kosova kome je mandat završen”. Nuk shkon kjo. Duhet të jetë ose “okončan” ose “istekao”. Domethënë, bëj apel që këta që i përkthejnë, t’i përkthejnë mirë, se ndryshe dalin tekstet qesharake. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Për fjalë është lajmëruar anëtari i Kryesisë dhe deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Është mirë që po krijohet një ligji për funksionin e Presidentit. Presidenti, thashë me qëllim si funksion, në mënyrë që mos të identifikohet se edhe në diskutimet e deritashme patën ngjyrim. Ne deri më tash i kemi pasur 2 presidentë dhe nuk është mirë që nenet e këtij ligji të lidhen me asnjërin, me këta ose të ardhshmit. Është shumë gabim nëse krijojmë ligje duke pasur parasysh persona dhe ky është gabim i madh për çfarëdo ligji, por edhe në interpretimin e këtij ligji. Prapë, mendoj që ky ligj e ka një koherencë të përgjithshme dhe është mirë që të lexohet në mënyrë koherente se po më duket që edhe kolegët e mi po lexojnë në mënyrë selektive në bazë të asaj që ekzistojnë në ligj edhe problemet që këta s’i kanë parë, disa prej tyre.

Për të konkluduar atë që kisha të them unë, thashë që koha është delikate dhe unë e shoh një delikatesë të sojit pak të rrezikshëm që të gjykohen elementet e një ligji sipas situatave dhe akceptimeve që kemi për njerëz dhe funksione. Duke kërkuar që çdo ligj të ketë koherencën e vet dhe duke pasur parasysh edhe këto situata, unë i po jap të ashtuquajturat vërejtjet e mia parimore, duke i lexuar në sistem nenin 5, nenin 6 edhe nenin 7.

Në nenin 5, thuhet: “Presidenti betohet” ose bën be, kjo është e njëjta gjë, njësoj është ajo, domethënë, që do ta mbrojë Kushtetutën.

Në nenin 6 thuhet: “Presidenti i ushtron detyrat që i janë akorduar me Kushtetutë”. Nëse është kështu, domethënë, nëse në nenin 5 betohet që do ta mbrojë Kushtetutën, nëse në nenin 6 “i ushtron detyrat që i jep Kushtetuta, vetë ky president s’ka shans ta nënshkruajë një ligj me nenin 7, sepse neni 7 nuk është kushtetues.

Unë e kreu bisedën. Unë mendoj që në lexim të dytë sistematikisht do të shihen këto probleme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë!
I fundit për diskutim është lajmëruar Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Unë heq dorë nga diskutimi.

KRYETARI: Edhe ty faleminderit, dy herë!

Kalojmë në procedurën e votimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se më 51 vota “për”, asnjë “kundër” e 4 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës. Në sallë janë 67 deputetë.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues,
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa,
3. Komisioni për Komunitete dhe
4. Komisioni për Integrime Evropiane.

Komisionet, brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, duhet që Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime. Ju faleminderit!

Vazhdojmë pikën e shtatë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërmjetësim

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 17 prill 2008. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i kanë parashtruar rekomandimet e tyre.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Ligjit nuk kanë implikime buxhetore.

Komisioni për Komunitete ka vlerësuar se Ligji nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Integrime Evropiane ka vlerësuar se dispozitat e Ligjit nuk bien ndesh me parimet bazë të *acquis communautaire*.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si Komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për ndërmjetësim dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Procedojmë me votimin dhe miratimin e amendamenteve sipas radhitjes së paraqitur në raport.

Amendamenti 1

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se më 58 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Fjalën e ka ministria Nekibe Kelmendi për amendamentin 3. A ta kryejmë njëherë amendamentin 2, mandej amendamentin 3, kur të vijë me radhë.

Amendamenti 2

Lus deputetët dhe regjinë le të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 50 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti nr. 2.

Tani e ka fjalën zonja ministre, Nekibe Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Mendoj se amendamenti 3 është pa objekt, sepse në nenin 6.1 nuk ekziston fare në reshtin e 4 parafjala “që”, e cila propozohet të hiqet. Prandaj, kisha sugjeruar Komisionit që ta tërheqë këtë amendament.

Fjalën duhet ta ketë kryetari i Komisionit Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Unë desha që në fillim ta bëjë një sqarim, mirëpo nuk m'u dha fjala, sepse u ngutëm, menjëherë kaluam në amendamente. Këtu po shihet që me rastin e shkrimit teknik që është bërë, është harruar fjala “që” kur ka kaluar në kompjuter kjo pjesë teknike, sepse është përdorë fjala “që” përpara fjalës “një” të përdoren, “që të përdoren” dhe ne kemi konsideruar që fjala “që” është e panevojshme. Kjo është çështja dhe mund ta heqim, nuk ka asnjë problem.

Mirëpo, tani po shihet që në projektligj ekziston fjala “që”, mirëpo këtu kur e kanë kaluar tash në këtë dokument, nuk e ka zënë kompjuteri apo është një gabim. Unë desha në fillim ta qartësoj, nuk është ndonjë dallim që prek esencën apo përmbajtjen e Projektligjit, andaj mund ta heqim.

KRYETARI: Atëherë, shkojmë me 4-shin. Është çështja e redaktuarës dhe po e konsiderojmë të tillë. Këtu duhet t'i ndryshojmë edhe numrat e amendamenteve. Tash amendamenti 4 bëhet 3.

Amendamenti 3

Atëherë lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

Konstatohet se me 52 vota “për”, 1 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se më 55 vota “për”, 2 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 6 dhe i fundit.

Votojmë ligjin në tërësi.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndërmjetësim.

Pika e tetë është hequr, edhe pika e nëntë, gjithashtu.

Kalojmë në pikën e dhjetë.

- Shqyrtimii i propozimvendimit për formimin e Komisionit Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Në bazë të Rregullores nr. 2008/12 për Shërbimin Civil, Kuvendi formon Komisionin Parlamentar ad-hoc për shqyrtimin e kandidaturave për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Komisioni ad-hoc përbëhet prej 9 anëtarëve, të cilët propozohen nga partitë ose koalicioni në bazë të ulëseve të fituara në zgjedhjet për Kuvend, ngjashëm me përfaqësimin e tyre në Kryesinë e Kuvendit.

Në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 9 shtator 2008, është kërkuar nga kryetarët e grupeve parlamentare që deri në seancën e sotme t’i prezantojnë emrat e deputetëve për anëtarë të Komisionit ad – hoc.

Me përjashtim të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe atij të LDK-së, të tjerët nuk i kanë propozuar anëtarët e këtij komisioni, andaj kërkoj që propozimet t’i bëjnë sipas radhës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka propozuar 2 anëtarë, Hydajet Hysenin dhe Ramadan Gashin.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka propozuar 2 anëtarë, Melihate Tërmkollin dhe Ismet Beqirin.

Në radhë është Grupi Parlamentar i AKR-së. E keni një kandidat. Pra, sot duhet ta bëni propozimin. Rita Hajzeraj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Për formimin e Komisionit ad-hoc për shqyrtimin e kandidaturave për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës ne kemi propozuar zotin Ibrahim Makolli.

KRYETARI: Faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, fjalën e ka shefi i Grupit, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, Kryetar!

Grupi Parlamentar i LDD-së propozon deputetin Adem Salihaj për anëtar, në kuadër të Komisionit ad- hoc. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kush e do fjalën ? Ibrahim Selmanaj e ka kërkuar fjalën.

IBRAHIM SELMANI: Jepja fjalën Naimit!

KRYETARI: Naim Maloku, urdhëro, Naim!

NAIM MALOKU: Zoti Kryetar,
Grupi Parlamentar i AAK-së propozon deputetin Bajram Kosumi, si anëtar.

KRYETARI: Faleminderit!
Nga Grupi Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputetja Shpresa Murati.

SHPRESA MURATI: Parlamentarna grupa „7+“ za člana ad hoc komisije predlaže gospodina Zylfi Merdžu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!
Nga Grupi Parlamentar SLS, deputetja Kosara Nikolić e ka fjalën.

KOSARA NIKOLIĆ: Parlamentarna grupa SLS zadržava pravo da dostavi pismo za svog kandidata.

KRYETARI: Ju lus që ta dorëzoni sa më parë!

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:
Konstatoj se më 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi emëroi Komisionin ad-hoc për shqyrtimin e kandidaturave për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Me këtë votim përfundon seanca e sotshme. Mirë u pafshim në seancën e nesërme.

Përgatiti:

Njsia e Transkripteve